


Nr. 4/1 Prot
Lutemi referoni këtë numër në përgjigje

Tiranë, më 05/03 / 2021

**VENDIM**

Nr. 03 , datë 26/02 / 2021

PËR**MIRATIMIN E STRATEGJISË DHE PLANIT TË VEPRIMIT TË PËRGJEGJSHMËRISË SOCIALE TË KESH SH.A.**

Në mbështetje të parashikimeve të Statutit të shoqërisë angazhimeve të KESH sh.a. në kuadër të planit të veprimit Social-Mjedisor pjesë e marrëveshjes së huasë KESH- BERZH për ristrukturimin e KESH sh.a., miratuar me Ligjin Nr. 125/2015 dhe materialit të përcjellë nga menaxhimi i shoqërisë, Këshilli Mbiqyrës në mbledhjen e tij të datës 26/02/2021,

VENDOSI:

1. Miratimin e Strategjisë dhe e Planit të veprimit të Përgjegjshmërisë Sociale të Korporatës Elektroenergjetike Shqiptare sh.a., sipas dokumentit bashkëlidhur pjesë e këtij vendimi.
2. Ngarkohet Administratori i shoqërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KËSHILLI MBIKËQYRËS I SHOQËRISË

Evis MAMAJ Kryetare

Gjergji SIMAKU Anëtar

Arta GUARABARDHI Anëtare

Endrit LAMI Anëtar

Thanas XHILLARI Anëtar

Luigj PJETRI Anëtar

EU Bridge

abkons

LOCAL Knowledge. GLOBAL Standards



KESH

**Strategjia dhe Plani i Veprimit për
Përgjegjshmërinë Sociale të Korporatës
Përgjegjësisë Sociale të Korporatës**

Nëntor / 2020

Tirana, Albania

Përmbajtja

1. Hyrje.....	6
1.1. Parimet ndërkombëtare në lidhje me PSK	6
1.1.1. Të dhëna kyçe nga Udhëzimet Ndërkombëtare	7
1.2. Qëllimi.....	8
1.3. Objektivat	8
1.4. Struktura	8
1.5. Metodologjia.....	8
2. Analiza e Thelluar e Gjendjes Ekzistuese	10
2.1. Përcaktimi i Zonës së Interesit.....	10
2.2. Analiza Sociale dhe Ekonomike e Zonës së Influencës	20
2.2.1. Administrimi dhe Qeverisja	20
2.2.2. Demografia dhe Përbërja e Familjes.....	21
2.2.3. Ekonomia dhe Punësimi	23
2.2.4. Përdorimi i Tokës dhe Mjetet e Jetesës.....	27
2.2.4.1. Bashkia Kukës.....	27
2.2.4.2. Bashkia Tropojë	28
2.2.4.3. Bashkia Shkodër.....	28
2.2.4.4. Bashkia Vau i Dejës	29
2.2.4.5. Ndikimi i Liqeneve në Tokë dhe Përmytjet.....	29
2.2.5. Infrastruktura dhe Shërbimet	29
2.2.5.1. Bashkia Kukës.....	30
2.2.5.2. Bashkia Tropojë	30
2.2.5.3. Bashkia Shkodër.....	30
2.2.6. Turizmi në Zonën e Influencës.....	31
2.2.7. Gjetjet Kryesore	31
2.3. Analiza Mjedisore e Zonës së Influencës	32
2.3.1. Situata Mjedisore dhe Problematikat në Liqenin e Fierzës	33
2.3.1.1. Mbetjet dhe ujërat e ndotura	33
2.3.1.2. Përmytjet dhe Erozioni	35
2.3.2. Situata Mjedisore dhe Problematikat në Liqenin e Komanit.....	37

2.3.2.1.	Mbetjet dhe Ujërat e Ndotura	37
2.3.2.2.	Përmytjet dhe Erozioni	40
2.3.3.	Situata dhe Problemet Mjedisore në Liqenin e Vaut të Dejës.....	41
2.3.3.1.	Përmytjet dhe Erozioni	41
2.3.3.2.	Mbetjet	42
2.4.	Identifikimi i Problemeve dhe Sfidave	43
2.4.1.	Mjedisi	44
2.4.2.	Zhvillimi Ekonomik Lokal.....	44
2.4.3.	Arsimi	45
3.	Veprimtaria Aktuale e Korporatës	47
3.1.	Analiza e Performancës Aktuale të KESH.....	47
3.2.	Praktikat më të mira në Shqipëri	52
3.2.1.1.	Rasti i TAP	52
3.2.1.2.	Rasti i Grupit Balfin	53
3.2.2.	Praktikat më të mira në Rajon	54
3.2.2.1.	Rasti i EPS në Serbi.....	54
3.2.2.2.	Rasti i KEDS në Kosovë	55
3.2.3.	Praktikat më të mira Europiane.....	55
3.2.3.1.	Rasti i ENEL në Itali.....	56
3.2.3.2.	Rasti i ENGIE në Francë	56
3.2.3.3.	Rasti i Statkraft në Norvegji.....	57
3.2.4.	Përfundime	58
4.	Vizioni i Strategjisë së Përgjegjësive Sociale	59
4.1.	Deklarata e Vizionit.....	59
4.2.	Misioni.	59
4.3.	Qëllimet Strategjike	59
5.	Objektivat Strategjike	60

Figurat

Figura 1 - Grupi i Parë i Bashkive në Zonën e Influencës.....	11
Figura 2 - Grupi i Dytë i Bashkive në Zonën e Influencës.....	11
Figura 3 - Komunitetet pranë Liqenit të Vaut të Dejës (1)	13
Figura 4 - Komunitetet pranë Liqenit të Vaut të Dejës (2)	14
Figura 5 - Zona e Përmytjeve në Bashkinë Shkodër	14
Figura 6 - Komunitetet pranë Liqenit të Komanit (1)	15
Figura 7 - Komunitetet pranë Liqenit të Komanit (2)	16
Figura 8 - Komunitetet pranë Liqenit të Komanit (3)	16

Figura 9 - Komunitetet pranë Liqenit të Fierzës (1).....	18
Figura 10 - Komunitetet pranë Liqenit të Fierzës (2).....	19
Figura 11 - Komunitetet pranë Liqenit të Fierzës (3).....	19
Figura 12 - Harta Administrative.....	20
Figura 13 - Popullsia sipas Bashkive.....	21
Figura 14 - Dëndësia e Popullsisë sipas Bashkive	22
Figura 15 - Popullsia sipas Gjinisë sipas Bashkive.....	22
Figura 16 - Popullsia sipas Grup-Moshave sipas Bashkive.....	23
Figura 17 - Papunësia në Qarqet Veriore në raport me Shqipërinë	24
Figura 18 - Punësimi sipas Sektorëve të Ekonomisë.....	24
Figura 19 - PBB në Euro sipas Rajoneve.....	25
Figura 20 - PBB në Euro sipas Qarqeve.....	25
Figura 21 - Venddepozitimi i Mbetjeve të Ngurta Urbane në Kukës (Myç Mamëz).....	34
Figura 22 - Venddepozitimi i Mbetjeve Inerte në Kukës (Myç Mamëz)	34
Figura 23 - Pamje Ilustruese të Ndotjes në Liqenin e Fierzës.....	35
Figura 24 - Zona e prekur nga përmytjet dhe erozioni në fshatrat Lume dhe Përbreg.....	36
Figura 25 - Zonat e Prekura nga Erozioni në Liqenin e Fierzës	36
Figura 26 - Foto të Zonave të Prekura nga Erozioni	37
Figura 27 - Depozitimet Ilegale të mbetjeve të ngurta në Bashkinë Tropojë.....	38
Figura 28 - Venddepozitimi në Fierzë, Bashkia Tropojë	38
Figura 29 - Depozitimet Ilegale të mbetjeve të ngurta në Bashkinë Fushë-Arrëz.....	39
Figura 30 - Vend-depozitim ilegal në Bashkinë Fushë-Arrëz	39
Figura 31 – Zonë e Prekur nga Përmytjet dhe Erozioni në Dushaj, Tropojë.....	40
Figura 32 – Zonë e Prekur nga Përmytjet dhe Erozioni në Levrushk, Fushë-Arrëz	41
Figura 33 - Ngjarjet historike të përmytjeve në zonë nga viti 1851 (Mott MacDonald, 2012)	42
Figura 34 - Vend-depozitimet Ilegale në Zonën e Influencës	43
Figura 35 - Harta e Vend-Depozitimeve të Mbetjeve në Zonën e Influencës	44

Tabelat

Tabela 1 - Karakteristika të Bashkive në Zonën e Influencës.....	12
Tabela 2 - Zona e Influencës së Liqenit të Vaut të Dejës.....	12
Tabela 3 - Zona e Influencës së Liqenit të Komanit	15
Tabela 4 - Zona e Influencës së Liqenit të Fierzës	17
Tabela 5 - Ndryshimet e Popullsisë në Qarqet Kukës dhe Shkodër.....	21
Tabela 6 - Ndërmarrjet e regjistruara sipas Bashkive.....	26
Tabela 7 - Vlera e Përafërt e Lejeve të Ndërtimit në 000 Lekë.....	26
Tabela 8 - Tipologjia e Qarqeve Shkodër dhe Kukës	32
Tabela 9 - Përmbledhje e Aktiviteteve Mjedisore të ndërmarra në kuadër të Përgjegjshmërisë Korporative 2019	48
Tabela 10 - Përmbledhje e Aktiviteteve të Ndërmarra në Kuadër të Përgjegjshmërisë Korporative	49

SHKURTIMET

KESH	Korporata Elektroenergjitike Shqiptare
OST	Operatori i Sistemit të Transmisionit
OSHEE	Operatori Shperndarjes se Energjise Elektrike
ESAP	Planit Veprimit Mjedisor dhe Social
EBRD	Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim
GWh	GigaVat ore
ESMS	Sstemi menaxhimit social dhe mjedisor
ARM	Agjensia Rajonale e Mjedisit
AKM	Agjensia Kombetare e Mjedisit
ISHMP	Inspektorati Shtetëror i Mjedisit dhe Pyjeve
VNM	Vleresimi I Ndikimit Mjedisor
VSM	Vleresimi Strategjik Mjedisor
VNMS	Vleresimi I Ndikimit Mjedisor dhe Social
SKMIBU	Strategjia Kombëtare e Menaxhimit të Burimeve Ujore 2017-2027
MIBU	Menaxhimi I Integruar I Burimeve ujore
MTM	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
TAP	Projekti: Trans Adriatic Pipeline
GHG	Gazeve me Efekt Serre

1. Hyrje

Korporata Elektroenergjetike Shqiptare (KESH) është ndërmarrja prodhuese e energjisë me kapacitetin më të lartë të instaluar në sektorin e energjisë në Shqipëri. Kompania prodhon energji duke pasur ne koniderate ndikim minimal mjedisor, parimet e zhvillimit të qëndrueshëm, përgjegjësisë mjedisore dhe sociale, gjatë aktiviteteve të saj të përditshme.

Korporata synon të përmirësojë vazhdimisht performancën e saj në të gjitha fushat, përfshirë aspektet mjedisore, sociale, shëndetësore dhe të sigurisë, të rrisë kapacitetin dhe të krijojë një kulturë të përmirësimit të vazhdueshëm.

Për t'u pajtuar me legjislacionin e BE për energjinë, aktivitetet e sektorit të energjisë të gjenerimit, transmetimit dhe shpërndarjes, janë shpërndarë në tre ndërmarrje të veçanta:

- OST (krijuar në 2004) është Operatori i Sistemit të Transmisionit;
- OSSH (krijuar në vitin 2007) është shpërndarësi dhe furnizuesi me pakicë, aktualisht i quajtur OSHEE
- KESH, gjeneratori i energjisë elektrike.

KESH shet energji kryesisht për OSHEE dhe më tej tregton energji me shumicë, kryesisht duke importuar dhe blerë nga prodhuesit e pavarur të energjisë, për të furnizuar kërkesën totale të konsumatorëve të tregut të rregulluar të energjisë elektrike, i cili është mbi 7,000 GWh / vit.

Hidrocentralet në lumin Drin kanë një kapacitet total të instaluar prej 1350 MW. HEC-et gjenden në Fierze (4x125 MW, i porositur 1978), Koman (4x150 MW, 1985) dhe Vau i Dejes (5x50 MW, 1971). Hidrocentralet kanë kaluar në rehabilitim të pjesshëm, kryesisht nën financimin e donatorëve. KESH po bashkëpunon me donatorët dhe me autoritetet shqiptare për të përmirësuar sigurinë e digave dhe gatishmërinë e emergjencës, si dhe menaxhimin e përmblyetjeve.

Në kuadër të projektit dhe kontratës së nënshkruar me objekt „Përpilimi i Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Përgjegjshmërinë Sociale të Korporatës (PSK) për KESH sh.a.” Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë “Abkons” dhe “EU Bridge” duhet të dorëzojnë tre raporte pranë Autoritetit Kontraktor:

- Raporti i parë mbi analizën e gjendjes bazë të përgjegjshmërisë sociale korporative;
- Raporti i dytë mbi strategjinë e përgjegjshmërisë sociale të korporatës;
- Raporti i tretë mbi planin e veprimit 3 vjeçar për zbatimin e strategjisë së përgjegjshmërisë sociale të korporatës.

Nga sa më sipër, më poshtë vijon Raporti i Dytë që përbëhet nga Strategjia e Përgjegjshmërisë Sociale dhe Plani i Angazhimit të Palëve të Interesit.

1.1. Parimet ndërkombëtare në lidhje me PSK

Teksa nevoja për adoptim të gjërë të nismave për përgjegjshmëri sociale dhe mjedisore ka ardhur gjithmonë e në rritje, po ashtu është rritur edhe gama e studimeve dhe e direktivave për PSK-në nga institucione ndërkombëtare si Banka Botërore (BB), OKB-ja, OSBE-ja dhe nga ato Europiane si KE. Ndër instrumentat/guidat kryesore për bizneset janë dokumentat e mëposhtme:

- Udhëzimet për Kompanitë Multinacionale të OSBE-së;
- Deklarata Trepalëshe e Organizatës Ndërkombëtare të Punës me Parime Shumëkombëshe për Kompanitë Multinacionale, Politikat Sociale dhe Standardet Thelbësore të Punës;
- Kompakti Global i OKB-së;
- Standardet ISO të Organizatës Ndërkombëtare për Standardizim si ISO 26000 i cili është një ISO vullnetar, i pacertifikueshëm dhe që shërben si udhëzim për ato institucione të cilat duan të investojnë në mënyrë të qëndrueshme dhe afatgjatë në impaktin e tyre social;
- Udhëzimet për Raportim të Qendrueshmërisë së Iniciativës Globale për Raportim (GRI);
- Standardi SA8000 i Përgjegjësisë Sociale Ndërkombëtare.

1.1.1. Të dhëna kyçe nga Udhëzimet Ndërkombëtare

Të gjitha dokumentat e mësipërme ofrojnë parime dhe standarde *vullnetare* për biznese në një kontekst global ku PSK-ja ka gjithmonë e më shumë rëndësi, në përputhje me standarde dhe parime të pranuar ndërkombëtarisht. Që prej Shtatorit të 2010, kur u miratua standardi ISO 26 000 për përgjegjësinë sociale, mbi 93% e organizatave nga 90 vende pjesëmarrëse e miratuan. Por, pavarësisht këtyre dokumentave udhëzues, nuk ka një qasje "one size fits all" për PSK-në duke qënë se cdo biznes ka karakteristika të vecanta dhe operon në një mjedis specifik ku nevojat e komunitetit janë diverse. Nga studimi i dokumentave të mësipërm, ky studim ka nxjerrë elementët e mëposhtëm kyc për strategjinë PSK të KESH-it.

FAZA 1 – PLANIFIKIMI

1. Zhvillimi dhe internalizimi i strategjisë për PSK-në:
 - Zhvillim i përqsjes së korporatës dhe i limiteve të saj;
 - Bazuar në buxhetin e mundshëm vjetor për aktivitete sociale, hartimi i një plani biznesi për aktivitetet PSK.

FAZA 2 - IMPLEMENTIMI

1. Hartimi i qëllimeve vjetore për investime në kuadër të PSK-së:
 - Bazuar në pilarët kryesorë të strategjisë hartuar pas konsultimeve me grupet e interesit.
2. Implementimi i qëllimeve vjetore:
 - Vendosja e objektivave të matshme për investimet sociale;
 - Trajnimi i punonjësve të KESH për garantimin e implementimit të saktë të investimeve dhe aktiviteteve të PSK-së;
 - Bërja publike e investimeve të planifikuara;

FAZA 3 – KONTROLLI

1. Raportim mbi secilin investim apo aktivitet:
 - Vlerësim i impaktit të investimeve apo aktiviteteve;
 - Raportim mbi performancën brenda dhe jashtë korporatës;
 - Raportim përpara grupeve të përfshira;
 - Diskutim mbi hapësirat për përmirësim në aktivitete të ardhshme.

Mbi të gjitha, është me rëndësi kalimi në cdo fazë duke u bazuar në qëllimin kryesor të korporatës, objektivat e biznesit të saj, si edhe kapacitetet. Në mënyrë që të strukturohet në përputhje me dokumentacionet e mësipërme puna e KESH, është i nevojshëm trajnimi dhe njohja e punonjësve me udhëzimet e mësipërme si edhe me mënyrën e raportimit të progresit në aspektet e PSK-së që njihet globalisht, kryesisht ISO 26000 për përgjegjësinë sociale dhe raportimi GRI.

KE e ka përkufizuar PSK-në si "përgjegjësi të ndërmarrjeve për ndikimin e tyre në shoqëri". Sipas këtij përkufizimi, 'barra' për mitigimin e ndikimit në shoqëri bie mbi kompanitë. Brenda KE-së, në drejtorinë DG – GROW (Drejtoria e Përgjithshme për Zhvillim Ekonomik), njësia për "Tregu i brendshëm, Industrinë dhe për Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme (NVM)" ka hartuar dokumenta ku shpjegon mbështetjen për iniciativa PSK nëpër Europë, ndonëse nuk ka një bazë ligjore Europiane për nisma të tilla. Dokumentat e KE janë në formën e Komunikimeve ku i pari është hartuar në vitin 2001 dhe mbështeten në dy parime kryesore:

1. Përgjegjësia sociale e korporatave (PSK) dhe
2. Sjellja e Përgjegjshme e Bizneseve apo Responsible Business Conduct (RBC).

Sa i përket PSK-së, KE inkurajon ndërmarrjet brenda BE-së t'u përmbahen udhëzimeve dhe parimeve ndërkombëtare. Më konkretisht, BE inkurajon të gjitha bizneset Europiane apo ato multinacionale të cilat operojnë edhe në Europë të bëjnë PSK-në pjesë të modelit të biznesit. Strategjia në veprim momentalisht me qëllim udhëzimin e bizneseve mbi këtë proces është hartuar në vitin 2011 dhe synon të bëjë zhvillimin e qëndrueshëm parim bazë të kompanive Europiane si edhe të përmirësorjve raportimet për efektet në mjedis dhe në shoqëri.

Sa i përket parimit të dytë, RBC është një term alternativ i hartuar nga Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Europë (OSBE). OSBE-ja e ka përkufizuar si "garantimi i një kontributi pozitiv në zhvillimin ekonomik, mjedisor dhe shoqëror me qëllim zhvillimin e qëndrueshëm dhe mitigimin e ndikimeve jo pozitive direkte ose indirekte të operimit të një ndërmarrje në komunitet". Për të arritur këtë të fundit, OSBE-ja ka botuar një udhëzues "Due Diligence Guidance for Responsible Business Conduct" (Udhëzues mbi Kujdesin e Kompanive për Veprimtari të Përgjegjshme) në vitin 2018. Kjo guidë është miratuar nga Këshilli i Ministrave Europianë më 30 Maj 2018 dhe ka për qëllim sigurimin e mbështetjes praktike për ndërmarrjet në zbatimin e udhëzimeve të OSBE-së për Ndërmarrjet Shumëkombëshe. Zbatimi i rekomandimeve ndihmon ndërmarrjet në shmangien dhe adresimin e ndikimeve të pafavorshme mbi punëtorët, të drejtat e njëriut, mbrojtjen e mjedisit, korrupsionit etj.

Përveç dokumentave të mësipërm, KE u sugjeron bizneseve Europiane zbatimin e ISO 26000 i cili është një Guidë mbi Përgjegjësinë Sociale plotësisht vullnetare për bizneset si edhe përputhshmërinë me Parimet Udhëzuese për Bizneset dhe të Drejtat e Njëriut të Kombeve të Bashkuara. Duke qënë se keto dokumenta janë vullnetarë, vihet re nje diferencë brenda për brenda Europës sa i përket praktikave PSK. Përkatësisht, në Europën Perëndimore, ku presioni i shoqërisë civile është më i lartë, praktikat PSK janë më të gdhendura në planin e biznesit të kompanive sesa në Europën Lindore. Duke qënë se ambicia e KESH-it është përafrim me udhëzimet optimale të BE-së dhe zbatim i praktikave më të mira, më poshtë do të elaborohet mbi praktikat e tre vendeve të ndryshme, përkatësisht: rasti I ENEL në Itali, ENGIE në Francë dhe Statkraft në Norvegji. Rastet nuk janë zgjedhur në mënyrë sporadike, por duke qënë se këto tre vendet janë nga prodhuesit më të mëdhenj të energjisë hidrike në Europë, ndërsa KESH është ndër prodhuesit më të mëdhenj në rajon.

1.2. Qëllimi

Qëllimi i këtij raporti është ravijëzimi i elementëve bazë të Strategjisë së Përgjegjshmërisë Sociale të KESH, duke identifikuar problemet dhe sfidat dhe përcaktuar Qelimet dhe Objektivat Strategjike, në mënyrë që këto të diskutohen me Palët e Interesit dhe komunitetet në Zonën e Influencës.

1.3. Objektivat

Objektivi kryesor i këtij raporti është të përcaktojë hapat dhe veprimet që KESH synon të ndërmarrë në kuadër të përgjegjshmërisë sociale. Më specifikisht, objektivat e këtij raporti janë:

- Përcaktimi i zonës së influencës;
- Identifikimi i problemeve dhe sfidave me të cilat përballen banorët e zonës së influencës;
- Përcaktimi i qëllimeve dhe objektivave strategjike për t'u përmbushur nga Strategjia.

1.4. Struktura

Ky raport është strukturuar si vijon:

Në Kapitullin 2 zhvillohet një analizë e thelluar e gjendjes ekzistuese në zonën e influencës. Në këtë seksion përcaktohet imtësisht zona e influencës dhe analizohen karakteristikat themelore sociale-ekonomike dhe mjedisore të kësaj zone dhe identifikohen problemet dhe sfidat.

Në Kapitullin 3 përshkruhet veprimtaria e deritanishme e KESH sa i përket përgjegjshmërisë sociale duke identifikuar rastet e suksesit dhe mësimet e nxjerra, çka do të shërbejë edhe si guidë për të ardhmen.

Në Kapitullin 4 përcaktohet vizioni i Strategjisë ndërsa në Kapitullin 5 objektivat strategjike për përmbushjen e këtij vizioni.

1.5. Metodologjia

Metodologjia e përdorur për përpilimin e këtij raporti është bazuar mbi teknikat e mëposhtme:

- **Shqyrtimi i literaturës:** Kjo u krye për të mbledhur të dhëna dytësore dhe informacione të përgjithshme. Ekipi hulumtues ka analizuar botimet dhe dokumentet përkatëse duke përfshirë edhe raportet e mëparshme të publikuara për zonën, botimet shkencore, raportet financiare, rregulloret dhe ligjet si dhe statistikat e qeverisë mbi kushtet socio-ekonomike të zonës.

- **Vëzhgimet në terren:** Gjatë studimit të projektit të propozuar, ekipi i konsulentëve kanë kryer një sërë vëzhgimesh në terren për të njohur nga afër Zonën e Influencës dhe për të vëzhguar gjendjen socio-ekonomike të komunitetit lokal.
- **Diskutimet me grupet e interesit:** Ekipi i konsulentëve kanë kryer një sërë takimesh, intervistash dhe konsultimesh me institucione publike, grupe interesi, ekspertë, etj. për të mbledhur të dhëna primare mbi problemet dhe nevojat. Gjithashtu, janë organizuar edhe dy workshope, një në Shkodër e një në Kukës, me përfaqësues të institucioneve publike, ekspertë, përfaqësues të shoqërisë civile, etj. Një listë e personave të kontaktuar dhe minutave të takimeve gjenden si Aneks i këtij dokumenti.
- **Shqyrtim i të dhënave dhe sondazheve të profilit të komunitetit:** janë kryer për të mbledhur informacione dhe të dhëna statistikore për nivelin e komunitetit. Kjo është bërë kryesisht duke folur me përfaqësuesit kryesorë të komunitetit dhe duke mbledhur informacion dhe të dhëna statistikore të regjistruara në dokumente që lidhen me këtë zonë, raportet socio-ekonomike të komunitetit, e kështu me radhë.

2. Analiza e Thelluar e Gjendjes Ekzistuese

Çdo strategji ka si synim parësor përcaktimin e një sërë objektivash që do të mundësojnë arritjen e një qëllimi afat-gjatë. Hapi i parë për përcaktimin e qëllimeve afat-gjata është analiza e gjendjes ekzistuese. Prandaj edhe në çdo strategji, analiza e gjendjes ekzistuese dhe identifikimi i problemeve dhe sfidave ka një rëndësi themelore, pasi vetëm në këtë mënyrë mund të përpilohen strategji që kanë një impakt të qënësishëm e që janë të implementueshme. Për këto arsye, kapitulli i mëposhtëm zë një vend qendror në këtë strategji.

Duke u nisur nga fusha e veprimtarisë së KESH sh.a. që është prodhimi i energjisë së rinovueshme përmes operimit të hidrocentraleve të Fierzës, Komanit dhe Vaut të Dejës, zona e influencës përfshin pikërisht komunitetet që jetojnë përreth këtyre liqeneve. KESH, me veprimtarinë e vet, ndikon drejtpërsëdrejti në shumë aspekte mbi bashkitë ku operon dhe sigurisht edhe ndikohet punës dhe veprimtarisë së tyre. Për të dyja palët, ndikimet janë si pozitive ashtu edhe negative. Ndonëse ndikimi më i madh mjedisor dhe social ka qenë gjatë ndërtimit të hidrocentraleve dhe krijimit të liqeneve, një ndikim ky permanent, veprimtaria e KESH vazhdon të ketë ndikime negative, si për shembull gjatë stinës së shirave ku hapja e portave shkarkuese shkakton përmytje në disa zona të Shkodrës. Nga ana tjetër, ndikimet që ka shkaktuar KESH përgjatë këtyre viteve kanë qenë më së shumti pozitive. Krijimi i liqeneve ka nxitur zhvillimin e turizmit dhe aktiviteteve ekonomike të lidhura me liqenin si peshkimi, transporti ujqor, etj. të cilat ofrojnë mundësi të shumta për punësimin e komunitetit. Nga ana tjetër, veprimtaria e bashkive dhe komuniteteve përreth ka ndikime negative mbi aktivitetin e KESH. Ndotja e lumenjve nga mbetjet e ngurta, depozitimi i inerteve si rezultat i erozionit, etj. impaktojnë dhe vështirësojnë aktivitetin e KESH për prodhimin e energjisë. Prandaj, KESH vlerëson si prioritare në këtë zonë mjedisin dhe çështjet sociale.

2.1. Përcaktimi i Zonës së Influences

Zona e Influencës së KESH është përcaktuar në bazë të tre kritereve objektive, të cilat janë si më poshtë:

1. Afërsia me kaskadën e Drinit, liqenet dhe lumenjtë që derdhen aty;
2. Aksesin në brigjet liqenore e lumore dhe lidhja ekonomike e sociale me liqenet;
3. Shkalla e ndikueshmërisë së komunitetit nga dhe mbi liqenet dhe lumenjtë.

Në përputhje me këto kritere është bërë përcaktimi i zonës së influencës, duke i ndarë bashkitë në dy grupe kryesore: në grupin e parë përfshihen bashkitë e Kukësit, Vaut të Dejës dhe Tropojës ku edhe ndodhen HEC-et që operohen nga KESH. Me përjashtim të Tropojës, qytetet e Kukësit dhe Vaut të Dejës shtrihen buzë liqeneve dhe prej vitesh qytetet janë zhvilluar në një shkallë me brigjet liqenore. Edhe sa i përket aktiviteteve ekonomike dhe zhvillimit të turizmit, bizneset e këtyre bashkive janë ngushtësisht të lidhura me liqenet. Bashkia e Tropojës, nga ana tjetër, e ka liqenin e Komanit një nga atraksionet më të mëdha turistike dhe në planet afatgjata për zhvillimin e turizmit




Figura 1 - Grupi i Parë i Bashkive në Zonën e Influencës

Në grupin e dytë përfshihen bashkitë e Pukës, Shkodrës dhe Fushë-Arrëzit të cilat ndikohen tërthorazi nga aktiviteti i prodhimit të elektricitetit. Me përjashtim të Bashkisë Shkodër, e cila ndikohet nga përmbytjet, dy bashkitë e tjera të grupit të dytë edhe pse ndodhen në kufi të HEC-eve kanë shumë pak zona të banuara që kanë akses të drejtpërdrejtë në këto liqene e rrjedhimisht kanë pak ndjeshmëri ndaj veprimtarisë së KESH.




Figura 2 - Grupi i Dytë i Bashkive në Zonën e Influencës

Sipërfaqja, popullsia dhe karakteristika të tjera të Bashkive në Zonën e Influencës janë përmbledhur në tabelën e mëposhtme.

Tabela 1 - Karakteristika të Bashkive në Zonën e Influencës

Bashkia	Njesite Administrative	Siperfaqja (km ²)	Popullsia
Shkodër	Shkodër, Rrethina, Gur i Zi, Ana e Malit, Bërdicë, Dajç, Velipojë, Postrisë, Pult, Shosh, Shalë	896	135,612
Vau i Dejës	Vau i Dejës, Bushat, Hajmel, Shllak, Temal	405	30,438
Pukë	Pukë, Qerret, Gjegan, Rrapë, Qelëz	506	11,069
Fushë Arrëz	Fushë-Arrëz, Qafë Mali, Blerim, Fierzë, Iballë	536	7,405
Kukës	Kukës, Kolsh, Malzi, Surroj, Shtiçen, Tërthore, Zapod, Bicaj, Shishtavec, Topojan, Grykë-Çajë, Ujëmisht, Arrën, Bushtricë, Kalis	944	47,985
Tropojë	Bajram Curri, Tropojë, Bujan, Margegaj, Llugaj, Fierzë, Lekbibaj, Bytyç	1,060	20,517

Ndonëse i gjithë territori i këtyre bashkive ndikohet dhe ndikon drejtpërdrejt apo tërthorazi në aktivitetin e KESH, zona e influencës është më e ngushtë dhe përfshin vend-banimet buzë liqeve të Fierzës, Komanit dhe Vaut të Dejës si edhe komunitetet që jetojnë pranë shtratit të lumenjve që furnizojnë këto liqene.

Më konkretisht, zona e influencës përfshin:

- Zonat e banuara buzë Liqenit të Fierzës me sipërfaqe 72 km²;
- Zonat e banuara buzë Liqenit të Komanit me sipërfaqe 34 km²;
- Zonat e banuara buzë Liqenit të Vaut të Dejës me sipërfaqe 25 km²;
- Zonat e banuara në brigjet e Lumit të Drinit të Zi;
- Zonat e banuara në brigjet e Lumit të Drinit të Bardhë;
- Zonat e banuara në brigjet e Lumit të Drinit;
- Zonat e banuara në brigjet e Lumit të Shalës;
- Zonat e banuara në brigjet e Lumit të Valbonës;
- Zonat e banuara në brigjet e Lumit të Bunës.

Në këtë mënyrë, zona e influencës buzë Liqenit të Vaut të Dejës përfshin qytetin e Vaut të Dejës dhe fshatrat Laç-Qyrsaç, Karmë, Vukaj, Kron i Madh, Vukjakaj-Gegaj, Palaj-Gushta, Koman dhe Qerret që ndodhen në Bashkinë e Vaut të Dejës. Gjithashtu, në Zonën e influencës përfshihet edhe fshati Qerret i Vogël i Bashkisë Pukë. Së fundi, Zona e influencës së këtij liqeni përfshin edhe fshatrat e Bashkisë Shkodër si Sheldi, Rragam, Mazrek, Vilzë dhe Shport.

Tabela 2 - Zona e Influencës së Liqenit të Vaut të Dejës

Nr.	Bashkia	Qyteti / Fshati
1		Vau i Dejës
2		Laç-Qyrsaç
3		Karmë
4		Vukaj

5	Vau i Dejës	Kron i Madh
6		Vukjakaj-Gegaj
7		Palaj-Gushta
8		Koman
9		Qerret
10	Pukë	Qerret i Vogël
11	Shkodër	Sheldi
12		Rragam
13		Mazrekë
14		Vilzë
15		Shport

Hartat e Zonës së Influencës sa i përket Liqenit të Vaut të Dejës gjenden më poshtë.



Figura 3 - Komunitetet pranë Liqenit të Vaut të Dejës (1)




Figura 4 - Komunitetet pranë Liqenit të Vaut të Dejës (2)

Vlen për t'u përmendur se sa i takon Bashkisë Shkodër, Zona e Influencës përfshin edhe zonat që përmblyhen nga shkarkimet e liqeneve si rezultat i prurjeve të mëdha të lumenjeve. Harta e përmblyetjeve të mundshme, që shfaqet më poshtë, përveç territoreve të Bashkisë Shkodër, përfshin edhe disa territore të Bashkisë së Vaut të Dejës.




Figura 5 - Zona e Përmblyetjeve në Bashkinë Shkodër

Zona e Influencës së Liqenit të Komanit përfshin vendbanimet që ndodhen në afërsi të këtij liqeni, si edhe përgjatë brigjeve të lumenjeve që e furnizojnë atë. Komunitetet që përfshihen në këtë kategori janë përmbledhur në tabelën më poshtë.

Tabela 3 - Zona e Influencës së Liqenit të Komanit

Nr.	Bashkia	Fshati / Qyteti
1	Vau i Dejës	Arrëz
2		Toplana
3	Pukë	Lëvrushk
4		Bushat
5		Buzhala
6	Fushë-Arrëz	Berishë e Vogël
7	Tropojë	Dushaj
8		Breg-Lumi
9		Salcë
10		Lekbibaj
		Bricë

Në këtë mënyrë, në këtë zonë përfshihen fshatrat Arrëz dhe Toplana të Bashkisë së Vaut të Dejës.



Figura 6 - Komunitetet pranë Liqenit të Komanit (1)

Fshatrat që i përkasin territorit të Bashkisë Pukë janë Buzhala, Bushati dhe Lëvrushku. Gjithashtu, në zonën e influencës përfshihet edhe fshati Berishë i Vogël i Bashkisë së Fushë-Arrëzit.




Figura 7 - Komunitetet pranë Liqenit të Komanit (2)

Fshatrat e Bashkisë Tropojë që përfshihen në Zonën e Influencës janë Dushaj, Breg-Lumi, Salcë, Bricë dhe Lekbibaj, sikurse shfaqen edhe në Hartën më poshtë.



Figura 8 - Komunitetet pranë Liqenit të Komanit (3)

Së fundi, Zona e Influencës së Liqenit të Fierzës është përmbledhur në tabelën më poshtë.

Tabela 4 - Zona e Influencës së Liqenit të Fierzës

Nr.	Bashkia	Fshati / Qytetit
1	Fushë-Arrëz	Arsë
2		Mëzi
3		Dardhë
4		Qebik
5	Has	Kostur
6		Helshan
7		Zahrisht
8		Plani i Patës
9		Liqeni i Kuq
10		Brenogë
11		Metaliaj
12	Kukës	Kukës
13		Kryemadh
14		Kolsh
15		Myç-Mamëz
16		Drinas
17		Gostillë
18		Kodër-Lumë
19		Breg-Lumë
20		Bardhoc
21		Bardhoc i Ri
22		Morinë
23		Domaj
24		Gabricë
25		Cinamak
26	Bushat	

27		Nangë
28		Gostillë

Kjo zonë përfshin fshatrat Arsë, Mëzi, Dardhë dhe Qebik në Bashkinë e Fushë-Arrëzit.



Figura 9 - Komunitetet pranë Liqenit të Fierzës (1)

Fshatrat Kostur, Helshan, Zahrisht, Plani Patës, Liqeni i Kuq, Brenogë dhe Metaliaj në Bashkinë e Hasit. Megjithatë duhet theksuar se këto fshatra kanë shumë pak akses në zonën e liqeni e rrjedhimisht ndikohen dhe ndikojnë shumë pak veprimtarinë e KESH.




Figura 10 - Komunitetet pranë Liqenit të Fierzës (2)

Numri më i madh i vendbanimeve në Zonën e Influencës së KESH i përket territorit të Bashkisë Kukës, ku përfshihen vetë qyteti i Kukësit, si edhe fshatrat Kryemadh, Kolsh, Myç-Mamëz, Drinas, Gostillë, Kodër-Lumë, Breg-Lumë, Bardhok, Bardhok i Ri, Morinë, Domaj, Gabricë, Cinamak, Bushat, Nangë dhe Gostillë.



Figura 11 - Komunitetet pranë Liqenit të Fierzës (3)

2.2. Analiza Sociale dhe Ekonomike e Zonës së Influencës

Studimi socio – ekonomik i zonës bazohet në studime sekondare të të dhënave (INSTAT, Planet Zhvillimore Bashkiake, studime të tjera) dhe në bazë të takimeve të kryera me Institucionet e ndryshme të Bashkive dhe Qarqeve përkatëse. Gjithashtu, ky studim bazohet edhe në Workshopet e kryera me aktorët rajonalë dhe lokalë të mbajtura respektivisht në datën 4 nëntor në Shkodër me përfaqësues të Bashkive, Institucioneve, OJF-ve dhe Operatorëve Turistikë dhe në datën 5 nëntor me aktorët rajonalë dhe lokalë në Qarkun Kukës.

2.2.1. Administrimi dhe Qeverisja

Pas Reformës së re Territoriale të vitit 2016, Shqipëria është e ndarë në 12 qarqe, 61 bashki dhe 373 Njësi Administrative (ish-Komunat). Komunat janë përgjegjëse për qëllimet gjeografike, ekonomike, sociale dhe kulturore brenda qarqeve.

Qarqet u krijuan më 31 korrik 2000 për të zëvendësuar 36 ish-rrethet. Qeveria prezantoi ndarjet e reja administrative që u zbatuan që në 2015, ku komunat u zvogëluan në 61. Ka gjithsej 2980 fshatra ose komunitete në të gjithë vendin, të njohur më parë si lokalitete. Komunat janë niveli i parë i qeverisjes lokale, përgjegjës për nevojat lokale dhe zbatimin e ligjit.

Qarku më i madh në Shqipëri, sipas popullsisë, është Qarku i Tiranës me mbi 800,000 njerëz të ndjekur nga Qarku i Fierit me mbi 300,000 njerëz. Qarku më i vogël, sipas popullsisë, është Qarku i Gjirokastrës me mbi 70,000 njerëz.

Bashkitë drejtohen nga një Kryetar i Bashkisë. Njësitë Administrative formohen nga një ose më shumë fshatra brenda territorit të njësisë dhe drejtohen nga një administrator i caktuar. Përveç kësaj, secili fshat përfaqësohet nga një kryetar fshati, i cili është në varësi të administratorit të njësisë. Tradicionalisht, kryetarët e fshatrave zgjidheshin midis njerëzve më të moshuar që zgjidhnin mosmarrëveshjet midis banorëve dhe i këshillonin ata për çështje të ndryshme, por në ditët e sotme roli i tyre është më shumë si përfaqësues në çështjet administrative.

E dyta, në lidhje me nivelet e qeverisjes lokale vijnë qarqet. Këshilli i qarkut përbëhet nga kryetari i bashkive dhe këshilltarët, ndërsa prefekti emërohet nga qeveria qendrore (Këshilli i Ministrave).



Figura 12 - Harta Administrative

Ndërsa Hidrocentralet e operuar nga KESH ndikojnë në të gjithë vendin sa i përket gjenerimit të furnizimit me energji dhe sigurisë, ato janë gjithashtu një pjesë e rëndësishme e ekonomisë së rajonit verior për sa i përket prodhimit, por edhe si qendra punësimi përmes vetë HEC-ve ose mundësive krijuar në ekonominë lokale përmes krijimit të rezervuarit (peshkimi, turizmi, etj.). Vetë HEC-et ndodhen në Bashkitë Vau Dejës (HEC Vau i Dejës dhe HEC Koman) dhe në Bashkinë e Tropojës (HEC Fierzë).

2.2.2. Demografia dhe Përbërja e Familjes

Shqipëria ka një popullsi aktuale rezidente prej 2,800,138 njerëz sipas Regjistrimit Kombëtar të vitit 2011. Popullsia e Shqipërisë filloi të bjerë nga viti 1990, si pasojë e emigracionit masiv kryesisht për shkak të kushteve të vështira ekonomike pas rënies së regjimit komunist dhe krizës që pasoi. Krahasuar me regjistrimin e mëparshëm në 2001, popullsia u ul me 8% nga 3,069,275 banorët e regjistruar.

Një fakt tjetër, jo më pak i rëndësishëm është që popullsia në zonat rurale ka ndryshuar ndjeshëm pas viteve 1990. Për shkak të mungesës së investimeve dhe mundësive për punësim, një numër i madh i banorëve u larguan nga zonat rurale për të gjetur një punë në qytet.

Në bashkitë e zonës së influencës, ky fenomen vazhdoi gjatë 10 viteve të fundit. Një numër i madh njerëzish janë zhvendosur në zonat urbane në Shqipëri (kryesisht në kryeqytet) ose jashtë vendit, në kërkim të mundësive më të mira ekonomike.

Rreth 275,000 njerëz jetojnë në rajonet e Shkodrës dhe Kukësit. Të dy rajonet janë ndër më të varfërit në vend, duke pësuar një humbje të rëndësishme të popullatës si rezultat i emigracionit jashtë vendit ose migrimit të brendshëm në rajonet qendrore të Tiranës dhe Durrësit. Sipas të dhënave të INSTAT, popullsia në këto rajone pritet të tkurret edhe më shumë në të ardhmen. Siç shihet në tabelën më poshtë, popullsia në 4 vitet e fundit është në rënie në të dy rajonet që humbin përkatësisht; Shkodra 4.83 % dhe Kukësi 7.22% të popullsisë së tyre të përgjithshme.

Tabela 5 - Ndryshimet e Popullsisë në Qarqet Kukës dhe Shkodër

QARKU	2016	2017	2018	2019	2020
Shkodër	210,168	207,924	204,994	202,895	200,007
Kukës	81,294	79,559	77,394	76,594	75,428

Sipas Censurit 2011, popullsia e bashkive në zonën e influencës është e paraqitur në grafikun si më poshtë. Shkodra është bashkia me numrin më të lartë të popullsisë me përkatësisht 135,612 banorë (përfshirë të gjitha njësitë administrative si në tabelë 1 më lart). Bashkia me numrin më të ulët të popullsisë është Fushë-Arrëzi, me përkatësisht 7,405 banorë.




Figura 13 - Popullsia sipas Bashkive

Tendencat e popullsisë urbane-rurale tregojnë një rritje prej 19% të popullsisë urbane në periudhën 2000-2017 në Qarkun e Shkodrës, e cila ka nivelin më të ulët të popullsisë urbane në krahasim me rajonet e tjera. Dendësia e popullsisë në nivelin bashkie është 155.3 b/km², më e larta në krahasim me bashkitë e tjera në zonën e influencës. Bashkia me dendësinë më të ulët të banorëve është Fushë-Arrëzi përkatësisht 13.7 b/km². Grafiku më poshtë paraqet dendësinë e popullsisë në secilën prej këtyre bashkive..




Figura 14 - Dendësia e Popullsisë sipas Bashkive

Sa i përket gjinisë, anëtarët e familjes janë kryesisht meshkuj, në shumicë e bashkive. Kjo pasqyron gjithashtu situatën e përgjithshme gjinore në Shqipëri. Grafiku më poshtë paraqet ndarjet gjinore për bashkitë në zonën e influencës.




Figura 15 - Popullsia sipas Gjinisë sipas Bashkive

Grupmosha dominante e anëtarëve të familjes është midis 15 dhe 64 vjeç, që përbën shumicën e popullsisë në secilën nga bashkitë. Grupmosha e popullsisë me moshën shumë se 65 vjeç, më është në nivelin mesatar të popullsisë së Shqipërisë, që është 11.34%. Bashkia me përqindjen më të lartë të banorëve mbi 65 vjeç është ajo e Vaut të Dejës, me 12.59% së totalit, ndërsa Bashkia me përqindjen më të ulët është ajo e Kukësit me vetëm 6.9% të totalit të popullsisë, në një nivel shumë më të ulët se mesatarja kombëtare. Nga të dhënat e paraqitura në grafikun më poshtë, fëmijët, të moshës ndërmjet 0 dhe 14 vjeç, përfaqësojnë deri në 28.7% (Has) të popullsisë.




Figura 16 - Popullsia sipas Grup-Moshave sipas Bashkive

Struktura tipike e familjes në Shqipëri përbëhet nga tre breza që jetojnë nën të njëjtën çati: të moshuarit, djali i tyre i martuar dhe nipërit e mbesat e tyre. Kur krijohet një strukturë e tillë, siguruesi kryesor i të ardhurave konsiderohet njeriu që është në moshë pune - brez i moshës së mesme.

2.2.3. Ekonomia dhe Punësimi

Shqipëria ka bërë përparim të jashtëzakonshëm ekonomik gjatë tre dekadave të fundit. Për shkak të performancës së fortë të rritjes, Shqipëria u rrit nga një prej kombeve më të varfra në Evropë në një vend me të ardhura të mesme, me varfërinë që u përgjysmua gjatë një periudhe 25 vjeçare. Sidoqoftë, modeli i rritjes së Shqipërisë duhet të kalojë nga rritja e nxitur nga konsumi, në rritjen e drejtuar nga investimet dhe eksporti.

Modeli i ri do të duhet të ndihmojë ata njerëz me më pak akses në mundësi ekonomike për të kontribuar dhe përfituar nga rritja ekonomike. Në mënyrë që të përshpejtojë ritmin e rritjes së drejtë, Shqipëria po zbaton reforma strukturore që do të rrisin produktivitetin dhe konkurrencën në ekonomi, të krijojnë më shumë vende pune dhe të përmirësojnë qeverisjen dhe ofrimin e shërbimeve publike. Lidhja e zgjeruar rajonale dhe qasja në tregjet rajonale dhe globale, së bashku me eksportin dhe diversifikimin e tregut, gjithashtu mund të ndihmojnë në promovimin e një rritje më të shpejtë.¹

Një prej aspekteve kryesore të rritjes së ekonomisë së një vendi apo rajoni, është edhe shkalla e papunësisë, e cila përfshin të dhëna të tilla si numri i punëkërkuessve të papunë sipas gjinisë dhe papunësia në % sipas rajonit. Grafiku më poshtë tregon një trend në rënie të numrit të punëkërkuessve të papunë në tre bashkitë e Qarkut Shkodër, ku ky numër në periudhën 2010-2016 është pothuajse përgjysmuar nga 44.723 në 27.494 individë. Në krahasim me nivelin kombëtar në vitet 2010-2016, Qarku i Shkodrës ka një pjesëmarrje gjithnjë e më të ulët nga 31.09% në 22.97%, që është një tregues shumë pozitiv.

Shkalla e papunësisë në Qarkun e Shkodrës gjatë periudhës 2010-2016, megjithëse ato kanë rënë në mënyrë të qëndrueshme nga 26.38% në 16.6%, janë dukshëm më të larta se niveli i papunësisë 10.3% në nivelin e vendit. Gjithashtu, këto norma në krahasim me rajone të tjera janë më të lartat. Kjo është për shkak të performancës së ulët ekonomike, si dhe problemeve të hyrjes që shfaqin zona të ndryshme brenda rajonit. Në nivelin e qarkut, Kukësi është qarku me papunësinë më të lartë në nivel kombëtar me 26.13% në 2016.

¹ Banka Botërore <https://eëë.eorlbank.org/en>




Figura 17 - Papunësia në Qarqet Veriore në raport me Shqipërinë

Sa i përket punësimit, në Qarkun Kukës, pjesa dërrmuese e popullsisë, rreth 70%, punon në sektorin e bujqësisë, duke e bërë Kukësin qarkun më të varur nga bujqësia.




Figura 18 - Punësimi sipas Sektorëve të Ekonomisë

Nga ana tjetër, Qarku Shkodër paraqet një strukturë punësimi më të balancuar, me 45% të popullsisë që punon në sektorin bujqësor dhe 38% në sektorin e shërbimeve.

Aspektet e mirëqenies sociale dhe varfëria janë gjithashtu shumë të rëndësishme për zhvillimin shoqëror të rajonit. Për sa i përket varfërisë, përqindja e familjeve në nivelin e qarkut që konsiderohen si të varfëra në krahasim me numrin e përgjithshëm të familjeve është ndër më të lartat në rang kombëtar. Qarku i Kukësit me rreth 23% është renditur si qarku me nivelin më të lartë të varfërisë. Gjithashtu, së bashku me qarkun e Shkodrës (15,4%) renditen midis qarqeve me shkallë të lartë të varfërisë në raport me rajonet e tjera të Shqipërisë. Varfëria është e lidhur ngushtë me faktorë të tillë si papunësia dhe faktorët e ulët ekonomikë që karakterizojnë rajonin verior. Në analizën e mësipërme, niveli i

papunësisë është më i larti në nivel kombëtar, gjithashtu PBB dhe GVA rajonale janë më të ultat në raport me rajonet e tjera, duke shtuar gjithashtu problemet në qasjen në shërbime të ndryshme. Këta faktorë kontribuojnë në nivelet më të larta të varfërisë në vend.

Sipas të dhënave të INSTAT, Veriu është rajoni më pak i zhvilluar ekonomikisht i vendit. Në këtë mënyrë, siç edhe mund të vërehet në grafikun e mëposhtëm, në rajonin e veriut prodhohet vetëm 23% e PBB-së së vendit, krahasuar me 49% që prodhohet në Qendër e cila përfshin Tiranën dhe Elbasanin. Është e rëndësishme të përmendet se përfshirja e Durrësit, qyteti i dytë më i zhvilluar i vendit, në rajonin e Veriut krijon një fare çorientimi duke rritur artificialisht kontributin e këtij rajoni në PBB e vendit. Nëse përjashtojmë Durrësin bashkitë e veriut rezultojnë se japin një kontribut shumë të vogël në PBB e Shqipërisë, çka përforcon idene se kemi të bëjmë me zonat më pak të zhvilluara të vendit.




Figura 19 - PBB në Euro sipas Rajoneve

Figura më poshtë jep një panoramë më të saktë të kontributit të qarqeve të Veriut të Shqipërisë në PBB e vendit. Kështu, qarku Kukës është qarku më pak i zhvilluar ekonomikisht i vendit dhe prodhon vetëm 2% të PBB kombëtare. Në një nivel pak më të lartë ndodhen qarqet Lezhë dhe Dibër me nga 3% dhe me qarku më i zhvilluar verior mbetet Shkodra e cila prodhon 5% të PBB të vendit.




Figura 20 - PBB në Euro sipas Qarqeve

Nga të dhënat INSTAT në vitin 2017 vërejmë se qarku me kontributin më të ulët në nivel kombëtar është Kukësi me 2%, Lezha 3% dhe Shkodra me 5%. Nga kjo mund të vërehet se Rajoni i Veriut kontribuon me rreth 10% të totalit. Kjo është gjithashtu shifra më e ulët e kontributit rajonal në raport me totalin në krahasim me rajonet e tjera. Kontributi i rajonit në PBB tregon qartë nivelin e pabarazive në zhvillimet ekonomike të qarqeve dhe rajoneve.

Në qarkun e Kukësit, në strukturën e PBB-së mbizotërohet nga sektori i bujqësisë, gjuetisë, pylltarisë dhe peshkimit me rreth 41.0% në total në vitin 2015. Një sektor i rëndësishëm është edhe sektori i industrisë i treguar nga prania e minierave në territor.

Në qarkun e Shkodrës, struktura e PBB-së dominohet nga sektori "Bujqësi, gjueti, pylltari, peshkim" me rreth 31.4% në total në vitin 2015. Prania e një game të gjerë tërheqjesh turistike vlerësohet se ka kontribuar në rritjen e pjesa e "Aktivitetet me shumicë dhe pakicë, Transporti dhe Ruajtja, Mikpritja dhe Shërbimet" në vitin 2015. Industria dhe Ndërtimi janë sektorë që rrisin vazhdimisht vlerën e shtuar të Qarkut Shkodër.

Një e dhënë tjetër që ndihmon në të kuptuarin e saktë të diferencave në zhvillimin rajonal është edhe numri dhe tipologjia e sipërmarrjeve që operojnë në zonë. Sipas Anketës Strukturore të Ndërmarrjeve të përpiluar nga INSTAT, në 6 bashkitë që ndodhen në zonën e influencës së KESH janë gjithësej të regjistruara 10,486 sipërmarrje ose 6.4% e totalit të sipërmarrjeve që operojnë në Shqipëri, duke treguar një zhvillim të ngadaltë ekonomik, me përfundim të Bashkisë Shkodër.

Në Bashkinë Kukës operojnë gjithësej 1,063 sipërmarrje ose 0.65% e totalit të vendit. Pjesa dërrmuese e sipërmarrjeve në këtë bashki operojnë në prodhimin e shërbimeve dhe të mirave, me industrinë, bujqësinë dhe turizimin në një shkallë më të ulët zhvillimi. Situata paraqitet disi më ndryshe në Bashkinë Tropojë ku janë të regjistruara gjithësej 571 sipërmarrje ose vetëm 0.35% e totalit të vendit. Në këtë bashki, shumica e ndërmarrjeve operojnë në sektorin e prodhimit të të mirave ndërkohë që në ndryshim nga bashkitë e tjera, sektori i shërbimeve është shumë pak i zhvilluar, ndërkohë që bujqësia dhe turizmi kontribojnë në ekonominë lokale në një shkallë më të lartë se në bashkitë e tjera. Nga tre bashkitë që ndodhen në zonën e influencës së drejtpërdrejt të KESH, Vau i Dejës ka numrin më të lartë të sipërmarrjeve të regjistruara. Më shumë se gjysma e sipërmarrjeve në këtë bashki operojnë në prodhimin e të mirave, ndërkohë që bujqësia paraqitet më e zhvilluar se në bashkitë e tjera.

Tabela 6 - Ndërmarrjet e regjistruara sipas Bashkive

Bashkia	Nr. i Sipërmarrjeve	% ndaj totalit të Shqipërisë	Prodhim të mirash	Industri	Bujqësi	Turizëm	Shërbime	Tregtia
Kukës	1,063	0.65%	425	69	326	130	638	254
Tropojë	571	0.35%	300	34	258	271	76	115
Vau i Dejës	1,178	0.72%	750	69	665	105	428	212
Pukë	298	0.18%	77	22	49	55	221	76
Fushë-Arrëz	107	0.06%	31	7	18	13	76	29
Shkodër	7,269	4.46%	2,091	454	1,486	1,226	5,178	2,465

Nga bashkitë që ndodhen në brezin e dytë të zones së influencës së KESH, Bashkia Shkodër është sigurisht bashkia me numrin më të madh të sipërmarrjeve. Pjesa dërrmuese e sipërmarrjeve në këtë bashki operojnë në sektorin e shërbimeve, tregtisë dhe prodhimin e të mirave. Industria është ende në fazat e para të zhvillimit në Shkodër. Fushë-Arrëzi, si një nga bashkitë më të vogla në Shqipëri, ka një numër shumë të vogël sipërmarrjesh, të cilat më së shumti operojnë në sektorin e shërbimeve. Në Bashkinë Pukë operojnë gjithësej 298 ndërmarrje, ose 0.18% e ndërmarrjeve të regjistruara në shkallë vendi. Edhe në këtë bashki, më shumë se gjysma e ndërmarrjeve operojnë në sektorin e shërbimeve, e cila pasohet nga tregtia dhe turizmi.

Një tjetër tregues shumë i rëndësishëm i zhvillimit ekonomik janë edhe investimet në ndërtim apartamentesh, zyresh, fabrikash etj. Siç mund të shihet edhe në tabelën e mëposhtme, gjatë 4 viteve të fundit, vlera e investuar në ndërtim në Bashkitë Kukës, Tropojë, Vau i Dejës, Shkodër, Pukë dhe Fushë-Arrëz është vetëm 4.53% e vlerës që është investuar në gjithë vendin për të njejtën periudhë. Vlerën më të ulët e shënon Bashkia Fushë-Arrëz në të cilën gjatë periudhës 2016-2019 janë investuar vetëm 64 milionë Lek, ose 0.02% e investimit në shkallë vendi. Edhe në Bashkinë e Pukës niveli i investimeve ka qenë i ulët duke shënuar në 665 milionë lekë ose 0.29% e investimeve në shkallë vendi. Në të njëjtin nivel qëndron edhe Bashkia Tropojë me rreth 700 milionë lekë investime në ndërtime. Kuptueshëm në Bashkinë Shkodër investimet në ndërtime kanë qenë shumë më të larta duke arritur vlerën e rreth 6.5 miliardë lekëve. Mbi 1 miliardë lekë investime janë shënuar edhe në Bashkitë e Kukësit dhe Vaut të Dejës, resepektivisht 1.1 miliardë Lekë dhe 1.3 miliardë Lekë.

Tabela 7 - Vlera e Përafërt e Lejeve të Ndërtimit në 000 Lekë

	2016	2017	2018	2019	TOTAL	Në % ndaj tot.
SHQIPËRIA	ALL 25,820,513	ALL 49,123,539	ALL 59,021,730	ALL 92,689,800	ALL 226,655,582	100%

Kukës	ALL 1,068,576	ALL 95,866	ALL -	ALL 3,122	ALL 1,167,564	0.51%
Tropojë	ALL -	ALL 105,115	ALL 167,355	ALL 429,331	ALL 701,801	0.3%
FushëArrëz	ALL -	ALL -	ALL -	ALL 64,117	ALL 64,117	0.02%
Pukë	ALL 52,000	ALL 278,775	ALL 263,717	ALL 70,709	ALL 665,201	0.29%
Shkodër	ALL 1,318,622	ALL 1,674,421	ALL 1,898,457	ALL 1,559,519	ALL 6,451,019	2.84%
Vau Dejës	ALL 1,519	ALL 30,042	ALL 652,582	ALL 627,726	ALL 1,311,869	0.57%

2.2.4. Përdorimi i Tokës dhe Mjetet e Jetesës

Shqipëria ka një sipërfaqe totale prej 28,748 km², nga të cilat 24% është tokë bujqësore, 36% pyje, 15% kullota dhe livadhe dhe 25% tokë joproduhuese, përfshirë tokën malore, tokën urbane dhe trupat ujorë. Shqipëria ka një nga zonat më të vogla të tokës bujqësore për frymë (0.22 hektarë) në rajon.

Shpërndarja relativisht e drejtë e tokës bujqësore në familjet rurale në vitet 1990 ka rezultuar në një copëzim ekstrem të pronave të tokës. Numri i lartë i pronarëve të tokave e ndërlikon vendimmarrjen për zhvillimet, si dhe për përdorimin në shkallë të gjerë bujqësore të tokës. Disa parcela toke janë me cilësi të dobët për qëllime bujqësore. Megjithatë copëzimi i tokës dihet të jetë një nga çështjet kryesore me të cilat përballet Shqipëria, mungojnë informacione të hollësishme statistikore ose të tjera të besueshme.

Gjithashtu, çështja e kthimit / kompensimit të të drejtave pronësore është ende e pazgjidhur. Kthimi i tokës bujqësore është debatuar që nga viti 1993, kur Ligji origjinal 7698 për Kthimin e Pronave ish-Pronarëve përjashtoi këtë kategori. Zbatimi i këtij ligji vazhdon të jetë i paplotë.

Gjatë viteve 1990 shumë parcela u ndanë dhe strukturat u ndërtuan në tokë pa autorizim ligjor. Këto veprime rezultuan në rrethe informale urbane në periferinë e qyteteve, zona të përqendruara hoteliere dhe shërbimesh turistike në bregdet, ndërtesa të shpërndara tregtare dhe shërbimi në autostrada dhe shtëpi në fusha bujqësore jashtë qendrave të fshatit. Parcela të tilla toke të paautorizuara dhe ndërtesa të paligjshme tani përbëjnë një pjesë të madhe të të gjitha pasurive të paluajtshme.

2.2.4.1. Bashkia Kukës

Bujqësia mbetet sektori që siguron nivelin më të madh të të ardhurave dhe sektori kryesor i punësimit në Kukësit. Kjo zonë njihet për zhvillimin e bujqësisë dhe sidomos blegtorisë falë një klime mjaft të përshtatshme për zhvillimin e saj. Klima dhe terreni gjeografik janë faktorët kryesorë që garantojnë zhvillimin e bujqësisë. Bujqësia zë një vend shumë të rëndësishëm në zhvillimin e tregut të brendshëm, ku operojnë një numër i madh tregtarësh me prodhimin vendas.

Terreni malor i zonës ndikon dhe në strukturën e tokës, ku pyjet zënë rreth 62% të territorit të zonës, ndërsa toka bujqësore zë vetëm 16 % të territorit. Pyjet përbëjnë një nga pasurinë natyrore me të rëndësishme. Llojet e drurëve janë, ha, pishë, mështekën, shkozë, rraboll etj. Kjo është një mundësi për shtimin e numrit të blektorisë dhe shfrytëzimin racional të kësaj sipërfaqe duke i dhënë jetë ekonomisë pyjore, me prodhimet e dyta të pyllit, bimët mjekësore dhe turizmi malor.

Pjesa e tokës e shfrytëzueshme për bujqësi përbëhet në një masë të madhe nga kullotat 56% ndërsa toka arë zë vetëm 34%. Ndërsa sipërfaqet e mbjella me vreshta dhe pemtoret zënë një sipërfaqe prej 10% të totalit.

Pemët frutore kane edhe orientimin më të lartë drejt tregut. Kulturat e drithërave të bukës dhe foragjeret kanë shumë pak fitim ose aspak, dhe kultivimi i tyre bëhet për shkak të traditës dhe përdoret për nevojat e familjes dhe foragjeret për blektorinë. Rendimenti më i lartë është në patate. Në lidhje me gjendjen e pemëtarisë, situata tregon për një trend pozitiv. Në vitin 2020 regjistroheshin pemë frutore 857 mijë rrënjë, vreshta 88 mijë rrënjë dhe 344 mijë rrënjë. Numri i tyre dhe prodhimtaria ka ardhur duke u rritur vit pas viti ku rritjen më të madhe e kanë pasur vreshtat me 8% në vit, pemët frutore 6%, dhe pjergullat me 3% në vit. Si rezultat i rritjes së numrit të vreshtave prodhimi ka pësuar një rritje me ritme mesatare vjetore 12%. Pemtaria është edhe dega që sjell burimin më të madh të të ardhurave, rreth 55% 17 për fermerët.

Agro-përpunimi ka filluar të intensifikohet këto vitet e fundit. Investitorët dhe fermerët kanë investuar në linja të vogla, të mesme dhe të mëdha për përpunimin agrobujqësor sidomos për përpunimin e qumështit dhe të frutave per lëngje dhe pije alkoolike. Në Kukës ushtrojnë aktivitetin dy subjekte per prodhimin e pijeve alkoolike kryesisht, të cilat përdorin si lëndë bazë produktet e zonës si kumbullat, rrushin, manaferrin, etj. Këto dy firma janë të pozicionuara në Bashkinë e Kukësit dhe shërbejnë edhe si pika grumbullimi e përpunimi të frutave.

Zona e Kukësit ka potenciale shumë të mëdha përsa i përket bimëve medicinale, pasi është mjaft e pasur me këto burime. Një bimë tipike medicinale e Zonës është sherebela, e cila kultivohet nga mbi 10.000 familje në Zonën e Kukësit. Për më tepër se një vit ama, ky produkt nuk gjen mjaftueshëm treg për të sjellë fitime tek kultivuesit e saj. Ashtu si sherebela, janë mbi 100 bimë medicinale që rriten në Zonë, për të cilat ama mungon drejtimi teknik dhe duhen bërë studime toke për të nxitur kultivimin e tyre dhe rritur përfitimet.

Gjithashtu në vende si Shishtavec, Topojan, Bicaç dhe Tërthora ku mjedisi i kësaj zone është mjaft i larmishëm, rriten në formë natyrale bimë medicinale si, boronicë, shkëm, qershizë lule basani, sherebela.

Aktualisht bimët mbledhen kryesisht nga banorë të fshatrave në territoret e të cilëve ato ndodhen dhe pastaj grumbullohen nga tregtarë lokalë apo të tjerë që jo të gjithë janë të licensuar.

Fermerët lokalë nuk i kultivojnë këto bimë por thjesht i mbledhin në natyrë. Grumbullimi i tyre bëhet spontanisht dhe nuk ka ende ndonjë organizim të vecantë për mbledhjen e tyre. Eksistojnë vetëm 2 pika grumbullimi të Bimëve Medicinale, një në Parkun i Ri dhe tjetra në Zonën Industriale. Të dija pikat e grumbullimit ndodhen në Bashkinë e Kukësit. Megjithatë vështirësitë në tregtimin e bimëve medicinale, ka potenciale që këto prodhime të jenë konkurrese jo vetëm në tregun lokal por edhe atë rajonal e ndërkufitar.

Tregu i produkteve bujqësore të dibrës akoma nuk është formalizuar në cilësinë e dëshiruar pasi mungon marka e produkteve, çertifikimi, pikat e grumbullimit dhe pikat e shitjes.

2.2.4.2. Bashkia Tropojë

Bujqësia është një nga sektorët e rëndësishëm ekonomik të rajonit të Tropojës. Popullsia e Tropojës është plotësisht e varur nga zhvillimi bujqësor, si veprimtari parësore për sigurimin e të ardhurave ekonomike. Tropoja ka rreth 7387 ha tokë bujqësore dhe nëse llogaritet kjo sipërfaqe toke për familje në ha, kemi: 0,634 ha për çdo familje. Në shkallë rrethi, janë rreth 4800 ferma që ushtrojnë aktivitet bujqësor dhe blegtoral. Madhësia e fermës shkon nga 1-2.2 ha tokë bujqësore të punueshme. Tokat bujqësore përfshijnë të kafenjtë (77%), të murrme (22%) dhe livadhore malore (0.6%). Sipërfaqen më të madhe të sipërfaqes së tokës së punueshme e zënë bimët e arave (rreth 50%).

Pothuaj për të gjitha kulturat bujqësore, përveç foragjereve, është ulur sipërfaqja e mbjellë. Kjo për arsye të ndryshme nga të cilat veçojmë largimin e familjeve nga fshati në qytet dhe në rrethe të tjera, emigrimin/migrimin e të rinjve jashtë shtetit dhe drejt kryeqytetit, mungesa e mekanizimit, pamundësia për të përballuar rritjen e tarifave të larta që rrisin koston e prodhimit, si dhe ulja drastike e aftësisë ujitëse në shkallë rrethi. Ulja e sipërfaqes së mbjellë me kultura bujqësore një-vjeçare është shoqëruar me rritjen e kulturave livadhore polifite shumë-vjeçare, kjo edhe si nevojë e sigurimit të bazës ushqimore për blegtorinë.

Bimët medicinale janë një element tjetër burim të ardhurash, të cilat gjenden më shumicë. Pyjet dhe bjeshkët e Tropojës janë të pasura në bimë medicinale. Boronica rritet në kullotat alpine në rreth 1800-2000 metër lartësi. Çdo vit mbledhen afërsisht 70-ton boronicë. Ndër bimët e tjera medicinale që mbledhen dhe tregtohen janë dëllinja e zezë (rreth 40 ton/vit), trendafilii i egër (rreth 20 ton/vit) dhe molla e egër (rreth 30 ton/vit).

Për shkak të terrenit malor, sipërfaqes së madhe të livadheve dhe kullotave në zonën e Tropojës ka bërë që të kemi një traditë blegtorale. Blegtorinë është ndoshta dega më e rëndësishme e bujqësisë për Tropojën pasi ajo mbulon pjesën më të madhe të ardhurave në vend. Kjo lidhet me të ardhurat e mëdha që fermeri siguron nga mishit ndërsa qumështi me nënproduktet e tij si gjalpi, djathi, kosi, gjiza etj janë baza kryesore e ushqimit në familje dhe shumë pak tregtohet. Bagëtitë vlerësohen shumë në rrethin e Tropojës, pasi ato janë burimi kryesor i prodhimeve të mishit dhe qumështit. Përpunimi i produkteve të mishit dhe të qumështit është pothuaj inekzistent. Mishit dhe qumështi ose shitën drejtpërsëdrejti dhe në mënyrë primitive ose përpunohen në masë të vogël në kushtet e shtëpisë, kryesisht për plotësimin e nevojave familjare dhe më pak për treg.

2.2.4.3. Bashkia Shkodër

Tokat bujqësore zënë një sipërfaqe prej 16054 ha, e shpërndarë në të gjitha njësitë administrative nga të cilat 90.5% e sipërfaqes i përket NJ Velipojë, Dajç, Ana e Malit, Gur i Zi, Rrethinat, ndërsa vetëm 9.5% katër NJA Shosh, Pult, Shalë dhe Postribë. Bujqësia në Shkodër është me rëndësi kombëtare pasi tokat bujqësore të nën Shkodrës përbëjnë kapacitete të larta prodhuese, me terren fushor 0-5%, të pasura dhe me mundësi për rritjen e aftësisë ujitëse. Shkodra ka një traditë të njohur për zhvillimin e bujqësisë, e përshtatshmëri të tokës dhe klimës për kultivimin e drithërave, perimeve, foragjereve, bishtajoreve, vreshtit, pemëve frutore, ullirit deri në kufirin e lejueshëm klimatik, bimëve dekorative, blegtorisë (gjedhit dhe të imtave).

Në zonën fushore dominojnë tokat në klasat 2-4. Boniteti vlerëson agroprodhimin e tokës. Një kategori përfshin Brenda të gjithë cilësitë e tokës të cilat mund të jetë të standartit e një zhvillimi bujqësor të qëndrueshëm ose cilësitë e tyre nuk janë të përshtatshme për zhvillimin e bujqësisë dhe nivelin e prodhimit.

Mekanizimi dhe përdorimi i teknologjisë në bujqësi nuk është shumë i zhvilluar. Një gjë që vërehet është mungesa e përdorimit të serave, të cilat janë të zhvilluara në territore shumë të vogla kryesisht në njësinë administrative Dajç. Për sa i përket kultivimit të tokave bujqësore mund të thuhet se jo i gjithë kapaciteti tokësor përdoret dhe kultivohet nga ku 20-25 % e sipërfaqes së përgjithshme është e pakultivuar. Numri total i fermave bujqësore është 18260 nga ku në njësitë malore madhësia mesatare e fermës është më pak se 0.5 ha.

2.2.4.4. Bashkia Vau i Dejës

Bujqësia dhe blegtoaria përbëjnë burimin kryesor ekonomik të popullsisë. Vreshtaria dhe kultivimi i frutave janë të pranishme, së bashku me prodhime të tjera me vlere të lartë të shtuar, të tilla si kultivimi i bimëve në serra. Nga një total prej 9681 hektarë tokë arë, në këtë bashki janë 497 hektarë pemë frutore, 336 hektarë ullishte dhe 256 hektarë vreshta. Pjelloria e tokës bën të mundur gjithashtu mbarëshkrimin e kafshëve dhe shpendëve, i cili është aktiviteti kryesor ekonomik për popullsinë vendase, në sajë të shitjes së produkteve të kafshëve, të tilla si mish, qumësht dhe djathë (me Zadrimën e cila tashmë gëzon tregun e saj në nivel lokal dhe kombëtar), vezë dhe produkte të tjera².

2.2.4.5. Ndikimi i Liqeneve në Tokë dhe Përmbytjet

Në zonën e influencës, ndërtimi i Hidrocentralit të Fierzës përmbyti një pjesë konsiderueshme të tokave në brigjet e Drinit Bardhë, Drinit Zi dhe Drinit Bashkuar. Vetëm në rrethet Kukës e Has u prekën nga përmbytja plotësisht e pjesërisht një qytet i tërë, Kukësi i Vjetër, me 28 fshatra me një sipërfaqe prej 1300 ha tokë arë prodhuese. Ndërsa në rrethin Tropojës u përmbyt pjesërisht vetëm fshati Shëngjergji, me një sipërfaqe jo të madhe. Toka e brigjeve të Drinit ishte toka më pjellore e qarkut të Kukësit tokë humusore, e gjitha nën ujë dhe me rendimente të larta dhe e vlerësuar për prodhimet e bollshme në perime, grurë e misër, në vreshta në fshatrat Brrut, Kukës, Ramhas, Përbreg, Shalqin, Bozhe, Kolsh, Kalimashit etj.

Përveç territoreve që janë përmbytje të përhershme gjatë prurjeve të shumta në sezonin e dimrit ekziston rrishtu i përmbytjeve të përkohëshme. Zonat e prekura nga përmbytja janë kryesisht territor rural, përveç qytetit të Shkodrës. Asetet më të prekura nga përmbytja janë shtëpitë, stallat e bagëtive dhe rrugët.

Gjatë ngjarjes së përmbytjes në dhjetor 2010 numri i dokumentuar i përgjithshëm i banorëve të evakuuar në këtë zonë ishte rreth 12,145 dhe numri i shtëpive të prekura ishte rreth 7,120 (4,540 shtëpi të përmbytura dhe 2,580 shtëpi të rrethuara me ujë), ndërsa numri i aseteve në rrezik në këtë zonë ishte më shumë se 400 të llojeve të ndryshme. Sipas provave të Drejtorisë së Bujqësisë në Rajon, gjatë ngjarjeve të përmbytjes, toka e kultivuar dhe tokat bujqësore janë prekur shumë (rreth 10,280 ha nga të cilat rreth 4,887 ha tokë të kultivuar) dhe dëmi ekonomik është shumë i lartë (rreth 500,350,000 Lek). Ndërsa për bagëtinë situata mund të konsiderohet më dramatike pasi disa nga kafshët u rrethuan me ujë dhe u mbytën (rreth 32,634 kafshë u evakuuan). Lidhur me Qytetin e Shkodrës, numri kryesor i objekteve të prekura ishte në pjesën perëndimore. Ky proces është duke vazhduar që nga viti 2010 dhe ende nuk është finalizuar. Informacioni i hollësishëm në lidhje me pasuritë në rrezik përmbytjeje në nivelin komunal përshkruhet në planin përkatës të menaxhimit të rrezikut nga përmbytjet.³

2.2.5. Infrastruktura dhe Shërbimet

Shërbimet publike në nivel lokal janë elementi më i rëndësishëm që ndikon drejtpërdrejt në cilësinë e jetesës së komuniteteve lokale dhe në mundësitë e zhvillimit social-ekonomik të zonës. Shërbimet që i ofrohen popullatës janë një element i rëndësishëm në të kuptuarit e cilësisë së jetesës të një popullate të caktuar, pasi ajo prek drejtpërdrejt jetën e individëve të shoqërisë.

Në funksionin e infrastrukturës dhe shërbimeve publike përfshihen: shërbimi i furnizimit me ujë dhe i kanalizimeve, shërbimi i transportit dhe i infrastrukturës rrugore, shërbimi i rregullimit dhe administrimit të mbetjeve urbane, shërbimi i ndërtimit, rehabilitimit dhe mirëmbajtjes së ndërtesave arsimore/shëndetësore, shërbimi i planifikimit dhe zhvillimit të territorit, shërbimi i rregullimit dhe administrimit të hapësirave të gjelbra, dekorit etj.

² Plani i Zhvillimit të Territorit - 2017

³ Plani i menaxhimit të rrishtit të përmbytjeve – Rajoni Shkodër 2015

2.2.5.1. Bashkia Kukës

Shumica e banorëve të Kukësit, shërbimet bazë publike i perfiton në qytetin e Kukësit ku gjendet spitali rajonal i Kukësit i cili është qendra më e madhe që mbulon gjithë zonën.

Numri i poliklinikave ka mbetur i pandryshuar gjate viteve te fundit. Viojnë të mbeten mesatarisht 2 poliklinika ashtu si në shumicën e qarqeve të Shqipërisë. Krahasuar me nivelin mesatar në shkallë vendi, për vitin 2013 kemi një poliklinikë për cdo 43.222 banorë, ndërkohë që mesatarja e vendit është 1 poliklinikë për 62.986 banorë. Sidoqoftë këtu duhet marrë parasysh jo vetëm numri i banorëve por edhe shpërndarja e popullsisë sipas zonave. Aksesit i zonave malore në shërbimet shëndetësore mbetet problematik.

Numri i qendrave shëndetësore është 27 në vitin 2020. Krahasuar me mesataren kombëtare prej 7085 banorëve për qendër shëndetësore, kjo zonë pozicionohet më lart pasi rezulton me 3201 banorë për qendër shëndetësore. Por në rast se marrim në konsideratë numrin e fshatrave dhe largësinë e tyre me qendrat urbane një pjesë e madhe e popullsisë së zonave malore e ka mjaft të vështirë aksesin në qendrat shëndetësore.

Në qytetin e Kukësit, përdorimi i transportit publik nga qytetarët për lëvizje ndërmjet zonave të ndryshme është tepër minimal. Pjesa me e madhe e shërbimeve të transportit ofrohet nga sektori privat nëpërmjet shërbimit të furgonave dhe shërbimit taksi. Aktualisht, infrastruktura e fragmentuar ndërmjet bashkive e Njësitve Administrativeve bën që aksesit ndaj këtij transporti të jetë i ulët. Në gjithë zonën mungojnë stacionet e udhëtarëve, c'ka bën që lëvizja e automjeteve dhe pikat e ndalimit të pasagjerëve të vendosen arbitrarisht edhe pa një plan të caktuar të pikave të transportit urban e ndërrurban.

Transporti i udhëtarëve nga Njësitë Administrative drejt Kukësit bëhet në mënyrë jo të rregullt. Edhe pse Transporti nga Kukësi në Njësitë Administrativeve afërta është i shpeshtë pothuaj cdo orë, nuk ka linja të dedikuara për shërbimin e transportit të qytetarëve nga Njësitë Administrative drejt Kukësit.

Linjat kryesore të transportit të udhëtarëve me qendrat kryesore të vendit si Tiranë dhe Durrës bëhen nga Kukësi. Nga Kukësi në drejtim të Tiranës dhe Durrësit transporti është disi më i rregulluar. Janë dy kompani të licensuara që ofrojnë shërbimin ndërqytetas me autobusë. Transporti i udhëtarëve kryhet edhe me mjete si mjete 8+1 dhe mjete taksi, por këto nuk kanë orare të rregullta pasi lëvizin në varësi të nevojave dhe në mes të orareve të autobusëve.

2.2.5.2. Bashkia Tropojë

Shtrirja e gjerë territoriale dhe shpërndarja e popullsisë përbëjnë një vështirësi madhore për bashkinë në ofrimin e shërbimeve publike dhe në hartimin e strategjive gjithëpërfshirëse. Duke marrë në konsideratë numrin e lartë të fshatrave të izoluara, ku infrastruktura inxhinierike mungon, ku arritshmëria është e vështirë, ku shërbimet primare si shëndetësia, arsimit dhe situata socio-ekonomike nuk ofrojnë kushtet optimale, kanë për efekt të shtyjnë një pjesë të mirë të banorëve drejt qytetit ose qendrave më të afërta, të cilat mund të sigurojnë një standard më të lartë jetese.

Mungesa e aktivitete ekonomike të konsoliduara në zonat rurale, mungesa e shërbimeve publike, shërbimeve komunitare dhe infrastrukturore, eksodi rural, kanë për efekte afat gjatë lëvizjen e popullsisë dhe braktisja e fshatrave të izoluara, duket përballur qendrat më të urbanizuara me një nevojë të lartë banesash sociale, ku qendra ekonomike dhe administrative Bajram Curri përballen me vështirësi në përmbushjen e të gjitha kërkesave për banesa sociale.

Sektori shëndetësor i territorit të Tropojës disponon 33 ambulanca dhe 8 qendra shëndetësore (pra një në çdo njësi administrative), si dhe një spital në qytetin e Bajram Currit.

Të gjitha Qendrat shëndetësore mbulohe me mjete të familjes dhe ambulancat ofrojnë shërbime primare, duke pozicionuar spitalin e Bajram Currit si qendër kryesore të shërbimeve të specializuara shëndetësore. Megjithatë shërbimet kryesore si pediatria, kirurgjia, obstetri etj ofrohen në spitalin e Bajram Currit, vlen të theksohet së ka një numër të pa mjaftueshëm të personelit shëndetësor dhe të pajisjeve bashkëkohore. Një pjesë të shërbimeve banoret e kësaj zone e marrin në spitalin e Gjakovës.

2.2.5.3. Bashkia Shkodër

Bashkia Shkodër ka një mbulim të mirë me kopshte, shkolla 9-vjeçare dhe shkolla të mesme. Në aspektin e qendrave shëndetësore, bashkia Shkodër ka një rrjet të mirë të shpërndarjes së qendrave shëndetësore në territorin e saj si rrjedhojë edhe e trashëgimisë institucionale nga bashkimi me komunat e tjera përreth saj. Gjithsesi rregullimi dhe përmirësimi i cilësisë së ndërtesave të këtyre qendrave shëndetësore në të gjithë territorin mbetet evident. Gjithashtu përmirësimi i cilësisë së ofrimit të shërbimit duke shtuar edhe aparaturore shtesë për shërbime të tjera. Në zonën e velipojës duke parë një fluks më të madh të turistëve gjatë verës, mund të shtohet kapacitetet e ofrimit të shërbimit

shëndetësor të cilat do ti vijjnë në ndihmë qytetarëve gjatë sezonit turistik. Këto qëndra duhet të jenë të lidhura me sistemin e rojeve të bregdetit në mënyrë që të ofrojnë një shërbim të koordinuar nda qytetarëve.

2.2.6. Turizmi në Zonën e Influencës

Në bashkitë e zonës së influencës, në aspektin e turizmit spikasin bashkitë e Shkodrës, Tropojës dhe Kukësit. Të treja këto zona kanë potenciale madhore dhe asete të mjaftueshme për të tërhequr turistët, veçanërisht burimet e jashtëzakonshme natyrore në majat e maleve, kullotat alpine, luginat e thella, si dhe liqenet dhe lumenjtë spektakolarë.

Në zonën e Kukësit atraksionet që tërheqin më shumë turistë janë, Liqeni i Fierzës, Shishtavec, Kanionet e Gjallicës, etj. Zona ka gjithashtu histori e kulturë të gjerë, tradita vendase, shumëllojshmëri e produkte bujqësore, kulinari, të cilat janë potenciale mjaft të vlefshme për zhvillimin e turizmit në vend. Ka një gamë të gjerë veprimtarish kuturore-artistike që zhvillohen në këtë zonë, kryesisht në qendrën e saj të Kukësit si manifestime, festivale, konkurse, letrare, panaire, ekspozita, festa e ditë festive.

Tropoja ofron mundësi të mëdha turistike, ndër më të kërkuarit nga turistë shqiptar dhe të huaj. Klima e pastër malore, peizazhet e mëdha dhe të shumëllojshme, mjedisi i pastër dhe i gjelbëruar, mikpritja, traditat etnografike dhe kulturore, monumente t historike dhe natyrore janë vlera që kanë rëndësi ekonomike, turistike, atraktive dhe shkencore. Rrethi ka mjedise të përshtatshme për ngritjen e kampingjeve turistike, turizmit veror dhe dimëror, zhvillimit të sportit të ujit në lumenjtë malor dhe mjediset liqenore, gjuetisë dhe peshkimit. Malet me kontraste të larmishme të relievit të tyre japin mundësi të mira për zhvillimin e sporteve dimërore e verore, si turizmin malor, alpinizmin, ngjitjen, skitë, hipizmin, përdorimin e kajakëve në kanione, peshkimin amator në kanione e lumenjtë e rrëmbyeshëm dhe çiklizmin malor. Lartësia e madhe mbi nivelin e detit, mundëson një klimë të freskët deri të ftohtë por shumë të shëndetshme.

Jetesa në Alpet Lindore Shqiptare dhe Pellgun e Tropojës me një larmi të madhe të peizazhit natyror, folklorit, kanunit, historisë etj paraqet një rajon të mrekullueshëm për zhvillimin e gjeoturizmit malor.

Ndërkohë Shkodra njihet si kryeqendra e veriut dhe është një nga qytetet më të vjetra të Shqipërisë. Një nga pikat më kryesore të qytetit është kalaja e Rozafës, e cila ngrihet mbi një kodër shkëmbore në perëndim të qytetit, e rrethuar nga ujërat e tre lumenjve; Drinit, Bunës dhe Kirit. Pranë qytetit shtrihet liqeni i Shkodrës, më i madhi i gadishullit ballkanik, me dy pika kryesore Shiroka dhe Zogajt të cilat vizitohen shumë nga turistët vendas dhe të huaj. Gjithashtu Shkodra mund të shërbejë si bazë për të vizituar plazhin e Velipojës por edhe qytetin e Lezhës ku gjendet memoriali i vendvarrimit të Skënderbeut.

Në zonën e Vaut të Dejës, ekzistojnë aktualisht firma private që ofrojnë shërbime trageti dhe ekskursionit lumor në itinerarin Koman – Fierzë në periudhën Maj-Tetor. Prania e këtyre aktiviteteve tregon qëndrueshmëri ekonomike të ndërmarrjeve të angazhuara në ofrimin e shërbimeve të ngjashme në itinerarin lumor që shkon nga Vau-Dejës në Koman.

Mbetet për t'u përmendur edhe Lumi i Shalës, i cili është kthyer në një atraksion të rëndësishëm turistik 2 vitet e fundit duke tërhequr një numër të madh vizitorësh vendas dhe të huaj. Lumi buron nga zona turistike e Thethit dhe derdhet në Liqenin e Komanit.

2.2.7. Gjetjet Kryesore

Duke pasur parasysh që zona e interesit është një nga pasuritë më interesante kombëtare në turizëm, dhe te KESH ne mjedisin perreth, duhet të fillojmë me një përmbledhje të shpejtë të kornizës strategjike kombëtare. Për shumë vite turizmi është renditur lart në përparësinë e qeverisë. Strategjitë nga niveli kombëtar në atë rajonal dhe lokal theksojnë objektivin dhe nevojën për ta bërë turizmin si një nga shtysat kryesore për rritjen e PBB-së, zhvillimit të qëndrueshëm dhe mirëqenies së komuniteteve. Duke mbajtur fokusin në projektin tonë, këto strategji kanë peizazh natyror, trashëgimi kulturore dhe historike si tipare të përbashkëta dhe elemente themelore, sa i përket natyrës së parë dhe peizazheve mjaft të paprekura është njëkohësisht thelbësore për strategjitë dhe përpjekjet e marketingut. Por është gjithashtu një shqetësim aktual për ruajtjen dhe zhvillimin e qëndrueshëm. Aktivitetet e sugjeruara në të gjitha strategjitë theksojnë se çdo zhvillim i produktit duhet të sigurojë mirëmbajtjen e peizazhit në formën aktuale. Së dyti, me deri në 35% të turistëve që raportojnë se kultura dhe historia si arsyeja kryesore për të vizituar vendin, aktivitetet që promovojnë aspekte të historisë dhe kulturës, së bashku me investimet në infrastrukturë dalin si përparësi.

Hulumtimi paraprak u krye me qëllim për të kuptuar më mirë se kush janë turistët dhe çfarë kërkojnë. Strategjia Territoriale e Alpeve na jep një pamje të mirë të demografisë turistike dhe veçantive që janë të dobishme në fazën e kërkimit. Gjatë përgatitjes së këtyre strategjive, ekspertët zhvilluan intervista të bazuara në hulumtime dhe pyetësorë që në sintezë mund të na ndihmojnë të informojmë vendimin tonë se kush mund të jenë klientët e nismës së KESH. Hulumtimi tregon se 67% e turistëve që vizitojnë dhe kalojnë në zonën ekonomike të KESH janë të huaj, kryesisht

evropianë, por turizmi i brendshëm është rritur me një ritëm më të shpejtë. Të gjithë vizitorët raportojnë nivele të larta arsimore një interes të larmishëm në zonë. Lidhur me këtë pikë të fundit, ajo që është veçanërisht interesante dhe unike është larmia e kërkesës turistike për aktivitete. Në këtë rajon gamën e aktiviteteve që turistët i përfshijnë në hapësira nga sporte të tilla si ecje, hipur në kalë, rafting, por edhe vizitat në qendra kulturore siç janë vizitat në monumente kulturore dhe vendet për tu angazhuar me komunitetet lokale. Në fakt, shtëpitë lokale janë opsioni i preferuar i akomodimit dhe kohëzgjatja e qëndrimit është më e gjatë se pjesa tjetër e Shqipërisë me më shumë se 4 netë për vizitë.

Edhe pse në fazën fillestare të punës ka disa gjetje që mund të raportohen: 1) edhe pse menjë infrastrukturë shumë herë të pamjaftueshme, numri i turistëve ka qenë në rritje nga viti në vit; 2) Ajo që forcon pikën 1 është larmia e turistëve sipas kombësisë, moshës, arsimit dhe interesit është konstante, duke shtuar shpresën që, nën mjedisin aktual, numrat të vazhdojnë të rriten; 3) duke pasur parasysh natyrën tranzitore të pikave të sugjeruara se ku mund të ndërtohet qendra ose muzeu, ekzistojnë disa vende arkeologjike dhe natyrore të cilat janë të pashpjeguara dhe nëse aktivizohen, mund të pasurojnë nismën KESH; 4) pushteti vendor dhe operatorët turistikë privatë mbeten aktorët kryesorë në fushën e turizmit në këtë rajon; 5) Turizmi në zonë është kryesisht i vetëorganizuar dhe i pa ndërmjetësuar nga aktorë të ndryshëm. 6) Ekziston një vetëdije dhe kulturë ekzistuese si në aktorët lokalë publik ashtu edhe në ato private për parimet e zhvillimit të qëndrueshëm; 7) Ajo që mund të jetë nxitja e suksesit në turizëm në këtë fushë është varg i ndryshëm i produkteve, aktiviteteve, tërheqjet dhe cilësia që ofrojnë një përvojë të ndryshme; 8) Ka mungesë të një rrjeti informacioni dhe kërkimi.

Si përfundim i potencialeve të zhvillimit, një punim për zhvillimin rajonal disa veçori kryesore janë përmbledhur në tabelën e mëposhtme:

Tabela 8 - Tipologjia e Qarqeve Shkodër dhe Kukës

	Karakteristika Hapsinore	Potenciali Socio-ekonomik
Shkodra	Qasja në infrastrukturë është relativisht e mirë, megjithëse qasja mbetet e dobët në krahasim me qendrat kryesore të qarkut, përveç Bashkisë Shkodër. Zakonisht koha për në zonën metropolitane zgjat (+ 2-3 orë). Ekzistojnë lidhje shumë të mira me zonat kufitare (5 pika doganore me Malin e Zi dhe Kosovën), por shumë pjesë të rajonit mbeten larg Tiranës. Zonat urbane janë të vogla dhe me presione relativisht të ulët mjedisore. Terreni është kryesisht malor ose kodrinor në rastin më të mirë dhe shumë i thyer.	Sfond i moderuar ekonomik, por me probleme strukturore, papunësi të lartë; bazuar kryesisht në bujqësi; diversiteti i burimeve natyrore si një bazë e mirë për zhvillimin e turizmit, por kjo e fundit është mjaft e pazhvilluar; ulja e popullsisë. Performanca e ulët ekonomike.
Kukësi	Qarku më malor i Qarkut Shkodër, pjesë e rrethit me qasje të ulët në zonën metropolitane. Nivelet më të ulëta të popullsisë në vend, me një urbanizim të ulët dhe gjithashtu kullimin e popullatës; shumë burime natyrore, shumë cilësore dhe të pashpjeguara, një potencial i madh i pashfrytëzuar për zhvillimin e turizmit; Presionet mjedisore urbane janë të ulëta.	Treguesit kanë shifra shumë të ulëta në shumicën e rasteve, me 30-40% (ose më shumë) nën mesataren kombëtare; Nivele shumë të ulëta të popullsisë; PBB-ja më e ulët në rajon; AUV bazohet kryesisht në bujqësi. Shkalla e punësimit është shumë e ulët, me fokus bujqësinë private;

2.3. Analiza Mjedisore e Zonës së Influencës

Ky seksion trajton në mënyrë të përmbledhur problematikën mjedisore të evidentuar në Zonën e Interesit të tre Hidrocentraleve të Fierzës, Komanit dhe Vaut të Dejës. Të dhënat reth këtyre problematikave janë grumbulluar në bazë të informacioneve të marra nga:

- Materialet e publikuara, të tilla si raporte, plane vendore, Vlerësime Strategjike Mjedisore (VSM);

- Faqet zyrtare të Ministrive/ Agjencive të linjës;
- Takimet e organizuara me palët e interesit, si Bashkitë, Njësitë Administrative dhe OJF.

Përtej evidentimit të problematikave ekzistuese në secilën prej zonave ku shtrihen HEC-et, është kryer një analizë dhe vlerësim i ndikimeve të mundshme që mund të vijnë si rrjedhojë e operimit të hidrocentraleve, kombinuar me kushtet apo problematikat ekzistuese specifike të secilës zonë.

Përmbledhja e problematikave mjedisore në HEC-et e Fierzës, Komanit dhe Vaut të Dejes

Problematikat mjedisore në të tre hidrocentralet kryesisht përqëndrohen në çështjet e mëposhtme:

1. Ndotja nga mbetjet e ngurta – të cilat vijnë si rrjedhojë e hedhjes/ depozitimit në mënyrë ilegale apo edhe nga ndërtimi i vend-depozitimeve zyrtare të Bashkive pranë baseneve liqenore dhe rrjedhave të lumenjve;
2. Ndotja nga shkarkimi i ujërave të ndotura urbane nga banesat, subjekte komerciale, industriale pa trajtim paraprak;
3. Grumbullimi i sedimenteve;
4. Shpyllëzimet;
5. Erozioni;
6. Përmytjet.

2.3.1. Situata Mjedisore dhe Problematikat në Liqenin e Fierzës

Diga e hidrocentralit të Fierzës është ndërtuar në vitin 1978, duke krijuar një liqen artificial me një sipërfaqe prej 73 km² (73,000 ha). Liqeni i Fierzës rrethohet nga komunitete apo fshatra që janë të organizuara në qarkun e Kukësit dhe atë të Shkodrës. Në organizimin në Bashki këto fshatra i përkasin Kukësit, Hasit, Pukës dhe Bajram Currit. Përgjatë liqenit ka këto qendra fshatrash: Kolsh, Kalimash, Kryemadh, Shtanë, Dukagjin, Shtikaj, Shënmri, që i përkasin Qarkut Kukës, dhe më pas në anë të liqenit janë fshatrat e Pukës që i takojnë Qarkut Shkodër: Blerim, Dardhë, Mezi, Poravë dhe Fierzë. Në bregun verior të liqenit në territorin e Hasit ka disa fshatra, si Brahog, Zahrisht dhe Helshan. Aksesit në liqen nga ana e Hasit është më i pakët. Në drejtimin verior të liqenit në vazhdim të rrugës së kombit është fshati i madh Përbreg, ndërsa në drejtimin e Drinit të Zi janë fshatrat Gostil dhe Bushat.

Bashkia Kukës (dhe qyteti) laget nga një sipërfaqe e madhe ujore e Liqenit të Fierzës, por shfrytëzimi dhe kontributi ekonomik që vjen prej këtij aksesit është në nivele jo të larta. Madje, ky kontribut është pakësuar në krahasim me të kaluarën për shkak të: i) perceptimit të ndotjes mjedisore në të, dhe ii) mungesës së investimeve në mbrojtje të mjedisit, rritjes së kapaciteteve ekoturistike. E njëjta situatë paraqitet edhe në zonat e tjera të prekura nga Liqeni i Fierzës.

2.3.1.1. Mbetjet dhe ujërat e ndotura

Problematikat në aspektin mjedisor janë të shumta në këtë liqen. Problemi kryesor i vënë në dukje nga shumë studime dhe gjatë takimeve me palët e interesit janë mbetjet. Gjenerimi i mbetjeve të ngurta ka pësuar një tendencë rritëse në vitet e fundit, veçanërisht për mbetjet shtëpiake dhe tregëtare. Ndërkohë mbetjet inerte kanë pësuar një tendencë ulje në krahasim me mbetjet e tjera, kjo dhe për shkak të mungesës së ndërtimeve masive në zonë. Megjithë përpjekjet nëpërmjet investimeve të ndryshme në fushën e menaxhimit të mbetjeve, përsëri ka një problematikë të theksuar me depozitimin e tyre në vende të papërshtatshme, kryesisht pranë rrjedhave të degëzimeve lumore që derdhen në liqen, apo edhe në afërsi të liqenit.

Konkretisht, dy prej vend-depozitimeve kryesore të qytetit të Kukësit janë fare pranë Liqenit të Fierzës. Vend-depozitimi i mbetjeve të ngurta urbane të Bashkisë Kukës ndodhet në vendin e quajtur "Lama e Fluturës" në fshatin Myç Mameëz, njësi administrative Kolsh, në një distancë rreth 4.5 km nga qyteti i Kukësit. Në pjesën veri-lindore dhe perëndimore të tij ndodhet liqeni i Fierzës, pjesa e Drinit të Zi. Vend-depozitimi ndodhet në një distancë ajrore rreth 400 m nga liqeni dhe kuote rreth 50 m mbi nivelin maksimal të liqenit. Koordinatat e vendodhjes së vend-depozitimit në Myç Mamëz janë E: 450558; N: 4657748.





Figura 21 - Venddepozitimi i Mbetjeve të Ngurta Urbane në Kukës (Myç Mamëz)

Vend-depozitimi i mbetjeve inerte, i ndodhur në një distancë rreth 2 km nga qendra e qytetit të Kukës, kufizohet në pjesën veri-lindore të tij me liqenin e Fierzës. Ky vend-depozitim është tepër i predispozuar për të shkaktuar ndotje në liqen pasi ndodhet në një distancë rreth 50 m ndaj tij. Koordinatat e vend-depozitimit janë E: 452145; N: 4660118.



Figura 22 - Venddepozitimi i Mbetjeve Inerte në Kukës (Myç Mamëz)

Referuar VSM së Bashkisë Kukës është akoma i kufizuar, duke u ofruar vetëm në Bashkinë e Kukës dhe Njësi Administrative Biçaj dhe Kolsh. Kuksi ka një mbulim me shërbimin e pastrimit dhe grumbullimit të mbetjeve rreth 85-90%, ndërsa në Biçaj dhe Kolsh mbulohet vetëm 75% e territorit me këtë shërbim. Në njësitë e tjera vendore dhe fshatrat përreth Liqenit të Fierzës praktikisht nuk ofrohet shërbim i rregullt në grumbullimin e mbetjeve, në këtë mënyrë rriten mundësitë për depozitime ilegale të mbetjeve anës degëve lumore apo edhe direkt në liqën. Depozitimet ilegale të mbetjeve mbeten një problem jo vetëm në Bashkinë e Kukës, por edhe në Bashkitë e Tropojës dhe Fushë-Arrëz. Planet konkrete për pastrimin, grumbullimin dhe depozitimin/ trajtimin e mbetjeve mungojnë, pavarësisht zhvillimit të programeve të ndryshme në këtë sektor. Projekti i financuar nga BE në kuadër të Programit IPA - Asistenca Teknike për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve në Shqipëri, i zhvilluar në vitin 2017-2018, ka kryer studime të thelluara në këtë fushë në Bashkitë Kukës, Tropojë, Fushë-Arrëz, Has, Bulqizë, Klos, Burrel, Dibër dhe Mirditë. Në kuadër të këtij projekti janë evidencuar thujtë të gjitha zonat ilegale të depozitimit të mbetjeve dhe zonat e aprovuara të vend-depozitimeve

nga Bashkitë përkatëse, një pjesë e të cilave ndodhen në distancë të afërt me brigjet liqenore të HEC-eve në këto zona dhe brigjeve lumore. Studimi ka përfshirë detaje rreth gjendjes ekzistuese, kapacitetit mbajtës të tyre, rrezikshmërisë në aspektin mjedisor-social, si dhe plane apo masa konkrete për rehabilitimin e tyre. Zbatimi i tyre është në funksion të punës së Bashkive, të cilat janë përgjegjëse për menaxhimin e mbetjeve në territoret e tyre.

Përveç problematikës së mbetjeve të mbartur prej vitesh nga bashkitë në basenin liqenor të Fierzës, një prej burimeve kryesore të ardhjes së tyre në liqën janë mbetjet që vijnë nga Kosova nëpërmjet derdhjes së lumenjve Drini i Bardhë dhe Drini i Zi. Me autoritetet vendore në Kosovë janë kryer diskutime të shumta rreth një marrëveshje të mundshme bashkëpunimi dhe kontributi financiar për pastrimin e liqenit, por akoma nuk është marrë një veprim konkret në këtë drejtim. Mbetjet e plastikës mbeten një prej problemeve më të mëdha në liqen. Më herët në zonë një sipërmarrje private kryente pastrimin periodik të mbetjeve mekanike (lëtar, karton, plastikë, dru, etj.) në sipërfaqe të liqenit, por tashmë ky aktivitet është pezulluar. Përveç pastrimit të nevojshëm të liqenit nga mbetjet është e nevojshme të ofrohet ndihmë që komunitetet të ndërgjegjësohen për dobinë e pastërtisë së tij dhe shmangien e hedhjes/ apo depozitimit të tyre. Nuk kanë munguar aksionet për pastrimin nga ana e Bashkive, apo edhe shoqërisë civile e qytetarëve, por perceptimi për pastërtinë e liqenit është se ai është i ndotur dhe shpesh mbledhja e mbetjeve pluskuese e dëmton peizazhin e zonave që lagen prej tij. Gjithashtu një çështje tjetër me rëndësi është derdhja dhe shkarkimet e vazhdueshme të ujërave të ndotura urbane dhe industriale në degëzimet e lumenjve përreth basenit të liqenit, madje dhe shkarkime direkte të tyre në liqen. Kjo situatë krijon ndotje të vazhdueshme në Liqenin e Fierzës, duke bërë thuajse të pamundur përdorimin e tij për aktivitete ekoturistike apo edhe për zhvillimin e aktiviteteve të peshkimit, të cilat janë kërkesat të vazhdueshme të komuniteteve, veçanërisht të qytetarëve të Kukësit.



Figura 23 - Pamje ilustruese të Ndotjes në Liqenin e Fierzës

2.3.1.2. Përmytjet dhe Erozioni

Përmytjet dhe erozioni i tokave janë një problematikë tjetër e ngritur gjatë takimeve me palët e interesit, megjithëse më pak shqetësuese në zonat e lagura nga Liqeni i Fierzës. Ky fenomen vihet re më tepër në fshatrat dhe tokat afër liqenit. Një prej zonave ku shfaqet ky shqetësim është zona në pjesën veri-lindore të qytetit të Kuksit, saktësisht e ndodhur midis fshatit Lume dhe Përbreg (Figura 24 më poshtë). Kjo zonë është shumë e ndjeshme nga lëvizjet e kuotës së ujit të liqenit gjatë vitit, të cilat shkaktojnë përmytje të tokave dhe erozion. Ujjet dhe ngritjet e nivelit të ujit variojnë në 20-30 metra, duke favorizuar fenomenin e erozionit, shpyllëzimit dhe përmytjeve jo vetëm në këtë zonë por edhe gjatë brigjeve të liqenit. Zonat e tjera të prekura nga erozioni në brigjet liqenore shfaqen në Figurën 25 më poshtë, shoqëruar me disa foto ilustruese të tyre. Përtej pjesës së erozionit dhe përmytjeve, lëvizja në kuotë e nivelit të ujit vë në dukje edhe mbetjet e ngurta në brigjet e liqenit (Figura 23 më sipër).



Figura 24 - Zona e prekur nga përmbytjet dhe erozioni në fshatrat Lume dhe Përbreg




Figura 25 - Zonat e Prekura nga Erozioni në Liqenin e Fierzës




Figura 26 - Foto të Zonave të Prekura nga Erozio

2.3.2. Situata Mjedisore dhe Problematikat në Liqenin e Komanit


Komani është një tjetër hidrocentral i tipit me digë dhe rezervuar i ndërtuar mbi basenin ujqor të llumit Drin. Hidrocentrali i Komanit është ndërtuar në vitin 1985 duke krijuar një rezervuar me kapacitet rreth 500 milion m³ ujë, ndërsa vëllimi i dobishëm i tij është 90 milionë m³ ujë. Liqeni i Komanit ndahet mes qarqeve të Kukësit dhe Shkodrës, duke prekur më së shumti territoret e Bashkive Fushë-Arrës, Tropojë dhe Pukë.

Problematikat mjedisore të Liqenit të Komanit janë të ngjashme me problematikat në Liqenin e Fierzës, ku ndër më thelbësoret janë problematikat me mbetjet, shkarkimet e ujërave të ndotura në degëzimet e lumenjve apo liqenit, përmytjet dhe erozioni në brigjet e liqenit.

2.3.2.1. Mbetjet dhe Ujërat e Ndotura

Problemi kryesor i vënë në dukje nga studime të ndryshme, si dhe i evidentuar gjatë takimeve me palët e interesit në këto Bashki janë mbetjet. Bashkitë e Tropojës, Pukës dhe Fushë-Arrës kanë problematika të theksuara me menaxhimin e mbetjeve, shërbimin e pastrimit dhe grumbullimit të mbetjeve, gjithashtu edhe me vend-depozitimet zyrtare të përdorura nga këto Bashki. Bashkia Fushë-Arrës është akoma duke konsoliduar përgatitjen e Vlerësimit Strategjik Mjedisor (VSM) për territorin e saj, prandaj dhe masat konkrete për të në këtë drejtim janë më emergjente.

Konkretisht, nëse i referohemi Bashkisë Tropojë kemi problematika të theksuara me grumbullimin dhe depozitim të mbetjeve urbane. Pjesa më e madhe e mbetjeve të ngurta (plastikë, organike, karton/ letër, etj.), si dhe mbetje të tjera të rrëzikshme apo edhe spitalore depozitohen ose derdhen pranë rrjedhave lumore. Këto mbetje më pas shkarkohen në liqenin e Komanit si rrjedhojë e derdhjes së lumenjve të cilët marrin me vete sedimentet dhe mbetjet, duke ndotur



në këtë mënyrë liqenin. Figura 27 më poshtë jep një paraqitje të zonave ilegale të depozitimit të mbetjeve urbane në anë të degëzimeve lumore.




Figura 27 - Depozitimet ilegale të mbetjeve të ngurta në Bashkinë Tropojë

Gjithashtu, vend-depozitimi i mbetjeve urbane në Fierzë, pjesë e territorit të Bashkisë Tropojë, ndodhet i pozicionuar në vend jo të mirë. Ky vend-depozitim është shumë pranë rrugës nacionale Fierzë - Fushë Arrëz (në bjeftin e poshtëm të tij) dhe digës së Liqenit të Fierzës. Koordinatat e vend-depozitimit janë E: 419387; N: 4680471. Për shkak të pjerrësisë së terrenit, vend-depozitimi është i rrezikuar nga erozioni dhe shkarrja e mbetjeve direkt në rrjedhën ujore, sidomos me rritjen e ngarkesës së mbetjeve dhe në rast të ngjarjeve me shi e erë të fortë.



Figura 28 - Venddepozitimi në Fierzë, Bashkia Tropojë

Bashkia e Fushë-Arrëz paraqet të njetjat problematika me mbetjet sikurse Bashkia Tropojë, pavarësisht se gjendja me depozitimet ilegale duket më pak serioze. Mbetjet që gjenerohen në territorin e bashkisë depozitohen në vend-depozitimin tek Kthesa e Krrabit, e cila ndodhet në largësi 5 km nga qyteti i Fushë-Arrëzit. Ky vend-depozitim përdoret që nga viti 2005 dhe aty depozitohen kryesisht qyteti Fushë Arrës dhe Njësia Administrative e Qaf-Malit. Vlen të theksohet se ky vend-depozitim është jashtë standardeve minimale të kërkuara (teknike dhe ligjore) dhe nevoja për ndërhyrje është emergjente. Për të kuptuar situatën ekzistuese në këtë vend-depozitim përveç të tjerave mungon edhe

rrethimi, duke e bërë të aksesueshëm si për kalimtarë të rastit ashtu edhe për kafshët që kalojnë aty. Aktualisht mungon çdo infrastrukturë për trajtimin e ujërave sipërfaqësor dhe liksivjateve dhe mungesa e tyre ka ndikim të lartë ndotës në ujërat e lumit Fan i Madh.

Figurat 29 dhe 30 më poshtë japin një paraqitje të zonave ilegale të depozitimit të mbetjeve urbane në anë të degëzimeve lumore.



Figura 29 - Depozitimet ilegale të mbetjeve të ngurta në Bashkinë Fushë-Arrëz




Figura 30 - Vend-deopzitim ilegal në Bashkinë Fushë-Arrëz

Këto dy Bashki, Tropojë dhe Fushë-Arrëz janë përfshirë rreth 2 vite më parë në Projektin e financuar nga BE në kuadër të Programit IPA - Asistenca Teknike për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve në Shqipëri, i zhvilluar në vitin 2017-2018. Në këtë projekt janë evidentuar thuajse të gjitha zonat ilegale të depozitimit të mbetjeve urbane sikurse është treguar në figurat më sipër. Studimi ka përfshirë detaje rreth gjendjes ekzistuese të këtyre zonave, kapacitetit mbajtës të tyre, rrezikshmërisë në aspektin mjedisor-social, si dhe plane apo masa konkrete për rehabilitimin e tyre. Megjithatë, zbatimi masave menaxhuese dhe rehabilituese për këto zona të depozitimit të mbetjeve është në funksion të punës së Bashkive, të cilat janë përgjegjëse për menaxhimin e mbetjeve në territoret e tyre.

Përtej problematikave me mbetjet e ngurta, këto Bashki sikurse pjesa më e madhe e bashkive në territorin e Shqipërisë paraqesin shkarkime të ndryshme të ujërave të ndotura urbane dhe industriale në degët e lumenjve. Një aspekt tjetër i rëndësishëm për tu përmendur janë dhe problematikat e ndryshme me industrinë nxjerrëse të mineraleve në këto zona, të cilat shpesh herë depozitojnë materiale të ndryshme dhe mbetje inerte pranë degëzimeve lumore. Në këtë mënyrë, uji i lumenjve ndotet me sasi të konsiderueshme të metaleve të rënda dhe përfundon në ujin e liqenit, ku dhe kryen ndotjen më të madhe dhe dëmtime të ekosistemit apo biodiversitetit ujor.

Evidentuar nga takimet e zhvilluara me palët e interesit në kuadër të këtij projekti, një zonë problematike që lidhet me Liqenin e Komanit është dhe zona tepër e frekuentuar së fundmi për qëllimit turistike, Lumi i Shalës. Kjo zonë paraqet problematika të theksuara në lidhje me menaxhimin e mbetjeve dhe shkarkimet e ujërave të ndotura pasi nuk ka asnjë infrastrukturë mbështetëse për të parandaluar ndotjen. Mungon infrastruktura e grumbullimit të mbetjeve dhe pastrimi i vetëm që kryhet në këtë zonë ndërmerret kryesisht nga subjektet private që operojnë në lumin e Shalës, qytetarët në zonë apo vizitorët, si dhe OJF-të të cilat angazhohen vazhdimisht për pastrimin e mbetjeve.

2.3.2.2. Përmbytjet dhe Erozioni

Përmbytjet dhe erozioni i tokave janë një nga problematikat kryesore të liqenit të Komanit. Ky fenomen vihet re në disa zona, kjo për shkak dhe të interferencës me dy HEC-et e tjerë, Fierëza dhe Vau i Dejës. Një prej zonave ku vërehen përmbytje dhe erozion është zona rreth fshatit Dushaj. Kjo zonë paraqet problematika në rastet kur kemi periudha me shira të mëdha, e cila ndërlikohet edhe më tej me shkarkimet që kryhen nga Liqeni i Fierzës në afërsi të tij. Niveli i ujit mund të rritet përnjëherë duke përmbytur kështu tokat bujqësore të fshatit dhe duke shkaktuar rritjen e erozionit bregor. Figura 30 më poshtë paraqet pamje ilustruese të kësaj zonë.




Figure 31 – Zonë e Prekur nga Përmbytjet dhe Erozioni në Dushaj, Tropojë




Figura 32 – Zonë e Prekur nga Përmytjet dhe Erozioni në Levrushk, Fushë-Arrëz

E njëjta situatë paraqitet edhe në zonën e fshatit Levrushk, megjithëse në këtë rast ndikimet paraqiten më të ulëta për shkak se zona nuk është e banuar (Figura 31).

2.3.3. Situata dhe Problemet Mjedisore në Liqenin e Vaut të Dejës

HEC Vaju i Dejës është një prej hidrocentraleve më të vjetër në Shqipëri, i ndërtuar në vitin 1975. Vëllimi maksimal i liqenit të Vaut të Dejës është 580 milionë m³, më një sipërfaqe prej 25 km². Ai ngjitet nga gryka e Vaut të Dejës për rreth 27 km në luginën e lumit Drin, deri në afërsi të hidrocentralit të Komanit. Ai ndodhet në qarkun e Shkodrës, duke prekur më së shumti territoret e Bashkive Shkodër, Vaut të Dejës dhe Pukës.

Problematikat mjedisore në HEC-in e Vaut të Dejës janë të ndryshme në krahasim me prolemtikat e HEC Fierzë dhe HEC Komanit. Ndotja nga mbetjet e ngurta evidentohet me pak në liqenin e Vaut të Dejës, megjithëse sikurse është përmendur edhe në dy HEC-et më sipër është një problematikë permanente në Shqipëri. Kalimi i mbetjeve në liqenin e Komanit është i kufizuar pasi sipër tij ndodhet diga e Fierzës dhe Komanit, të cilat akumulojnë pjesën më të madhe të tyre. Ndërkohë që edhe qendrat e banuara apo bizneset përgjatë liqenit të Vaut të Dejës janë më të pakta. Problemet më të mëdha mjedisore janë në pjesën fundore të basenit poshtë digës së Vaut të Dejës, të cilat lidhen me shkarkimin e ujërave të ndotur urbanë dhe industriale. Zona rreth Vaut të Dejës, fshatrave rreth Shkodrë ka popullim të përqëndruar dhe shpesh ujërat e ndotura derdhen direkt lumë. Ky është një problem i ngjitur shpesh nga Bashkia Shkodër dhe institucionet shtetërore.

2.3.3.1. Përmytjet dhe Erozioni

Liqeni i Vaut të Dejës dhe kryesisht zona e bashkimit të lumit Drin me lumin Bunë është një zonë që njihet reshje të shumta dhe shpesh ka probleme me përmytjet. Ngjarja më e freskët e përmytjeve në këtë zonë është në vitin 2010 në zonën e Shkodrës. Në ngjarjen e përmytjes në janar 2010, ngarkesa e ujit në Bunë ishte afërsisht 3,600 m³/s (3,000 m³/s që erdhën nga lumi Drin). Kjo përmytje u shkaktua kryesisht nga shkrija e borës në basenin e lumit Drin. Edhe më dramatike ishte përmytja në dhjetor 2010 për shkak të reshjeve të mëdha të shiut. Në këtë periudhë rajoni i Shkodrës regjistroi rreth 900 mm reshje, që është afërsisht sa gjysma e mesatares vjetore të reshjeve të shiut. Niveli i ujit të Liqenit të Shkodrës arriti nivelin maksimal historik të regjistruar dhe ngarkesa e ujit në Bunë ishte më e lartë se 4,000 m³/s. Përmytja ishte një nga ngjarjet më të mëdha mbahet mend për sa i përket zonës së përmytur, nivelit të ujit dhe kohëzgjatjes së saj në zonë (Mott MacDonald, 2011).




Figura 33 - Ngjarjet historike të përmbytjeve në zonë nga viti 1851 (Mott MacDonald, 2012)

Përmbytja e vitit 2010 ishte ngjarje e rëndë dhe me pasoja të mëdha në aspektin mjedisor dhe social. Ky rast specifik ndodhi si rrjedhojë e kombinimit të faktorëve njerëzorë dhe natyrorë. pasojë e një kombinimi të faktorëve njerëzorë dhe natyrorë. Si shkaqe natyrore mund të përmenden:

- reshjet e mëdha dhe afatgjata në sezonin e dimrit shpesh në kombinim me shkriren e borës në fund të dimrit / fillim të pranverës duke shkaktuar tejmbushje në lumenjtë e Bunës, Drinit, Kir dhe liqenin e Shkodrës,

Si shkaqe të pasojnë si rrjedhojë e faktorëve njerëzorë mund të përmenden:

- çlirimi i papritur i sasive të mëdha të ujit nga rezervuarët e hidrocentraleve dhe kryesisht HEC-it të Vaut të Dejës i cili lidhet drejtpërdrejt me zonën;
- sistemi i kullimit i cili nuk funksionon si duhet në ultësirën e zonës së poshtme të Vaut të Dejës, fshatrave përreth dhe pjesës periferike të Shkodrës.

Përveç problematikave me përmbytjet vihet re dhe fenomeni i erozionit në zonë, i cili është drejtpërdrejtë i lidhur me përmytjet. Veç kësaj digat në lumin Drin kanë krijuar një pengesë për prurjet e sedimenteve dhe materialeve të ngurta të lumit dhe lumenjve të vegjël, duke favorizuar kështu erozionin detar. Kjo situatë sjell gjithashtu ndikime të rëndësishme në ekosistemin e zonës duke shkaktuar ndryshime të qënësishme të cilat duhen studiuar dhe vlerësuar në mënyrë të detajuar për të reflektuar zgjidhje adekuate.

2.3.3.2. Mbetjet

Sipas Raportit "Zbutja e Riskut në vend-depozitime" të vitit 2018 Bashkia Shkodër grumbullon përafërsisht 32,018 ton/vit mbetje urbane të cilat depozitohen në landfillin e Bushatit. Nga kjo sasi mbetjesh, vetëm 60% e tyre grumbullohen nga shërbimi i pastrimit. Në qytetin e Shkodrës mbulohet 90% e zonës me shërbim pastrimi të mbetjeve. Ndërsa njësitë e tjera administrative kanë një mbulim mesatar të territorit me shërbim që varion nga 50-70%. Problemi kryesor ngelen Njësitë Administrative Shalë, Pult dhe Shosh ku si rezultat i distancave të mëdha dhe i kushteve të infrastrukturës rrugore nuk mbulohen me shërbim. Bashkia Vau Dejës po njësoj depoziton mbetjet në landfillin e Bushatit. Mbulimi me shërbim realizohet kryesisht në Njësia Administrative Vau Dejës dhe Bushat dhe pjesërisht në Njësia Administrative Vig-Mnelë dhe Hajmel. Pavarësisht numrit të vogël të banorëve në Njësia Administrative Shllak dhe Temal dhe sasisë së mbetjeve që gjenerohen në këto njësi administrative, mbulimi me shërbim është thujtë pamundur si rezultat i infrastrukturës rrugore mjaft të amortizuar. Ndërkohë, mbetjet që gjenerohen në territorin e Bashkia Pukë depozitohen në vend-depozitim e Fushë Qarrit. Mbulimi i ulët i bashkive me shërbimin e pastrimit, grumbullimit të mbetjeve sjell problematika të shumta në këto zona, duke rritur shkarkimet/ depozitimet e tyre pranë degëve të lumenjve apo edhe pranë liqenit të Vaut të Dejës.




Figura 34 - Vend-depozitimet ilegale në Zonën e Influencës

2.4. Identifikimi i Problemeve dhe Sfidave

Për identifikimin e problemeve dhe sfidave të Njësisë të Qeverisjes Vendore dhe komuniteteve në Zonën e Influencës sa u përket fushave të mbrojtjes së mjedisit, mbrojtjes dhe përfshirjes sociale dhe zhvillimit ekonomik lokal, është përdorur një metodologji mikse që bazohet në:

1. Analiza e dokumentave strategjike, si strategjitë kombëtare, rajonale e lokale si edhe Planet e Përgjithshme Vendore;
2. Analiza e studimeve të ndryshme të realizuara nga organizatat ndërkombëtare e kombëtare;
3. Zhvillimi i intervistave në terren me palët e interesit; dhe
4. Zhvillimi i workshopeve me synim identifikimin e problemeve në Zonën e Influencës.

Duke u nisur edhe nga analiza e mësipërme, problemet dhe nevojat e identifikuara, janë grupuar në katër kategori kryesore:

- 1- Problemeve/sfida në mbrojtjen e mjedisit;
- 2- Probleme/sfida në zhvillimin ekonomik lokal;

- 3- Probleme/sfida në fushën e arsimit;
- 4- Probleme/sfida në fushën e mbrotjes dhe përfshirjes sociale.

Më poshtë vijon një analizë e problemeve dhe sfidave të identifikuara për secilën nga kategoritë e mësipërme.

2.4.1. Mjedisi

Sfidat kryesore në Zonën e Influencës, rreth tre HEC-eve, janë komplekse dhe përfshijnë një sërë problematikash të cilat lidhen me mbetjet, ujërat e ndotura, shpyllëzimet, erozioni dhe përmbytjet.

Këto problematikë kërkojnë përveç investimeve nga KESH, një bashkëpunim shumë të ngushtë me pushtetin qendror dhe vendor. Bashkitë luajnë një rol të rëndësishëm në zgjidhjen e këtyre problematikave.




Figura 35 - Harta e Vend-Depozitimeve të Mbetjeve në Zonën e Influencës

Në rastin e depozitimit të mbetjeve të ngurta pranë degëve të lumenjve dhe brigjeve të liqeneve, bashkëpunimi me Bashkitë luan një rol thelbësor. Bashkitë duhet të zhvillojnë politika mbështetëse dhe programe për parandalimin e hedhjes së mbetjeve në rrjedha ujore, mbylljen e zonave të rrezikshme të depozitimit (legale dhe jolegale), si dhe rehabilitimin e tyre. Përveç rolit të Bashkive, ka një sërë programesh të financuara nga BE apo organizma të tjerë si GIZ, të cilat kanë në fokus menaxhimin e integruar të mbetjeve. Prandaj, nevojitet që KESH të jetë i informuar në mënyrë të vazhduar mbi programet e ndryshme të zhvilluara në këtë drejtim, duke bashkëpunuar ngushtë me këto programe dhe Bashkitë për të zhvilluar plane të duhura veprimi për përmirësimin e situatës.

2.4.2. Zhvillimi Ekonomik Lokal

Zona e interesit të KESH paraqet probleme të ndryshme si nga pikëpamja ekonomike, me një nga zonat me zhvillim më të ulët në Shqipëri, ashtu si edhe nga pikëpamja e një zhvillimi social të qëndrueshëm, kun përmirësimi i infrastrukturës (kryesisht rrugëve), por edhe i arsimit dhe komponentëve të tjerë socialë.

Ekonomia e kësaj zone është e mbështetur kryesisht në dy qytetet më të mëdha që janë Shkodra dhe Kukësi.

Megjithë rritjen e këtyre dy qyteteve nga ana ekonomike, zona vazhdon të ketë mbështetjen kryesore në ekonominë rurale, e cila nuk jep fitime të mëdha për arsye të fargmentizimit të tokës në parcela që nuk lejojnë një zhvillim bujqësor të kënaqshëm dhe mungesës të investimeve.

Probleme shfaqen gjithashtu edhe në lëvizjen demografike nga zonat rurale në qytetet më të mëdha brenda vendit, por edhe në emigrimin jashtë vendit. Kjo ka bërë që shumë zona rurale të cilat ndodhen larg qyteteve, të kenë pësuar një rënie drastike të numrit të banorëve apo edhe të abandonimit total të tyre. Kjo ka ardhur edhe si pasojë e mungesës së investimeve në infrastrukturë.

Nga intervistat e bëra me Institucionet Vendore lokale dhe aktorë të tjerë në zonë, është shprehur nevoja e përmirësimit të infrastrukturës rrugore në shumë fshatra të kësaj zone si interes primar në zhvillimin ekonomik dhe jo vetëm. Në pamundësi të zhvillimit të rrugëve, është shprehur si alternativë mundësia e shërbimit me mjete lundruese që mund të jenë tragete të vegjël që lidhin këto fshatra buzë liqenit me zonat e tjera, duke bërë në këtë mënyrë që mos mbeten të izoluara dhe të kenë një rritje ekonomike sajë shitjes së produkteve bujqësore apo shtazore.

Shumë prej mbetjeve të cilat derdhen në liqen vijnë gjithashtu si pasojë e një mungese infrastrukturore të arritjes nëpërmjet rrugës të këtyre zonave, të cilat mbeten të izoluara dhe shpesh i derdhen mbetjet e tyre në liqen.

Gjithashtu nga ana ekonomike, disa prej këtyre fshatrave kanë mungesë të tokës bujqësore si pasojë e formimit të liqenit në vitet e kaluara dhe si rrjedhojë, tokat bujqësore të punueshme ndodhen në largësi të fshatrave duke çuar kështu në varfërimin e mëtejshëm të tyre. Një pjesë e tokave të cilat ndodhen afër liqenit kanë pësuar edhe erozion me kalimin e viteve duke e zvogëluar në këtë mënyrë sipërfaqen e tokës të shfrytëzueshme.

Probleme janë shfaqur herë pas here edhe me përmbytjet e krijuara në periudha të caktuara me rritjen e shirave. Veçanërisht problematike paraqitet kjo situatë për Bashkinë e Shkodrës, e cila gjendet në një zonë me prurje të shumta uji edhe nga lumi i Bunës.

Nje problem tjetër i evidentuar nga takimet e bëra me aktorët lokalë dhe rajonalë, ishte ai i prurjeve të mbetjeve të liqeneve dhe sfida e pastrimit apo të masave lehtësuese për uljen e këtij fenomeni. Kjo për tu arritur jo vetëm nëpërmjet investimeve, por edhe nëpërmjet bashkëpunimit me aktorët lokalë, por edhe me fushata sensibilizimi dhe edukimi të popullatës.

Zhvillimi i turizmit në zonë do të kërkonte një përmirësim të strukturave ekzistuese dhe investime afatgjata në strukturë në një zonë me potencial të lartë, por me pak struktura akomodimi, dhe që nuk janë lehtësisht të arritshme nëpërmjet infrastrukturës ekzistuese.

Investime në infrastrukturë apo dhe në rrjetet alternative të transporti, siç mund të jetë transporti ujor, kërkojnë një bashkëpunim të ngushtë edhe me Institucionet Vendore dhe Rajonale.

Bashkëpunimi midis të gjitha palëve të përfshira do të sillte edhe një sinergji tjetër në rajon, por edhe qëllime të përbashkëta për përmirësimin e kushteve socio – ekonomike të banorëve dhe shkëmbim informacioni që do të sillte padyshim edhe në arritjen e disa objektivave të përbashkëta.

2.4.3. Arsimi


Kjo pjesë e raportit bazohet në një **metodologji të dyfishtë**: mbledhje të dhënash nga burime parësore dhe dytësore si edhe intervista gjysmë të strukturuar. Kjo qasje e dyfishtë garanton një pasqyrim më gjithëpërfshirës të mundësisë për bashkëpunim ndërmjet degëve profesionale dhe KESH. Në total u kryen 4 intervista me profesionistë nga Universiteti Politeknik dhe një shkollë profesionale në mënyrë të gjysmë strukturuar, mënyrë e cila sipas studiuesve të ndryshëm janë mënyra më efektive për tu thelluar në temë me bashkëbiseduesin.

Sipas informacionit të gjendur në faqe zyrtare të Ministrisë së Arsimit, në Shqipëri gjenden 39 shkolla profesionale, nga të cilat dy janë me interes të vecantë për KESH, përkatësisht:

- 1- Shkolla Elektrike "Gjergji Canco" në Tiranë me profile kryesore në Elektrikë dhe Elektronikë dhe
- 2- Shkolla e Ndërtimit "Kol Idromeno" në Shkodër me degë kryesore Teknik Ndërtimi dhe Teknik Hidraulik.

Në nivel universitar, interesi i drejtpërdrejtë i KESH është Universiteti Politeknik i Tiranës dhe përkatësisht degët:

- Gjeodezi në Fakultetin e Gjeologjisë dhe Minierave, nivel Bachelor dhe Master Shkencor;
- Inxhinieri Ndërtimi, Inxhinieri Mjedisi dhe Hidroteknike në Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit (FIN) nivel Bachelor dhe Master Shkencor;



- Inxhinieri Energjitike në Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike në nivel Bachelor, Master Shkencor dhe Doktoraturë;
- IT dhe Informatikë në Fakultetin e Teknologjisë së Informacionit;
- Inxhinieri Mekanike, specifikisht profilizimi i Masterit Shkencor në Energjitikë.

Disa raporte të ndryshme janë hartuar në lidhje me problemet kryesore që hasin studentët shqiptarë në ambientet publike të shkollave profesionale dhe universiteteve. Këto probleme, të miratuara si të tilla dhe nga të intervistuarit për këtë pjesë të raportit, mund të përmbliidhen në disa pika kyce me mundësi angazhimi nga KESH, përkatësisht:

Ambiente të papërshtatshme për mësim:

- Mungesë e auditorëve bashkëkohorë për mësimdhënie;
- Mungesë e bibliotekave të përshtatshme fizike dhe dixhitale;
- Mungesë e hapësirave të përbashkëta si hapësira të gjelbërta.

Mungesë e mjeteve mësimore:


- Mungesë e kabineteve dhe mjeteve demonstrative mësimore;
- Mungesë e software-ëve të update-uara për degët në të cilat janë domosdoshmëri.

Mungesë e financimit për kërkim shkencor:

- Sipas ligjit të Arsimit të Lartë, i miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë në vitin 2015, një nga misionet e arsimit të lartë është integrimi i mësimdhënies me kërkimin shkencor;
- Të dhënat e siguruara nga BIRN nga 11 universitete publike në Shqipëri tregojnë se nga viti 2015 deri në vitin 2019, buxheti i shtetit dhe AKKSHI financuan në total pak më shumë se 110 milionë lekë për kërkimin shkencor në vend, ku UPT ka përfituar 21 milion lekë.

Mungesa e kurrikulës së përshtatshme për kërkesat e tregut të punës:

- Kurrikulat mësimore nuk janë mjaftueshëm të update-uara apo specifike për ndryshimet dhe kërkesat në tregun e punës, përshëmbull, në UPT ka një profilizim "Master Shkencash për Energji të Rinovueshme", por ky i fundit, ndonëse nivel Master, nuk ka akse specifike për lloj të caktuar energjie të rinovueshme (diell, erë, etc) duke zbehur specializimin e studentit;
- Mungojnë programet e strukturuar të praktikave ose janë të limituara për një numër shumë të ngushtë nxënësish.



3. Veprimtaria Aktuale e Korporatës

3.1. Analiza e Performancës Aktuale të KESH

Shoqëria KESH sh.a. synon të ruajë dhe të konsolidojë pozitën në sektorin e prodhimit të energjisë elektrike në Shqipëri duke u përshtatur me ndryshimet në mjedisin e biznesit, përfshirë nevojën për të konsoliduar strategjinë për Përgjegjshmërinë Sociale të Korporatës (PSK). Ndërsa tregjet e energjisë elektrike në rajon bëhen më konkurruese dhe të orientuara nga kostot e arsyeshme, synimi i përgjithshëm i KESH përqëndrohet jo vetëm në rritjen e kapaciteteve dhe modernizimit të Korporatës, por edhe në luajtjen e një roli pozitiv në shoqëri.

Në kontekstin ndërkombëtar, por edhe në atë kombëtar, po bëhet gjithnjë e më e rëndësishme përgjegjësia social-mjedisore e bizneseve. Një gamë e larmishme dhe në rritje biznesesh po adopton strategji PSK si pjesë thelbësorë të modelit të tyre të biznesit. Rritja e ndjeshmërisë së konsumatorëve kryesisht gjatë dy dekadave të fundit e ka bërë PSK-në gati domosdoshmëri dhe Shqipëria nuk përbën përjashtim.

Sektorin e prodhimit të energjisë është nga më të prekurit nga domosdoshmëria për PSK gjithëpërfshirës pasi ndryshimet klimatike, ndotja e ajrit dhe e mjedisit, punësimi, etj., e prekin konsiderueshëm këtë sektor. KESH, prej vitesh është ndërgjegjësuar për efektet mjedisore, sociale dhe ekonomike të veprimtarisë së Korporatës. Së pari, KESH mbetet i përkushtuar për shfrytëzimin racional dhe të qëndrueshëm të burimeve ekzistuese dhe përdorimin e burimeve të reja dhe të rinovueshme të energjisë. Gjithashtu, në çdo aspekt të veprimtarisë së vet, KESH garanton komunitetin dhe brezat e ardhshëm për përkushtimin karshi prodhimit të energjisë së gjelbër dhe kryerjen e funksionit të Korporatës me integritetin mjedisor.

Përveç parimit të prodhimit të energjisë së pastër, gjatë viteve të fundit, KESH, përveçse ka operuar në përputhje me legjislacionin kombëtar social dhe mjedisor, ka marrë edhe masa për të përmbushur standardet e direktivave të BE-së. Këto masa janë të përfshira në Planin e Veprimit Mjedisor dhe Social (ESAP), pjesë e marrëveshjes së huasë me Bankën Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH). Masat raportohen rregullisht dhe po zbatohen në mënyrë rigoroz nga Departamenti Strategjik brenda KESH. Plani i veprimit i mësipërm përfshin masa në nivele të ndryshme, të tilla si zhvillimi i një sistemi të menaxhimit të cilësisë; përmirësimi i angazhimit të palëve të interesuara dhe përgatitja / zbatimi i një politike të burimeve njerëzore; monitorimi i parametrave mjedisorë; investimet specifike në HEC-e; organizimi i veprimtarive sociale, etj.

Viti 2016 shënoi një hap të rëndësishëm në KESH sa i përket kriterëve mjedisore dhe sociale, pasi u ratifikua marrëveshja e huasë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) për financimin e projektit për ristrukturimin e KESH për të arritur qëndrueshmëri afatgjatë. Sa i përket aspektit mjedisor, në zbatim të parimeve të Sistemit të Menaxhimit të Mjedisit, sipas standartit ndërkombëtar ISO 14001, KESH ndjek politikën social mjedisore si më poshtë:

- Aktivitetet në njësitë e KESH-it duhet të jenë në përputhje me ligjet, rregulloret dhe kërkesat e tjera mjedisore të aplikueshme të Republikës së Shqipërisë.
- KESH menaxhon në mënyrë rigorozë impaktet në mjedis dhe shëndetin e punonjësve për një zhvillim të qëndrueshëm të performancës së tij social mjedisore: – duke parandaluar shkarkimin e substancave që dëmtojnë mjedisin (tokë, ajër dhe ujë); – duke minimizuar ndotjet dhe reduktuar ato që në burim si dhe mundësinë për riciklim të tyre; – duke përmirësuar burimet ekzistuese nëpërmjet planifikimit e shfrytëzimit të kujdesshëm dhe krijimit e burimeve të reja gjeneruese; – duke mbështetur inovacionin teknologjik për të zbutur impaktet mjedisore gjatë aktiviteteve të veta.
- KESH i kushton kujdes të veçantë monitorimit dhe kontrollit të impakteve gjatë aktiviteteve prodhuese në njësitë e saj të prodhimit.
- KESH trajnon punonjësit me qëllim ndërgjegjësimin për mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit dhe merr masat e nevojshme që të sigurojë që çdo punonjës i korporatës të zbatojë normat e rregullat ligjore për sigurinë në punë gjatë aktiviteteve në një njësi.
- KESH siguron transparencën dhe informimin e komunitetit lokal dhe shoqërisë civile për vlerësimet social mjedisore të investimeve të reja me fondet e veta apo të huaja.
- Çdo punonjës i korporatës është përgjegjës për zbatimin e parimeve të përgjithshme të kësaj politike dhe për arritjen e rezultateve konkrete në menaxhimin për mbrojtjen e mjedisit.



- KESH mbetet i angazhuar për bashkëpunim me institucione, apo kompani të tjera për zbatimin e praktikave më të mira për mbrojtjen e mjedisit.

Pra KESH, operon sipas praktikave më të fundit të menaxhimit mjedisor me qëllim minimizimin e impaktit në mjedis dhe i jep përparësi aplikimit të procedurave për përdorimin eficient të energjisë. Në aspektin **social mjedisor**, fokus i këtij raporti, KESH përmbush detyrimet sociale që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi dhe marrëveshjet me palë të treta, por mbi të gjitha bazohet në tendencën e shoqërisë për të qënë gjithnjë e më aktive në shoqëri. Me lidhjen e marrëveshjes me BERZH-in në 2016, u strukturua edhe përgjegjësia sociale e KESH, me nismat e mëposhtme kyce:

2017 – Krijim i Njesisë për Përgjegjshmërinë Mjedisore dhe Sociale me ekspertë mjedisorë dhe socialë;

2017 – Filloi raportimi i përvitshëm për ceshtje mjedisore dhe sociale tek BERZH;

2018 – Krijimi i një buxheti specifik për Njësinë për Përgjegjshmërinë Mjedisore dhe Sociale;

2019 – U adoptua "Action Plan për Realizimin e Aktiviteteve Sociale";

2020 – Hartimi i Strategjisë PSK.

Me këtë qëllim, vit pas viti janë organizuar edhe aktivitete të ndryshme me qëllim mbrojtjen e mjedisit në komunitetet rreth HEC-eve si edhe për pastrimin e tyre. Këto aktivitete mund të konsiderohen relativisht të vakta duke pasur parasysh synimin e Korporatës për rritjen e përfshirjes gjatë 2021 në bazë të një strategjie të mirëfilltë social-mjedisore. Aktivitetet e 2020 si më poshtë:

Tabela 9 - Përmbledhje e Aktiviteteve Mjedisore të ndërmarra në kuadër të Përgjegjshmërisë Korporative 2019

Periudha kohore	Përshkrimi i Aktiviteteve
Tremujori I	<p>22 Mars "Dita Ndërkombëtare e Mbrojtjes së Ujit"</p> <p>Aktivitet sensibilizues dhe ndërgjegjësues për pastrimin e brigjeve në lumin e Valbonës dhe pranë Liqenit të Fierzës. Aksion pastrimi me shkollat e mesme të Tropojës.</p>
Tremujori II	<p>17 – 18 Prill "Aksion Pastrimi HEC - Koman"</p> <p>Aksion pastrimi i baseneve të HEC-it të Komanit.</p> <p>5 Qershor "Dita Botërore e Mjedisit"</p> <p>Aktivitet me nxënës të shkollave të mesme të Shkodrës dhe Kukësit për rëndësinë e energjisë së rinovueshme dhe ndërgjegjësim mbi mënyra për përdorimin me efikasitet të energjisë elektrike.</p>

Tremujori IV	24 Nëntor "Dita Ndërkombëtare e mbjelljes së pemëve" Mbjellje pemësh në disa lagje të qytetit të Tropojës.
-------------------------	--

Sa i përket aspektit social, Njësia organizon aktivitete edukative në HEC-e apo në shkolla të qarkut të Shkodrës e Tiranës si edhe kontribuon në mënyrë materiale në institucione të ndryshme në zonë.

Për shëmbull, gjatë vitit 2019 janë organizuar aktivitetet si më poshtë:

Tabela 10 - Përmbledhje e Aktiviteteve të Ndërmarrta në Kuadër të Përgjegjshmërisë Korporative

Periudha kohore	Përshkrimi i Aktiviteteve
Tremujori I	5 Mars "Dita Botërore e Eficiencës së Energjisë" Aktivitet mësimor teori-praktikë me shkollën e mesme profesionale "Gjergj Canco" në HEC Vau Dejës.
	22 Mars "Dita Ndërkombëtare e Mbrojtjes së Ujit" Aktivitet sensibilizues dhe nërgjegjësues për pastrimin e brigjeve në lumin e Valbonës dhe pranë Liqenit të Fierzës. Aksion pastrimi me shkollat e mesme të Tropojës.
Tremujori II	7 Prill "Dita Botërore e Shëndetit" Organizimi i një vizite edukative me rastin e 7 Prillit, Ditës Botërore të Shëndetit, në njësinë-prodhuese HEC Vau i Dejës me femijët e punonjësve të KESH sh.a.
	15 Maj "Dita Ndërkombëtare e Ndryshimeve Klimaterike " Organizimi i një ore mësimore edukative me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Ndryshimeve Klimaterike në Shkollën e Mesme të Bashkuar "LUCE Agraja" Dajç, Shkodër.
Tremujori III	4 Korrik "Dita kundër përdorimit të qeseve plastike" Organizimi i një aktiviteti në Bashkëpunim me Agjensinë Eper Center , Me rastin e Datës 4 Korrik Ditës kundër përdorimit të qeseve plastike. Shpërndarja e fletë palosjeve për ndërgjegjësim, cantave beze, etj.

	Përdorimi i cantave biodegraduese në Koman, ndërgjegjësim dhe sensibilizim i komunitetit dhe turistëve në lidhje me qeset plastike.
Tremujori IV	1 Nëntor Vizitë me shkollën e mesme profesionale "Karl Gega" në HEC Vau Dejës Organizimi i një vizite mësimore në Hec Vau Dejës me nxënës dhe mësues të shkollës së mesme profesionale "Karl Gega".
	21 Nëntor Vizitë me shkollën 9-vjeçare "Skënder Çaçi" në HEC Vau i Dejës Vizitë mësimore në Hec Vau Dejës me nxënës dhe mësues të shkollës 9-vjeçare "Skënder Çaçi". Kërkesë e ardhur në KESH sh.a nga vetë shkolla për realizimin e këtij aktiviteti. <i>*(Ky aktivitet ishte parashikuar të zhvillohej më 7 Nëntor, por për shkak të kushteve të pafavorshme atmosferike, u vendos të zhvillohet më datën 21 Nëntor).</i>
	24 Nëntor "Dita Ndërkombëtare e mbjelljes së pemëve" Mbjellje pemësh në disa lagje të qytetit të Tropojës.

Vlera e aktiviteteve dhe investimeve të mësipërme për vitin 2019 ishte **1,126,680.00 ALL**.

Në krahasim me vitin 2018 kur u shpenzua **152,500.00 ALL**, kjo shënon një **rritje të trefishtë** buxhetore si edhe rritje të konsiderueshme në aktivitetin e Njesisë.


Përveç nismave të mësipërme mjedisore dhe sociale, KESH ka investuar edhe në përmirësimin e disa aspekteve të brendshme të Korporatës nga të cilat fillon përgjegjësia sociale e KESH, përfshirë **Sigurinë në Punë dhe Shëndetin**. Përgjegjësitë e Korporatës Elektroenergjitike Shqiptare për sigurinë dhe shëndetin në punë janë në përputhje me rregulloret dhe normat shtetërore të sanksionuara në Rregulloren e Sigurimit dhe Shfrytëzimit Teknik për Impiantet, Pajisjet dhe Instalimet elektrike. Në zbatim të kësaj rregulloreje, KESH ka bërë parashikimet e veta në strukturën e vet organizative, duke integruar funksionet përkatëse në nivel Qëndror dhe Njësi Prodhimi. Qëllimi i sistemit të menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit në punë është rritja e sigurisë së punonjësve në ambientet e punës dhe mbrojtja e shëndetit e mirëqënien e tyre dhe personave të tjerë (publikut) që mund të ekspozohen ndaj risqeve të aktivitetit të KESH. Ndërkohë që njohja dhe zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe ruajtës së shëndetit në punë është detyrë e përhershme e personelit të KESH, menaxhimi i Sistemit të Sigurisë dhe Shëndetit në Punë përfshin në vetvete përmirësimin e vazhdueshëm dhe shërbim gjithnjë e më të kualifikuar ndaj të punësuarve në nivelin e kërkesave të kohës.

Mbi të gjitha, është me rëndësi kalimi në cdo fazë duke u bazuar në qëllimin kryesor të korporatës, objektivat e biznesit të saj, si edhe kapacitetet. Në mënyrë që të strukturohet në përputhje me dokumentacionet e mësipërme puna e KESH, është i nevojshëm trajnimi dhe njohja e punonjësve me udhëzimet e mësipërme si edhe me mënyrën e raportimit të progresit në aspektet e PSK-së që njihet globalisht, kryesisht ISO 26000 për përgjegjësinë sociale dhe raportimi GRI.

Përveç dokumentave të mësipërme dhe standardeve ndërkombëtare për përgjegjësinë për komunitetet jashtë bizneseve/korporatave, rëndësi gjithmonë e më të madhe ka marrë trajtimi i punonjësve të bizneseve dhe diversifikimi i 'work force'. Investimi në rritjen e diversitetit në vendin e punës ndihmon kompanitë të evoluojnë, të inovojnë dhe të zgjidhin problemet në mënyrë më efektive. Studimet më të fundit vërtetojnë se rritja e diversitetit ka edhe benefite të

konsiderueshme financiare. Hulumtimi më I fundit nga kompania prestigjioze e konsulencës McKinsey vërtetoi se kompanitë me diversitetin më të lartë gjinor, racor dhe etnik kanë më shumë të ngjarë të kenë kthime financiare mbi mesataren e industrisë në të cilën bëjnë pjesë.⁴ Në rastin e KESH, rritja e diversitetit gjinor në Korporatë, është me rëndësi të vecantë duke pasur parasysh disbalancën e tanishme.

Ndarja Gjinore e Punonjesve KESH



Nga të cilët, 219 punojnë në KESH – Qendër dhe 434 në tre HEC-et. Pra, femrat përbëjnë afërsisht 23% të forcës së punës së KESH (Qendër + HEC-e). Sic mund të pritet, përqindja e femrave në HEC-e është konsiderueshëm më e ulët se ajo në Qendër, përkatësisht, nga 152 femra që punojnë në KESH, 99 punojnë në Qendër.

Një shpjegim I mundshëm është fakti se në Shqipëri sektori I energjisë është I dominuar nga meshkujt, një trend që ndonëse po thyhet në vende të tjera, nuk ka arritur të ndryshojë në Shqipëri për shkak të mungesës së nismave për përfshirje më të madhe të femrave në sektor duke filluar nga krijimi I incentivave për arsimimin e duhur për këto fusha për studentet femra.

Për rritjen e diversitetit gjinor brenda KESH, janë të rëndësishëm 3 faktorë kryesorë:

1. Sigurimi I kompensimit të njejtë për meshkuj dhe femra me nivel edukimi dhe eksperience të njejtë;
2. Sigurimi I një ndarjeje gjinore më të drejtë në pozicione drejtimi në KESH-Qendër e kryesisht në HEC-e;
3. Investimi në incentivim për përfshirje më të madhe të femrave në sektor duke filluar nga bashkëpunimi me Universitetet përkatëse, etc.

Duke qënë se KESH ka investuar tanimë në përgatitjen dhe internalizimin e një Kodi Etik I cili është pjesë themelore e veprimtarisë të brendshme dhe të jashtme të KESH, si edhe duke pasur parasysh investimin në një qasje më strategjike karshi PSK-së së shoqërisë, investimi në rritjen e diversitetit gjinor në vendin e punës duhet të jetë gjithashtu një përparësi kyce.

Sa i përket arsimit dhe bashkëpunimit me Universitetin Politeknik të Tiranës, një bashkëpunim i pa strukturuar ka ekzistuar prej vitesh. Për shëmbull, në gjimnazet profesionale janë kryer herë pas here leksione mbi punën e KESH nga profesionistë të Korporatës, ndërsa me Universitetin Politeknik janë firmosur disa marrëveshje bashkëpunimi ndër vite, me e fundit e firmosur në Qershor të vitit 2019, me pikat e mëposhtme si kyce për bashkëpunim:

- **Diploma, mikroteza dhe disertacione** ku KESH do të facilitojë kërkimin shkencor në ambientet e administruara nga KESH dhe në aktivizimin e specialistëve të KESH në udhëheqjen e këtyre punimeve;
- **Projekte, ekspertiza, studime, kërkime** ku të dy palët do të inkurajojnë dhe organizojnë projekte, studime, ekspertiza dhe kërkime në fusha të ndryshme me interes të përbashkët;
- **Formimi i vazhdueshëm dhe rekrutimi i specialistëve** ku:

⁴ McKinsey & Company, “Why Diversity matters”, 1 Janar 2015.

- Donacione direkte për konferenca të profesionistëve të fushave me interes për EPS, si "Ditët e Teslës", "Nata e Hulumtuesve", Konferenca për Energjinë dhe Inxhinierinë etj.

Shëndetësi:

- Rinovim i disa prej spitaleve kryesorë në Serbi dhe dhurim i aparatëve të ndryshëm e të nevojshëm shëndetësor;
- Suport monetar i vazhdueshëm për skuadra paraolimpike të sporteve të ndryshme.

Kulturë:

- EPS është 'mik' i disa institucioneve kryesore kulturore në Serbi, si Muzeu i Shkencave dhe Artit, Muzeu i Artit Modern, Teatri Kombëtar në Beograd, Muzeu "Nikola Tesla", etj.;
- Rikonstruksion i Tempullit të Shën Savës në Beograd dhe donacione për rikonstruksion të objekteve fetare në Serbi.

3.2.2.2. Rasti i KEDS në Kosovë

KEDS organizon aktivitete të ndryshme PSK prej vitit 2013 kur ka filluar operimin. Ndonëse këto aktivitete nuk janë të strukturuar në raporte vjetore për PSK-në, aktiviteti i gjërë i KEDS është i mirëpasqyruar në mediat sociale të shoqërisë. Aktivitetet mund të klasifikohen në tre grupe kryesore:

Edukim:

- Akademia KEDS, themeluar në 2014, është iniciativë e KEDS me qëllim kontributin në zgjidhjen efektive të problemit akut të mungesës së oportuniteteve të punësimit së të rinjve në Kosovë. KEDS organizon stazh njëvjeçar për 150 studentë ekselentë Kosovarë (120 nga Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike të Universitetit të Prishtinës dhe 30 nga gjimnaze mekanike) dhe ofron mundësi punësimi për disa prej stazhierëve;
- Akademia KEDS KIDS organizon kurse në elektrikë dhe robotikë për 30 fëmijë të moshave 7-10 vjec;
- KEDS nënshkruan "Parimet për Fuqizimin e Gruas" në Mars të 2020 me qëllim rritjen e përqindjes së femrave në pozicione drejtuese brenda KEDS;
- Prezantim i përvitshëm i një aspekti të profesionit të inxhinierisë ndërmjet organizimit të një vizite në hapësirat e KEDS për 50 vajza nga klasa I-V të shkollës "Xemajl Mustafa" në Prishtinë;
- Dhurim i 300 librave për 2 qendra për të rinj në Prishtinë;
- Dhurim i laboratorëve informatikë për 3 shkolla në Deçan.

Sociale:

- Dhurata të përvitshme gjatë festave të fundvitit për nxënës me vështirësi socio-ekonomike;
- Dhurim i 10 tabletave me qindra libra për fëmijët e fshatit "SOS".

3.2.3. Praktikrat më të mira Europiane

Për të edukuar vendimarrjen e KESH sa i përket strukturimit të PSK-së brenda Korporatës, ky raport përmban informacion edhe nga aktivitetet e disa prej kompanive më të rëndësishme Europiane dhe standardeve që ato kanë adoptuar dhe praktikave që ndjekin. Në ndryshim nga KESH, këto kompani, përkatësisht ENEL në Itali, ENGIE në Francë dhe STATKRAFT në Norvegji, nuk janë vetëm prodhues energji dhe kanë një gamë më të diversifikuar prodhimi. Sidoqoftë, duke qenë se të tre vendet janë ndër 5 prodhuesit kryesorë të energjisë hidrike në Europë, me Norvegjinë të renditur në vend të parë.

3.2.3.1. Rasti i ENEL në Itali

ENEL është furnizuesi më i madh i energjisë elektrike në Itali, ku i shërben më shumë se 27 milionë konsumatorëve, pra rreth 40% të popullsisë së Italisë. ENEL në Itali gjeneron energji nga resurse të ndryshme si energji hidroelektrike, energji gjeotermale, energji termoelektrike dhe energji fotovoltaike. Nga 27 GW e prodhuar, 14 GW vijnë nga burime të rinovueshme. Parimi i ENEL sa i përket PSK-së është "Të jesh i qëndrueshëm sot domethënë të jesh kompetitiv nesër" (sustainable today means competitive tomorrow). Një nga aspektet më interesantë të PSK-së së ENEL është përfshirja e elementëve "Environmental and Social Governance" (ESG) përgjatë tërë zinxhirit të veprimtarisë së kompanisë dhe hartimi i strategjisë për PSK-në në përputhje me standardin AccountAbility 1000 për angazhimin e grupeve të interesit. Pra, ENEL ka internalizuar standarde ndërkombëtare jo vetëm në aspekte specifike mjedisore, por edhe për të informuar vendimet e shoqërisë në veprimtarinë sociale të saj. Prej vitit 2004, ENEL është pjesë e Kompaktit Global të Kombeve të Bashkuara (UN Global Compact) ku theksohet rëndësia e integritetit të elementëve për zhvillim të qëndrueshëm përgjatë tërë zinxhirit të biznesit të kompanive. PSK-ja e grupit ENEL ka për qëllime kryesore 1. Përafrimin e modelit të biznesit për t'ju përshtatur ndryshimeve klimaterike dhe 2. Prodhimi i energjisë së rinovueshme dhe të qëndrueshme në afatgjatë.

ENEL harton plane dy-vjetore me qëllim krijimin e sinergjive ndërmjet krijimit të vlerës për kompaninë dhe për komunitetet ku kjo e fundit operon. ENEL njihet për organizimin e aktiviteteve të shumta dhe dialogut me palët e interesuara dhe për studime të kujdesshme të kontekstit social dhe ekonomik në zonë.

Qëllim kryesor i PSK-së së ENEL është krijimi i energjisë së gjelbër dhe të qëndrueshme. Kështu, ENEL ka ndërmarrë disa nisma në Itali:

Sociale:

- Dhënia e "Bonuseve Sociale" ku që nga viti 2008, ENEL ofron zbritje për klientët vendas të cilët janë duke përjetuar vështirëse financiare, pjesë e një liste të përpiluar nga autoritetet vendase. Këto bonuse sociale vlejnë edhe për ato klientë të ENEL të cilët përdorin në mënyrë të vazhdueshme pajisje mjekësore të cilat bazohen mbi energjinë elektrike për të operuar. Në vitin 2019, 512 000 klientë kanë përfituar nga këto bonuse në Itali.
- Dhurimi i një makinerie avant-garde të prodhuar nga Tesla për spitalin pediatrik "Buzzi" të Milanos, duke siguruar krijimin e një reparti pediatrik me makineri të cilat nuk rrezatojnë.
- ENEL dhuron bursa studimi për studente femra në fushat STEM.

Mjedis:

- Në 2019, ENEL lançoi nismën "ZERO Plastics Project" (Projekti për ZERO Plastikë), në të cilën u përfshinë të 10 000 punëtorët e ENEL në Itali. Gjatë këtij viti, grupi arriti të uli konsiderueshëm dhe synon të eliminojë totalisht përdorimin e objekteve plastike një përdorimëshe deri në vitin 2021.
- ENEL menaxhon projektin FUTUR-e, i cili ka për qëllim rikualifikimin e 23 termocentraleve për prodhim energjie të gjelbër. Ky projekt bashkëpunon ngushtësisht me administratat lokale, kompanitë vendase dhe shoqërinë civile dhe promovon inovacionin dhe energjinë e gjelbër.
- Në 2014 ENEL lançoi 114 projekte për mbrojtjen e specieve dhe të biodiversitetit, me vlerë 8.9 milionë Eur dhe me operim kryesisht në Brazil, Kili, Spanjë dhe në Itali.
- Nëpërmjet iniciativës ENEL-X: e-mobility, kompania ENEL në Itali, nëpërmjet nënstacioneve për karikim të gjelbër, arriti të krijojë rreth 10 mil KWh energji me anë të garantimit të mbi 800 000 karikimeve nga Janari i 2018 deri më Dhjetor të 2019.

3.2.3.2. Rasti i ENGIE në Francë

ENGIE udhëhiqet nga qëllimi për të "përsheptuar tranzicionin drejt një ekonomie neutrale sa i përket karbonit (carbon-neutral economy)", një qëllim drejt së cilit u rivendos vëmendja gjatë takimit më të fundit të aksionerëve të grupit më 14 Maj, 2020. ENGIE është i vendosur për t'u bërë lider në tranzicionin drejt energjisë së gjelber dhe në Shkurt të 2020,

grupi përcaktoi 19 objektiva të reja për në vitin 2030. Përcaktimi i 19 objektivave bën të mundur monitorimin rigoroz të PSK-së së grupit. Objektivat përputhen plotësisht me "17 Qëllimet për Zhvillim të Qëndrueshëm për 2030" të përcaktuara nga Kombet e Bashkuara. ENGIE publikon raportime vjetore në 3 fusha: social (me fokus të dhënat e personelit të kompanisë), mjedisor (me fokus efektet mjedisore të kompanisë dhe mitigimin e tyre) dhe shoqëror (me fokus PSK-në e kompanisë).

Sociale:

- Në 2019, ENGIE dhuroi një fond prej 6 milion Eur për "Fonds de Solidarité pour le Logement" (Fondi për Solidaritet në Ndërtim Shtëpish) për fonde për ndërtim apo rindërtim.
- Që prej vitit 2011, grupi është pjesë e iniciativës "Live Better" (Jeto më Mirë). Për periudhën 2014-2020, ENGIE ka paguar 100 milion Eur për rinovimin e 250 000 shtëpive të familjeve në nevojë.
- ENGIE ka krijuar shoqërinë "Energy Assistance France" (Ndihmë Elektrike Francë) i cili ka për qëllim përdorimin e talentit dhe njohurive të punëtorëve të tanishëm ose të mëparshëm të ENGIE për të krijuar akses në energji për persona nga vende në zhvillim të cilëve u mungon. Që nga krijimi, kjo shoqëri e ENGIE në Francë ka kryer 147 projekte në 36 vende të ndryshme, duke ndihmuar rreth 1.5 milionë persona për të pasur akses më të sigurt dhe të qëndrueshëm në energji. Vetëm në vitin 2019, Energy Assistance France kreu 23 projekte në të cilat u mobilizuan 37 vullnetarë. Projektet ishin kryesisht të vendosjes së paneleve fotovoltaike në shkolla dhe në ndërtesa shëndetësore si klinika apo spitale në Burkina Faso dhe në Madagaskar.
- Ndërtimi i një qendre për gra të pastreha në Paris, ku mund të strehohen, kurohen dhe mjekohen 200 femra në vit që prej 2019.
- Ndërtimi i një shtëpie për pacientë kanceri afatgjatë në spitalin "Gerard Marchant" në Toulouse.

Mjedis:

- Reduktimi i emitimit të dioksidit të karbonit në - 28.7% në 2018 në krahasim me 2012;
- Rritje e kapaciteteve të prodhimit të energjisë së gjelbër nga 23.7 GH në 2017 në 24.8 GW në 2018.

Edukim:

- Nëpërmjet iniciativës "CIVIGAZ", lancuar në vitin 2015, së bashku me nëpunës social, ENGIE ka edukuar rreth 55 000 familje franceze mbi mënyra të ndryshme për konservim energjie. Vetëm në vitin 2019 kanë përfituar nga ky program 4 000 familje.

3.2.3.3. Rasti i Statkraft në Norvegji

Ndonëse STATKRAFT prodhon energji kryesisht ndërmjet hidrocentraleve dhe të turbinave me erë, të dyja metoda të cilat kanë cilrim të ulët karboni, kompania është koshiente se veprimtaria e saj gjithsesi lë gjurmë në biodiversitet dhe në mjedis, andaj nismat PSK të kompanisë kanë kryesisht për qëllim mitigimin e këtyre efekteve. STATKRAFT-I është i angazhuar të përfshijë standarde të zhvillimit të qëndrueshëm, etik dhe të përgjegjshmërisë sociale në të gjithë aktivitetet e veta, në cdo nivel aktiviteti. Përveç sigurimit të një mjedisi pune të sigurt dhe të shëndetshëm për nëpunësit, STATKRAFT synon të mbrojë mjedisin dhe asetet e ndryshme të komuniteteve ku vepron. Veprimtaria PSK e STATKRAFT drejtohet nga initiative dhe standarde të njohura globalisht, përkatësisht:

- Udhëzimet e OSBE-së për Ndërmarrjet Shumëkombëshe;
- Standardet e Performancës së IFC-së mbi Qëndrueshmërinë Sociale dhe Mjedisore;
- Kompakti Global i Kombeve të Bashkuara mbi të drejtat e njeriut, të drejtat në punë, mjedisin dhe nismat anti-korrupsion.

STATKRAFT, që prej krijimit në Norvegji, mbështet energjinë e gjelbër dhe ka investuar në tranzicionin drejt një ekonomie me karbon të ulët (loë carbon economy). STATKRAFT shikon investimin drejt energjisë së rinovueshme si një nga efektet më pozitive që mund të ketë në shoqëri, pasi energjia e rinovueshme është një pjesë kritike e zgjidhjes

për një të ardhme me energji të pastër dhe të qëndrueshme. Përshëmbull, në vitin 2017, 96.5% e energjisë së gjeneruar nga STATKRAFT ka ardhur nga resurse të ripërtëritshme dhe 91.6% është energji hidrike.

Mjedis:


- Regjistrim dhe hartëzim i llojeve të ndryshme të zogjve të konsideruara në rrezik përgjatë zonës së operimit të "ëind farms" të ndërtuara nga STATKRAFT.
- Krijimi i zonave "no work" gjatë periudhës së ciftëzimit të specieve të efektuara nga veprimtaria e STATKRAFT.
- Hartimi i 2 projekteve kërkimore dhe zhvillimore (R&D) të cilat kanë për qëllim rritjen e kompetencave të kompanisë për mitigimin e efekteve në mjedis të veprimtarisë. Gjetjet e 2 projekteve kanë të bëjnë me optimizimin e temperaturës së ujit dhe të sedimentizimit të HEC-eve në mënyrë që të stimulohet maksimalisht biodiversiteti.
- Restaurimi i habitateve akuatike duke krijuar kalime të reja për peshqit për të siguruar kalimin e salmonit dhe troftës përgjatë lumit Skjoma të Norvegjisë.

3.2.4. Përfundime

Në ndryshim nga kompanitë shqiptare apo rajonale, kompanitë Europiane ndryshojnë në dy aspekte kryesore sa i përket qasjes PSK:

1. Kanë adoptuar dhe bërë pjesë të planeve të biznesit rezoluta apo udhëzime ndërkombëtare vullnetare si ISO 26000 për përgjegjësinë sociale, Kompakti Global i OKB-së apo guidën e Iniciativës Globale për Raportim (GRI) të impaktit në shoqëri të kompanive;
2. Operojnë në bazë të strategjive disa vjecare dhe kryejnë investime të mirëmenduara dhe të konsultuara me institucionet përkatëse vendore.

Sa i përket veprimtarisë PSK, vihet re një strukturë e ngjashme investimesh në 4 grupe kryesore në të gjitha nivelet e kompanive, kombëtare, rajonale ose europiane:



Në shumicën e rasteve, në të dhënat për PSK qoftë në formë raporti apo publikimesh në faqet zyrtare, rëndësi të madhe merr veprimtaria e brendshme e firmës, përfshirë ndarjen gjinore të punonjësve, kodin e etikës së kompanisë dhe veprimtaria e gjelbër. Ndonëse të gjitha i japin rëndësi bashkëpunimit me grupet e interesit, nuk kishte informacion për strukturimin e këtij bashkëpunimi në asnjë nga rastet e para. Ndonëse të gjitha kishin raportim të strukturuar dhe të detajuar mjedisor, nuk ishte e njejtë për aspektin social të PSK-së. Kjo mund të jetë si rrjedhojë e faktit se PSK është jo vetëm vullnetare në natyrë, por edhe një koncept relativisht i ri.

4. Vizioni i Strategjisë së Përgjegjësive Sociale

4.1. Deklarata e Vizionit

Shoqëria KESH sh.a. synon të ruajë dhe konsolidojë pozitën në sektorin e prodhimit të energjisë elektrike në Shqipëri duke u përshtatur me ndryshimet në mjedisin e biznesit, teknologjinë, mundësitë për financim dhe ruajtjen e mjedisit. E ndërsa tregjet e energjisë elektrike në rajon bëhen më konkurruese dhe të orientuara nga kostot e arsyeshme, synimi i përgjithshëm i KESH përqëndrohet në rritjen e performancës, zhvillimin e kapaciteteve dhe krijimin e kulturës së përmirësimit të vazhdueshëm. Për këtë qëllim, shoqëria merr përsipër:

- të fokusohet në veprimtarinë e prodhimit dhe tregtimit të energjisë elektrike, duke ndjekur dinamikën e zhvillimit të tregut dhe garantuar veprimtarinë e vet në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe me parimet e mirëqeverisjes;
- të arrijë cilësi, përsosmëri, inovacion dhe efikasitet në aspektet administrative dhe teknologjike të prodhimit të energjisë elektrike, duke vepruar me respekt, ndershmëri, besueshmëri dhe transparencë përkundrejt klientëve, punonjësve, furnitorëve dhe palëve të tjera të interesuara;
- të angazhohet për garantimin dhe përmirësimin e kushteve të punës duke pasur në fokus shëndetin dhe sigurinë në punë të punonjësve;
- të inkurajojë angazhimin dhe idetë e punonjësve, me qëllim që të rrisë besimin e tyre për të qenë pjesë e shoqërisë, duke identifikuar punonjësit si asete themelore dhe mbështetur zhvillimin e karrierës së tyre;
- të orientohet drejt zhvillimit të qëndrueshëm dhe me përgjegjshmëri të lartë social –mjedisore.

4.2. Misioni

Prodhimi i energjisë së të nesërme, së sigurtë, me inteligjencë dhe me ndikime minimale në mjedis nëpërmjet:

- shtimit të kapaciteteve gjeneruese nga burimet e rinovueshme;
- rritjes së kompetencës së punonjësve dhe besimit të tyre për të qenë pjesë e shoqërisë;
- orientimit drejt komercializimit të shoqërisë;
- shërbimit me përkushtim ndaj shfrytëzimit racional dhe mirëmbajtjen efektive të aseteve prodhuese.

4.3. Qëllimet Strategjike

Qëllimet Strategjike të KESH sh.a. sa i përket përgjegjshmërisë sociale janë si më poshtë:

1. **Angazhimi i vazhdueshëm i palëve të interesit dhe komunitetit në zonën e influencës në përmbushjen e përgjegjshmërisë sociale të KESH**

Çdo Strategji për Përgjegjshmërinë Sociale nisat dhe bazohet tek konsultimi i vazhdueshëm i palëve të interesuara. Qëllimi i KESH është që të ngrejë mekanizmat e nevojshme për të garantuar përfshirjen e palëve të interesit në identifikimin e problemeve apo nevojave dhe ideimin e projekteve që mund të implementohen nga KESH në kuadër të përgjegjshmërisë sociale;

2. **Mbrojtja e Mjedisit dhe orientimi drejt zhvillimit të qëndrueshëm të aseteve prodhuese**

KESH sh.a. prodhon energji me ndikime minimale në mjedis, duke pasur parasysh parimet e zhvillimit të qëndrueshëm dhe me përgjegjshmëri të lartë sociale e mjedisore nëpërmjet zbatimit të procedurave të Sistemit të Integruar të Menaxhimit dhe ato operative sipas standartit ISO 14001 në Njësitë Prodhuese; duke implementuar teknologji "ekologjike të pastra"; si edhe duke respektuar zbatimin e parimeve bazë të mbrojtjes së mjedisit;

3. Mbështetja e Zhvillimit Social dhe Ekonomik në zonën e interesit

Si e pjesë rëndësishme e Strategjisë së Përgjegjshmërisë Sociale, KESH ka si qëllim të implementojë një sërë projektesh që do të adresojnë nevoja të komunitetit duke dhënë ndihmesë në zhvillimin social dhe ekonomik të zonës.

5. Objektivat Strategjike

Për përbushjen e qëllimeve strategjike të sipër-përmendura, janë identifikuar objektivat e mëposhtme strategjike.

Qëllimi Strategjik 1 - Angazhimi i vazhdueshëm i palëve të interesit dhe komunitetit në zonën e influencës në përbushjen e përgjegjshmërisë sociale të KESH.

- Objektivi Strategjik 1.1. – Hartimi dhe miratimi i Planit të Angazhimit të Palëve të Interesit.

Hartimi i këtij plani do të krijojë mekanizamat dhe përcaktojë procedurat se si KESH do të komunikojë në mënyrë të vazhdueshme me Palët e Interesit për të marrë informacion mbi nevojat e komunitetit dhe për të konsultuar me ta iniciativat që planifikon të ndërmarrë.

- Objektivi Strategjik 1.2. – Ngritja e Strukturave Lokale për Konsultimin me Palët e Interesit.

Për të garantuar një angazhim efektiv, sektorit aktual të përgjegjësisë sociale dhe mjedisore të KESH do t'i bashkëngjitet edhe një strukturë lokale në zonën e influencës detyra e së cilës do të jetë komunikimi i vazhdueshëm me palët e interesit.

Qëllimi Strategjik 2 - Mbrojtja e Mjedisit dhe orientimi drejt zhvillimit të qëndrueshëm të aseteve prodhuese.

- Objektivi Strategjik 2.1. – Bashkëpunim me institucionet e tjera publike për të minimizuar ndikimin e përmbytjeve.

Një nga ndikimet më me pasoja mjedisore, ekonomike dhe sociale i veprimtarisë së KESH është ai i përmbytjeve, sidomos në zonën e Shkodrës. Për realizimin e këtij objekti, do të punohet ngushtësisht me institucionet e tjera përgjegjëse duke ndërmarrë një sërë iniciativash për të minimizuar efektin e përmbytjeve mbi komunitetin.

- Objektivi Strategjik 2.2. – Ndhimesë për bashkitë në zonën e influencës për të marrë iniciativa të përbashkëta për pyllëzimin e brigjeve liqenore.

Erozioni që shpesh herë shkaktohet nga shpyllëzimi rrit depozitimet e inerteve në liqene e vështirëson veprimtarinë e KESH. Për këtë arsye, do të studiohen bashkë me organet bashkiake zonat e erozionit dhe do të ndërmerren iniciativa për pyllëzimin e tyre.

- Objektivi Strategjik 2.3. – Bashkëpunim dhe iniciativa të përbashkëta me organet e pushtetit vendor për të adresuar problemin e mbetjeve të ngurta.

Ndotja e ujërave të liqeneve nga mbetjet e ngurta, ujërat e zeza apo edhe mbetjet e rrezikshme është një tjetër çështje që ndikon veprimtarinë e KESH. Prandaj, është e arsyeshme që të mbështeten insituioncet dhe të ndërmerren iniciativa që do të ndihmojnë komunitet për të reduktuar ndotjen e mbrojtur mjedisin.

- Objektivi Strategjik 2.4. – Mbështetje për të prmovuar dhe nxitur zbatimin e parimit të Efiçencës së Energjisë.

KESH, si prodhuesi më i madh në vend i energjisë së rinovueshme, ka si qëllim afat-gjatë prodhimin e enegjisë me ndikime minimale në mjedis. Për këtë arsye, KESH synon të ndërmarrë një sërë aktiviteteve që promovojnë rritjen e efiçencës së energjisë në ndërtesat publike, ndriçimin publik, etj.

Qëllimi Strategjik 3 - Mbështetja e Zhvillimit Social dhe Ekonomik në zonën e interesit.

- Objektivi Strategjik 3.1. – Mbështetje për Zhvillimin e Turizmit.

Turizmi është një nga potencialet më të mëdha të zonës së interesit për të nxitur zhvillimin ekonomik dhe rritjen e punësimit. Vetë liqenet përbëjnë një atraksion turistik që gjithnjë e më shumë po tërheqin vizitorë. Në këtë kuadër, KESH planifikon ndërmarrjen e një sërë iniciativash që do të ndihmojnë në mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe zhvillimin e turizmit në këtë zonë.

- **Objektivi Strategjik 3.2. – Mbështetje për zhvillimin e arsimit.**

Duke qenë zona e influencës është një ndër zonat më të varfra të vendit, infrastruktura arsimore sidomos në zonat rurale lë shumë për të dëshiruar. Si pjesë e përgjegjësisë sociale, KESH do të kontribuojë në përmirësimin e infrastrukturës arsimore në zonë.

- **Objektivi Strategjik 3.3. – Mbështetje për grupet vulnerabël.**

Duke qenë një zonë e izoluar dhe me zhvillim të ngadaltë ekonomik, përjashtimi social është një fenomen jo i rrallë. Prandaj, si pjesë e përgjegjshmërisë sociale, KESH do të angazhohet edhe në masa e inisiativa për përfshirjen dhe mbrojtjen sociale.



abkons
LOCAL Knowledge, GLOBAL Standards

EU Bridge

Plani i Veprimit për Përgjegjshmërinë Sociale të Korporatës

Dhjetor / 2020

PËRMBLEDHJA E RAPORTIT

TITULLI I PROJEKTIT	PLANI I VEPRIMIT PËR PËRGJEGJSHMËRINË SOCIALE TË KORPORATËS
TITULLI I DOKUMENTIT	RAPORTI 3

RISH.	QËLLIMI I PUBLIKIMIT	PËRSHKRIMI	EMRI	DATA
1	Draft Plani i Veprimit	Dërguar për rishikimin e parë	Abkons	15/12/2020
2	Draft Plani i Veprimit	Dërguar për rishikim e dytë	Abkons	22/12/2020

QËLLIMI PËRFUNDIMTAR PËR PUBLIKIM

	KONSULENTI		
	Punoi	Kontrolloi	Miratoi
Emri/ Mbiemri	Rei Naçe		Enkelejd Musabelliu
Firma			
Data			

Përmbajtja

1. Hyrje	5
2. Qëllimi Strategjik 1: Angazhimi i vazhdueshëm i palëve të interesit dhe komunitetit në zonën e influencës në përmbushjen e Përgjegjshmërisë Sociale të KESH	6
2.1. Objektivi Strategjik 1.1. Hartimi dhe miratimi i Planit të Angazhimit të Palëve të Interesit	6
2.2. Objektivi Strategjik 1.2. Ngritja e Strukturave Lokale për Konsultimin me Palët e Interesit	6
2.2.1. Ngritja e Komitetit për Përgjegjshmërinë Sociale	7
2.2.2. Ngritja e Zyrave Rajonale për Përgjegjshmërinë Sociale	7
3. Qëllimi Strategjik 2: Mbrojtja e Mjedisit dhe orientimi drejt zhvillimit të qëndrueshëm të aseteve prodhuese	8
3.1. Objektivi Strategjik 2.1. Bashkëpunim me institucionet e tjera publike për të minimizuar ndikimin e përmytjeve	8
3.1.1. Projekte për reduktimin e dëmeve nga përmytjet	9
3.1.2. Iniciativa (projekte) sensibilizuese mbi mjedisin	9
3.2. Objektivi Strategjik 2.2. Ndhmesë për bashkitë në zonën e influencës për të marrë iniciativa të përbashkëta për pyllëzimin e brigjeve liqenore	10
3.2.1. Projekte me fokus ri-pyllëzimin	11
3.3. Objektivi Strategjik 2.3. Bashkëpunim dhe iniciativa të përbashkëta me organet e pushtetit vendor për të adresuar problemin e mbetjeve të ngurta	11
3.3.1. Projekte të menaxhimit të mbetjeve	12
3.4. Objektivi Strategjik 2.4. Mbështetje për të promovuar dhe nxitur zbatimin e parimit të Efiçencës së Energjisë	13
3.4.1. Tipologjia e projekteve në fushën e Efiçencës Energjitike	14
3.4.1.1. Projekte ndërtimi dhe zhvillimi kapacitetesh	15
3.4.1.2. Projekte promovuese	15
3.4.1.3. Projekte edukuese dhe ndërgjegjësuese	16
4. Qëllimi Strategjik 3: Mbështetja e Zhvillimit Social dhe Ekonomik në zonën e interesit	16
4.1. Objektivi Strategjik 3.1. Mbështetje për Zhvillimin e Turizmit	17
4.1.1.1. Projekte në mbështetje të turizmit	17
4.1.1.2. Projekte në mbështetje të transportit ujor	18
4.2. Objektivi Strategjik 3.2. Mbështetje për zhvillimin e arsimit	18
4.2.1. Tipologji projektësh në fushën e Arsimit	19
4.2.1.1. Financime studimesh dhe marrëveshje me institucionet arsimore	19
4.2.1.2. Projekte investimi në infrastrukturë arsimore	20
4.3. Objektivi Strategjik 3.3. Mbështetje për grupet vulnerabël	20

4.3.1.1.	Projekte në mbështetje të bujqësisë dhe belgotorisë.....	21
4.3.1.2.	Fushata mbështetjeje për grupet vulnerabël dhe kohezioni social.....	21
5.	Analiza e Strukturës Organizative të KESH-it.....	21
5.1.	Struktura Aktuale.....	22
5.2.	Rritja e Kapaciteteve të Sektorit të Përgjegjshmërisë Sociale-Mjedisore	23
6.	Instrumentet e Implementimit të PSK.....	23
6.1.	Përshkrim i Proceseve të Implementimit	24
6.1.1.	Identifikimi i projekteve.....	24
6.1.2.	Implementimi i Projekteve	25
6.1.2.1.	Implementimi i Drejtpërdrejtë nga KESH	25
6.1.2.2.	Implementimi nga Bashkitë.....	25
6.1.2.3.	Implementimi nga Shoqatat Jofitimprurëse	26
6.1.2.4.	Dhënia e ndihmave materiale për komunitetet e prekura në formën e sponsorizimeve materiale 27	
7.	Aneks 1: Procedura e implementimit të sponsorizimit	27
7.1.	Teksti i thirrjeve për projekt propozime	27
7.2.	Formati tip i aplikimit.....	28
7.3.	Formati i raportimit për aktivitetet	30
7.4.	Format tip marrëveshjeje	31
7.5.	Rregullorja e aplikimit.....	33

1. Hyrje

Në përputhje me Strategjinë e Përgjegjshmërisë Sociale të Korporatës, KESH duhet të sigurohet që të gjitha çështjet e Përgjegjshmërisë Sociale të Korporatës të konsiderohen, mbështeten dhe të inkorporohen në operacionet dhe çështjet administrative të kompanisë si dhe të synojnë mbështetjen e palëve të përfshira në aktivitetin KESH dhe jo vetëm.

Në mënyrë që të sigurojë progresin dhe implementimin e vazhdueshëm të kësaj strategjie, KESH duhet të mbështetet në një plan veprimi të veçantë. Ky plan duhet të synojë të arrjë përmirësime në qeverisjen e korporatës, në administrimin e riskut mjedisor dhe në proceset e dialogut dhe llogaridhënies ndaj palëve të interesit teksa tenton të përmbushë përgjegjshmërinë sociale të saj. Për të munduruar këtë drejtuesit e KESH duhet të sigurojnë që ekzistojnë strukturat e duhura organizative brenda korporatës për të identifikuar, implementuar, monitoruar dhe menaxhuar në mënyrë efektive çështjet e përgjegjshmërisë sociale të korporatës të cilat do të jenë gjithmonë të gërshetuara me performancën në lidhje me aktivitetin ekonomik të KESH-it.

Procesi për të ardhur në një plan veprimi ka nisur me shqyrtimin e dokumentave të zhvillimit strategjik zonal për zonat e influencës së KESH dhe ka vijuar me takimet dhe workshop-et me palët e interesit të korporatës. Gjatë këtyre takimeve u arrit të merret informacion thelbësor për gjendjen e zonës së interesit dhe për pikat ku ka më shumë nevojë për ndërhyrje me projekte sociale dhe mjedisore të mbështetura nga KESH.

Rezultatet dhe informacionet e marra u strukturuan në dokumentin e Strategjisë së Përgjegjshmërisë Sociale të KESH. Strategjia parashtroi tre qëllime strategjike drejt të cilave duhet të orientohen përpjekjet dhe projektet e KESH në kuadër të përgjegjshmërisë sociale. Në vazhdimësi të qëllimeve strategjike, është ndërtuar një plan veprimi në mënyrë që të prezantojë tipologjitë kryesore të projekteve që mund të ndiqen nga KESH. Ky plan veprimi është ndërtuar duke pasqyruar standardet ekzistuese dhe ato në zhvillim të përgjegjshmërisë sociale të korporatave.

Këto projekte mund të implementohen nga KESH në mënyra të ndryshme dhe në bashkëpunim me aktorë të tjerë, publikë ose privatë. Një nga institucionet kryesore me të cilat do të bashkëpunohet janë Bashkitë e zonës së influencës (Bashkitë Shkodër, Kukës, Vau i Dejës, Has, Puke dhe Tropojë). KESH parashikon të implementojë projekte në bashkëpunim me bashkitë nëpërmjet marrëveshjeve të bashkëfinancimit, ose të alokojë fonde për projekte të këtyre institucioneve që kanë impakt në çështjet sociale që KESH kërkon t'u japë zgjidhje nëpërmjet strategjisë së përgjegjshmërisë sociale. Një tjetër mekanizëm që përmbush qëllimin e KESH është implementimi i projekteve nga vetë korporata nëpërmjet angazhimit të stafit të saj në prokurimin dhe menaxhimin e këtyre projekteve. Kjo qasje do të lejonte një pavarësi më të madhe dhe një menaxhim më të përqëndruar të projekteve, duke rezultuar në përfundimin e tyre në afate kohore më të shkurtra dhe me kosto sa më efektive.


Një tjetër rol mjaft i rëndësishëm për realizimin e këtyre projekteve pritet të luhet nga shoqatat apo OJF-të që operojnë në zonën e interesit. KESH parashikon të implementojë projekte në bashkëpunim me to, nëpërmjet skemave të sponsorizimit. Gjithashtu, një partner jo më pak i rëndësishëm për KESH në përmbushjen e përgjegjshmërisë sociale të korporatës mund të jenë bizneset vendore, me të cilat mund të bashkëpunohet nëpërmjet bashkëfinancimeve sponsorizuese për projekte të caktuara.

Për përmbushjen e përgjegjshmërisë sociale u identifikuan tre qëllime strategjike, ndërkohë që për përmbushjen e këtyre qëllimeve u identifikuan një sërë objektivash strategjike. Më poshtë vijon një prezantim i tipologjive të projekteve që KESH synon të implementojë për të përmbushur objektivat strategjike të vendosura në kuadër të përgjegjshmërisë sociale të korporatës.

2. Qëllimi Strategjik 1: Angazhimi i vazhdueshëm i palëve të interesit dhe komunitetit në zonën e influencës në përmbushjen e Përgjegjshmërisë Sociale të KESH

Përpilimi dhe zbatimi i një Plani Veprimi për përmbushjen e Strategjisë së Përgjegjshmërisë Sociale të një korporate duhet të nisë para së gjithash me ngritjen e mekanizmave për angazhimin dhe konsultimin e vazhdueshëm të palëve të interesit. Thelbi i përgjegjshmërisë sociale qëndron në identifikimin e problemeve, zhvillimin dhe implementimin e këtyre projekteve duke angazhuar palët e interesit.

Siç detajohen edhe në këtë plan veprimi, tipologjitë e projekteve që KESH pritet të ndër marrë në këtë drejtim kërkojnë inputin, besimin dhe dëshirën e mirë të të gjitha autoriteteve vendore të interesuara, organizatave jo-fitimprurëse dhe komunitetit të zonës në mënyrë që këto projekte të kenë një ndikim pozitiv jo vetëm për KESH-in, por edhe për mjedisin dhe banorët e zonave që ndikohen nga aktiviteti ekonomik i KESH. Në mënyrë që ky angazhim të arrihet duhet që ai të formalizohet institucionalisht. KESH, në kuadër të zbatimit të Strategjisë së PSK planifikon të miratojë një Plan Angazhimi me të gjithë aktorët dhe palët e interesit, dhe më tej të krijojë struktura të posaçme që do të lehtësonin punën për realizimin e projekteve të PSK.



2.1. Objektivi Strategjik 1.1. Hartimi dhe miratimi i Planit të Angazhimit të Palëve të Interesit

Plani i Angazhimit të Palëve të Interesit është hartuar si pjesë e Strategjisë së Përgjegjshmërisë Sociale të Korporatës. Miratimi i këtij plani identifikon palët e interesit, përcakton format e komunikimit, krijon mekanizmat dhe përcakton procedurat se si KESH do të angazhojë në mënyrë të vazhdueshme Palët e Interesit për të marrë informacion mbi nevojat e komunitetit dhe për të konsultuar me ta iniciativat që planifikon të ndër marrë.

2.2. Objektivi Strategjik 1.2. Ngritja e Strukturave Lokale për Konsultimin me Palët e Interesit.

Për të garantuar një angazhim efektiv, sektorit aktual të përgjegjshmërisë sociale dhe mjedisore të KESH-it do t'i bashkëngjiten edhe strukturat lokale në zonën e influencës, detyra kryesore e të cilave do të jetë komunikimi i vazhdueshëm dhe i drejtpërdrejtë me palët e interesit në terren. Rol mjaft të rëndësishëm në këtë aspekt pritet të luhet edhe nga Komiteti për Përgjegjshmërinë Sociale, organ i ri ky që propozohet të ngrihet brenda shoqërisë në kuadër të ri-organizimit në drejtim të përmbushjes së PSK të KESH-it.

2.2.1. Ngritja e Komitetit për Përgjegjshmërinë Sociale

Me miratimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit, në kuadër të ri-organizimit dhe angazhimit për përmbushjen e përgjegjshmërisë sociale të korporatës, rekomandohet që KESH të ngrëjë një strukturë të re, në formën e një komiteti për të kryer identifikimin dhe priorizimin e projekteve. Ky komitet, i cili do të quhet Komiteti për Përgjegjshmërinë Sociale, do të përbëhet nga përfaqësues të departamenteve kryesore të KESH, dhe në të do të propozohet të përfshihen përfaqësues nga Bashkitë e zonës së influencës, përfaqësues nga institucionet e tjera vendore ose rajonale, si dhe nga OJF-të apo bizneset private të zonës së influencës, të cilat janë të angazhuara në çështjet sociale dhe mjedisore.

Komiteti për Përgjegjshmërinë Sociale do të garantojë angazhimin e vazhdueshëm të palëve të interesit në përmbushjen e objektivave të Strategjisë së Përgjegjshmërisë Sociale dhe do të luajë një rol kyç në identifikimin e problematikave dhe diskutimin e zgjidhjeve të tyre. Gjithashtu, përmes këtij Komiteti do të identifikohen edhe projektet që do të implementohen në përmbushje të Strategjisë dhe Planit të Veprimit.

Komiteti rekomandohet të jetë një organ honorifik dhe këshillimor. Veprimtaria e tij do të rregullohet me anë të një Rregulloreje që miratohet me vendim të Administratorit të Shoqërisë. Sugjerohet që mbledhjet e Komitetit të bëhen në mënyrë periodike, minimalisht çdo tre muaj. Si sekretariat i Komitetit shërben Sektori i Përgjegjshmërisë Social-Mjedisore, i cili do të njoftojë anëtarët për mbledhjet, do të përgatisë materialet e mbledhjeve dhe do të mbajë dhe zbardhë proces-verbalet e tyre.

2.2.2. Ngritja e Zyrave Rajonale për Përgjegjshmërinë Sociale

Për të mbajtur lidhje të vazhdueshme me zonën e influencës dhe për të garantuar një ndërveprim dhe komunikim sa më të mirë me palët e interesit, rekomandohet ngritja e dy Zyrave Rajonale që do të kenë përgjegjësinë të kryejnë identifikimin dhe komunikimin e përditshëm me palët e interesit, angazhimin e tyre nëpërmjet takimeve dhe dëgjësave në kuadër të çdo projekti, që do të propozojë Komiteti për Përgjegjshmërinë Sociale si dhe të raportojnë tek Sektori i Përgjegjshmërisë Social-Mjedisore të gjithë këtë ndërveprim me palët e interesit. Këto Zyra Rajonale do të vendosen në pikat qendrore të zonës së influencës së KESH, prandaj një zyrë propozohet të vendoset në qytetin e Shkodrës, ndërsa tjetra në qytetin e Kukësit, duke mbuluar kështu dy qarqet ku KESH ushtron veprimtarinë e tij ekonomike.

Këto struktura, përveç aktivitetit të përmendur më sipër, do të jenë përgjegjëse për të mbledhur dhe për të adresuar në KESH të gjitha ankesat që do të vijnë nga komuniteti i zonave të influencës, qoftë përsa i përket projekteve që do të zhvillohen në kuadër të përgjegjshmërisë sociale, qoftë në lidhje me veprimtaritë e tjera të KESH në këtë zonë. Gjithashtu, ato do të luajnë një rol të rëndësishëm në organizimin e aktiviteteve ndërgjegjësuese, edukative e sociale që do të organizohen në kuadër të përgjegjshmërisë sociale.

Rekomandohet që në secilën nga Zyrat Rajonale të punësohen 1-2 punonjës.



Figura 1 – Foto nga takimi i KESH me palët e interesit

3. Qëllimi Strategjik 2: Mbrojtja e Mjedisit dhe orientimi drejt zhvillimit të qëndrueshëm të aseteve prodhuese

Duke qenë prodhuesi më i madh i energjisë elektrike nga hidroenergja në vend, veprimtaria e KESH-it është ngushtësisht e lidhur me mjedisin. Sfidat kryesore mjedisore në Zonën e Influencës, rreth tre HEC-eve në pronësi të KESH-it, janë komplekse dhe përfshijnë një sërë problematikash të cilat lidhen me mbetjet, ndotjen e ujërave të liqenit nga prurjet e ngurta, shpyllëzimet, erozioni dhe përmytjet. Këto problematika kërkojnë, përveç investimeve nga KESH, një bashkëpunim shumë të ngushtë me autoritetet qendrore dhe vendore.

3.1. Objektivi Strategjik 2.1. Bashkëpunim me institucionet e tjera publike për të minimizuar ndikimin e përmytjeve

Një nga ndikimet më me pasoja mjedisore, ekonomike dhe sociale që lidhen me veprimtarinë e KESH është ai i përmytjeve, që shkaktohen për shkak të kombinimit të reshjeve të mëdha dhe shkarkimeve të detyrueshme që KESH bën nga HEC-i i Vaut të Dejës, sidomos në zonën e Shkodrës. Për të minimizuar efektet e këtij ndikimi, do të punohet ngushtësisht me institucionet e tjera përgjegjëse duke ndërmarrë një sërë iniciativash për të zbutur dhe minimizuar efektin e përmytjeve mbi komunitetin.

Bashkitë luajnë një rol thelbësor si partnerë lokalë në zgjidhjen e problematikave mjedisore, si për shembull në rastin e depozitimit të mbetjeve të ngurta pranë degëve të lumenjve dhe brigjeve të liqeneve, parandalimin e hedhjes së mbetjeve në rrjedha ujore, mbylljen e zonave të rrezikshme të depozitimit (legale dhe jolegale), si dhe rehabilitimin e tyre.






Figura 2 - Zona e Përmbytjeve në Bashkinë Shkodër

3.1.1. Projekte për reduktimin e dëmeve nga përmbytjet

Përmbytjet e shkaktuara nga reshjet e dendura dhe prurjet e mëdha të lumit Drin janë padyshim një nga problemet më madhore që banorët e zonave të influencës kanë hasur gjatë viteve. Këto përmbytje kanë edhe një efekt negativ të konsiderueshëm ekonomik tek familjet e prekura. Duke qënë se zona mbështetet gjerësisht në aktivitetin bujqësor dhe blegtoral, Plani i Veprimit në kuadër të përgjegjshmërisë sociale të korporatës përmban tipologji projektesh që zbusin riskun e përmbytjeve. Këto tipologji projektesh përfshijnë ndërtimin apo riparimin e infrastrukturës ndihmëse në rast përmbytjesh (rregullim pritash, rregullime të shtratit të lumenjve dhe argjinaturave) e deri tek lobimi për ndërmarrjen e masave institucionale në rastin kur godet një katastrofë natyrore si përmbytja. Këto masa mund të bashkëfinancohen nga KESH dhe Bashkitë kur kanë nevojë për financime të konsiderueshme.

Gjithashtu, kryerja e studimeve që do të ndihmonin në minimizimin e dëmeve nga përmbytjet do të përbënin një tjetër tipologji projektesh që mund të ndërmerret nga KESH, qoftë nëpërmjet kontraktimit të ekspertëve dhe konsulentëve, ashtu edhe nëpërmjet bashkëpunimit me universitetet dhe institucionet shkencore dhe kërkimore.

3.1.2. Iniciativa (projekte) sensibilizuese mbi mjedisin

Iniciativat sensibilizuese do të ndihmonin jo vetëm banorët e zonës të edukohen mbi ndotjen e mjedisit dhe impaktin që ajo sjell në jetën e tyre të përditshme por edhe turistët, të cilët gjatë periudhës së verës janë të shumtë në zonë. Këto iniciativa janë mjaft praktike, pasi janë lehtësisht të organizueshme dhe kanë kosto relativisht të ulëta.

Këto lloj projektesh mund të kryhen qoftë nga vetë stafi i KESH-it, ashtu edhe në bashkëpunim me OJF mjedisore që zhvillojnë aktivitetin e tyre në zonën e influencës. Në rastin e dytë, KESH mund të angazhohet nëpërmjet sponsorizimeve të vogla financiare për OJF-të në mënyrë që të ndërmerren fushata sensibilizuese për komunitetin e zonës. Iniciativat sensibilizuese mbi mjedisin mund të kryhen në një gamë të gjerë temash, duke filluar nga edukimi mbi klasifikimin dhe ndarjen e mbetjeve, deri tek dëmet që i shkaktohen ekosistemeve dhe biodiversitetit dhe mënyrat e shmangies së tyre.



Figura 3 – Pastrim vullnetar I brigjeve liqenore

3.2. Objektivi Strategjik 2.2. Ndhimesë për bashkitë në zonën e influencës për të marrë inisiativa të përbashkëta për pyllëzimin e brigjeve liqenore

Erozioni që shpesh herë shkaktohet nga shpyllëzimi, rrit depozitimet e inerteve në liqene e vështirëson veprimtarinë e hidrocentraleve. Për këtë arsye, rekomandohet të studjohen bashkë me autoritetet vendore zonat e erozionit dhe të ndërmerren inisiativa për pyllëzimin e tyre.

Ndikimi i HEC-eve në pjesën mjedisore është më i dukshëm në erozionin që shkaktohet për shkak të lëvizjeve të shpeshta të nivelit të ujit dhe prurjeve. Erozioni dhe shkarkimet ujore janë një ndër shkaktarët më të mëdhenj të përmytjeve në këtë zonë, sidomos në zonën e Shkodrës, e cila e ka vuajtur këtë problem prej dekadash tashmë. Erozioni ka edhe një ndikim tjetër anësor mjaft të rëndësishëm në zonë, që është amortizimi me shpejtësi i strukturave ekzistuese të lundrimit (molet, terminalet e vogla ujore), dëm ky, që vështirëson punën e personave dhe bizneseve që shfrytëzojnë liqenet dhe lumenjtë për transport.




Figura 4 - Zonat e Prekura nga Erozioni në Liqenin e Fierzës

3.2.1. Projekte me fokus ri-pyllëzimin

Ripyllëzimi shihet si një nga mjetet më të mira për të dhënë një impakt të prekshëm në fushën e mjedisit, pasi përfitimet që rrjedhin nga ky aktivitet janë të shumfishta. Ripyllëzimi i zonave të influencës së KESH do të sillte si fillim një reduktim të konsiderueshëm të erozionit në brigjet lumore dhe liqenore si dhe zonave përreth që vuajnë nga kjo problematikë. Ripyllëzimi do të sillte gjithashtu një rritje të ndjeshme të biodiversitetit dhe habitatit të gjallesave të egra, duke shtuar në këtë mënyrë një atraksion të ri në zonë me potencial të konsiderueshëm turistik. Një tjetër përfitim afatmesëm i pyllëzimit është punësimi që gjenerohet, duke ndihmuar kështu panoramën sociale të zonave të prekura nga aktiviteti i KESH.

Pyjet gjithashtu ofrojnë shumë mundësi për aktivitete sportive dhe aktivitete për fëmijët dhe KESH duhet të bëjë përpjekje për të ruajtur apo edhe zgjeruar zonat pyjore përmes pyllëzimeve të reja.

Nga sa më sipër rezulton se një nga prioritetet në fushën mjedisore për KESH-in do të jenë projektet me fokus pyllëzimin e brigjeve lumore dhe liqenore apo zonat e tjera të shpyllëzuara, të cilat mund të jenë identifikuar nga Bashkitë apo institucionet e tjera, ose do të identifikohen gjatë procesit të angazhimit të vazhdueshëm të komunitetit.

Iniciativa të tilla mund të ndërmerren në bashkëpunim me Bashkitë, agjencitë mjedisore rajonale apo edhe Ministrinë e Turizimit dhe Mjedisit. Këto projekte gjithashtu mund të kryhen në bashkëpunim me OJF-të vendore të angazhuara në fushën e mjedisit, duke sponsorizuar blerjen e fidanëve dhe organizimin e fushatave masive të mbjelljes.

3.3. Objektivi Strategjik 2.3. Bashkëpunim dhe inisiativa të përbashkëta me organet e pushtetit vendor për të adresuar problemin e mbetjeve të ngurta

Ndotja e ujërave të liqeneve nga mbetjet e ngurta, ujërat e zeza apo edhe mbetjet e rrezikshme është një tjetër çështje që ndikon në veprimtarinë e KESH. Prandaj, është e arsyeshme që të mbështeten institucionet dhe të ndërmerren inisiativa që do të ndihmojnë komunitetin për të reduktuar ndotjen.

Problemi kryesor i vënë në dukje nga analiza e gjendjes ekzistuese dhe gjatë takimeve me palët e interesit në zonën e influencës së KESH-it, ishin mbetjet e ngurta. Gjenerimi i mbetjeve të ngurta ka pësuar një tendencë rritëse në vitet e fundit, veçanërisht për mbetjet shtëpiake dhe tregtare.

Ndërkohë mbetjet inerte kanë pësuar një tendencë uljeje në krahasim me mbetjet e tjera, kjo dhe për shkak të mungesës së ndërtimeve masive në zonë. Megjithë përpjekjet nëpërmjet investimeve të ndryshme në fushën e menaxhimit të mbetjeve, përsëri ndeshemi me problematikën e depozitimit të tyre në vende të papërshtatshme, kryesisht pranë rrjedhave të degëzimeve lumore që derdhen në liqen, apo edhe në afërsi të liqenit.

Vend-depozitimet e mbetjeve inerte ndodhen në një distancë të afërt nga qendrat e banuara. Vihen re gjithashtu edhe pozicionime të vend-depozitimeve afër brigjeve liqenore, gjë që i ekspozon shumë keto te fundit ndaj ndotjes. Jo në pak raste mbetjet shkaktojnë edhe probleme teknike për KESH-in, sepse mund të dëmtojnë pajisjet e KESH-it që kanë kontakt me rrjedhën ujore.

Problem tjetër përbën edhe mbulimi i dobët me shërbimin për pastrimin e mbeturinave urbane në zonë. Qytetet (Kukësi, Shkodra dhe Tropoja) gëzojnë një mbulim relativisht më të mirë në krahasim me zonat rurale të territorit, por gjithsesi mbulimi në masa të kënaqshme nuk arrihet në asnjë zonë. Projektet e KESH në këtë optikë do të ishin me një raport kosto-benefit mjaft të mirë, pasi vendosja e infrastrukturës bazike për mbrojtjen e ambientit nuk kërkon shumë investime për të qënë e efektshme.

Gjithashtu një çështje tjetër me rëndësi në ekosistemin e zonës së interesit është derdhja dhe shkarkimet e vazhdueshme të ujërave të ndotura urbane dhe industriale në degëzimet e lumenjve përreth baseneve liqenore, madje dhe shkarkime direkte të tyre në liqene. Kjo situatë krijon ndotje të vazhdueshme, duke bërë thuajse të pamundur përdorimin e lumenjve e liqeneve për aktivitete ekoturistike apo edhe për zhvillimin e aktiviteteve të peshkimit, të cilat janë kërkesa të vazhdueshme të komuniteteve, veçanërisht të qytetarëve të Kukësit.

Një problematikë e kohëve të fundit lidhur me Liqenin e Komanit buron nga pika turistike Lumi i Shalës. Kjo zonë paraqet problematika të theksuara në lidhje me menaxhimin e mbetjeve dhe shkarkimet e ujërave të ndotura pasi nuk ka asnjë infrastrukturë mbështetëse për të parandaluar ndotjen.

Së fundmi, një aspekt tjetër i rëndësishëm për t'u përmendur janë dhe problematikat e ndryshme me industrinë nxjerrëse të mineraleve në këto zona, të cilat shpesh herë depozitojnë materiale të ndryshme dhe mbetje inerte pranë degëzimeve lumore. Në këtë mënyrë, uji i lumenjve ndotet me sasi të konsiderueshme të metaleve të rënda dhe përfundon në ujin e liqeneve, ku dhe shkakton ndotje të konsiderueshme dhe dëmtime të ekosistemit apo biodiversitetit ujor.

3.3.1. Projekte të menaxhimit të mbetjeve

Vënddepozitimet e mbetjeve anës lumenjve dhe liqeneve janë një problem madhor për komunitetet që jetojnë në zonën e influencës së KESH-it. Në këtë drejtim KESH-i mund të ndërmarrë një sërë projektesh për rehabilitimin, transformimin ose transferimin e këtyre venddepozitimeve. Një ndërhyrje e tillë do të kërkonte fonde të konsiderueshme nga Bashkitë, por, nga ana tjetër, është një tipologji kryesore projekti që KESH mund të realizojë nëpërmjet bashkëpunimit me autoritetet lokale duke përdorur një sërë instrumentash.

Një tjetër ndërhyrje e nevojshme është mbulimi me shërbimin e pastrimit në zonat e thella të cilat ndodhen pranë brigjeve të Kaskadës. Duke u gjendur larg qendrave administrative të bashkive, këto zona nuk mbulohen me shërbimin e pastrimit, dhe shpesh here mbetjet e gjeneruara prej tyre përfundojnë në liqene.

Problemi i mbetjeve të ngurta në sipërfaqet ujore të zonës së influencës mbetet një nga pikat fokale ku duhet të përqëndrohen projektet që KESH-i do ndërmarrë në kuadër të përgjegjshmërisë sociale të korporatës. Kjo tipologji projektesh do të ndihmonte gjerësisht jo vetëm KESH, por edhe ekosistemet e liqeneve dhe lumenjve e biodiversitetin e tyre, si dhe banorët që shfrytëzojnë këto burime natyrore për turizëm dhe peshkim.

Në këtë tipologji projektesh mund të përfshihen iniciativa të vendosjes së koshave të mbeturinave, pasi ka mungesë të theksuar të tyre dhe gjatë sezonit turistik kjo problematikë del edhe më shumë në pah si pasojë e rritjes së qarkullimit të turistëve dhe personave në zonë, duke sjellë një rritje të ndotjes në këtë aspekt.

Një strategji tjetër reduktimi i riskut mjedisor që u kanoset burimeve ujore nga grumbullimi i mbetjeve mund të jetë prokurimi i makinave pastruese të sipërfaqeve ujore. Këto makineri do të siguronin një pastrim periodik të sipërfaqes. Pajisjet mund të prokurohen direkt nga KESH dhe të vihen në dispozicion të organeve që administrojnë liqenet.

Vendosja e rrjetave për grumbullimin e mbetjeve në pikat e ngushta të liqeneve dhe lumenjve të cilat konsiderohen "hotspote" grumbulluese, do të ndihmonte në grumbullimin e mbetjeve dhe me tej largimin e këtyre mbetjeve e transportin e tyre nëpër vend-depozitimet e miratuara. Këto rrjeta kanë kosto relativisht të ulëta dhe paraqesin një tipologji projekti me një raport kosto-përfitim mjaft të favorshëm, pasi impakti pozitiv që kanë është i konsiderueshëm. Vendosja e rrjetave mund të bëhet direkt nga KESH nëpërmjet prokurimit.




Figura 5: Harta e vend-depozitimeve në Zonën e Influencës

3.4. Objektivi Strategjik 2.4. Mbështetje për të promovuar dhe nxitur zbatimin e parimit të Eficiencës së Energjisë

KESH, si prodhuesi më i madh në vend i energjisë së rinovueshme, ka si qëllim afatgjatë prodhimin e enegjisë me ndikime minimale në mjedis. Për këtë arsye, KESH-i synon të ndër marrë një sërë aktivitete që promovojnë rritjen e eficiencës së energjisë në ndërtesat publike, ndriçimin publik, etj.

Përdorimi i efektshëm i energjisë, ndonjëherë e quajtur thjesht efienca e energjisë, ka të bëjë me synimin për të zvogëluar sasinë e energjisë që nevojitet për të siguruar produkte dhe shërbime. Efienca energjitike dhe energjia e rinovueshme konsiderohen se janë shtyllat binjake të politikës së energjisë së qëndrueshme dhe kanë prioritet të lartë në hierarkinë e energjisë së qëndrueshme. Në shumë vende, efienca energjitike shihet si një avantazh i sigurisë kombëtare, sepse mund të përdoret për të zvogëluar nivelin e importeve të energjisë nga vendet e huaja, uljen e varësisë ndaj tyre dhe mund të ngadalësojë shkallën me të cilën shterojnë burimet e brendshme të energjisë.

Nga shumë studime është vlerësuar se rritja e eficiencës së energjisë sjell përfitime shtese në uljen e konsumit të energjisë. Disa vlerësime të vlerës së këtyre përfitimeve të tjera, shpesh të quajtura përfitime



të shumëfishta, bashkë-përfitime, përfitime ndihmëse ose përfitime jo-energjitike, e kanë llogaritur vlerën e tyre të përmbledhur edhe më të lartë se ajo e përfitimeve direkte. Këto përfitime të shumëfishta të efikasitetit të energjisë përfshijnë elemente të tilla si ulje e ndikimit në ndryshimet klimatike, ndotja e reduktuar e ajrit dhe përmirësimi i shëndetit, përmirësimi i kushteve të ambienteve të brendshme, rritja e sigurisë së energjisë dhe reduktimi i rrezikut të ngritjes së çmimit për konsumatorët e energjisë. Pikërisht edhe këto përfitime duhet të jenë në qendër të aktivitetit të KESH përsa i përket veprimtarisë së shoqërisë në kuadër të përgjegjshmërisë sociale të korporatës.

Duke rritur ndjeshmërinë ndaj efikasitetit të energjisë, KESH ndikon njëkohsisht edhe në përmirësimin e mjedisit në mënyrë indirekte. Edukimi i nxënësve të shkollave, për shembull, do të jepte përfitime mjaft afatgjata në lidhje me mbrojtjen e mjedisit, apo në fushën turistike, duke përmirësuar kushtet e brendshme të strukturave akomoduese turistike nëpërmjet zbatimit të parimeve të efikasitetit të energjisë. Edukimi energjistik është shumë i rëndësishëm për KESH, dhe, në këtë kuadër, këto lloje nismash do të sillnin një përfitim dypalësh për komunitetin dhe për KESH.

Përmirësimet e efikasitetit të energjisë me kosto efektive mund të kenë ndikime pozitive ekonomike në zonat e aplikuara, duke rritur aktivitetin ekonomik dhe punësimin. Eficenca e energjisë zvogëlon sasinë e energjisë së nevojshme për të ofruar shërbime, të tilla si lëvizshmëria, ndriçimi, ngrohja dhe ftohja. Zona e influencës së KESH do të përfitonte masivisht nga rritja e efikasitetit të energjisë, pasi energjia në këto zona përdoret shumë për ngrohje gjatë dimrit, si nga familjet, ashtu edhe nga strukturat akomoduese turistike.

Nga sa më sipër, avantazhet janë të shumëfishta dhe të ndërlidhura, duke siguruar përfitime për komunitetin e zonave të influencës, por edhe për KESH. Për këtë arsye, një nga fushat prioritare të projekteve në kuadër të përgjegjshmërisë sociale të KESH është përqëndruar pikërisht tek efikasiteti i energjisë dhe do të përfshijë një gamë nderhyrjesh që variojnë nga ndërtimi i kapaciteteve e deri tek edukimi dhe sensibilizimi në fushën e efikasitetit të energjisë.

3.4.1. Tipologjia e projekteve në fushën e Efikasitetit të Energjisë

Duke qënë se zona paraqet çdo ditë e më shumë shtim të potencialit turistik, por edhe për të siguruar minimumet e standarteve të një jetese dinjitoze për banorët e zonës, ndërhyrja e KESH-it në këtë aspekt do të sillte përmirësim të ndjeshme dhe do të krijonte një marrëdhënie "win-win", duke ndihmuar zonën, por edhe duke edukuar banorët mbi temën aq të rëndësishme të efikasitetit të energjisë.



Figura 6 – Foto nga inagurimi I Smart Flower në qytetin e Shkodrës

3.4.1.1. Projekte ndërtimi dhe zhvillimi kapacitetesh

Kjo tipologji projektësh parashikon ndërhyrjen në infrastrukturën publike dhe përmirësimin e saj nëpërmjet zbatimit të parimeve të efikasitetit energjetic. Një nga tipet e përshtatshme të projekteve që mund të aplikohen në këtë fushë është ndërhyrja në ndriçimin publik në segmente të caktuara të zonës së influencës. Sigurisht ky ndriçim duhet të jetë konform parimeve të efikasitetit, me specifikimet e duhura, panele që furnizojnë ndriçimin etj.

Një tip tjetër i përshtatshëm projekti do të ishte ndihmesa për godinat publike, duke filluar nga shkollat e deri tek bashkitë dhe ristrukturimi elektrik i tyre, termoizolimi, vendosja e paneleve diellore, dizajni për thithjen maksimale të rrezeve diellore, etj. Montimi i paneleve diellore për godinat publike dhe për shkollat e zonës pranë kaskadës do të ishte më eficient për aspektin e ndriçimit.

3.4.1.2. Projekte promovuese

Në kuadër të zhvillimit të qëndrueshëm të burimeve gjeneruese, KESH-i parashikon të ndërmarrë projekte promovuese për të nxitur konsumatorët edhe bizneset të lëvizin drejt efikasitetit energjetic, e cila përveç kursimit, nxit mbrojtjen e mjedisit dhe bart shumë efekte pozitive me vete.

KESH-i mund të promovojë këtë frymë duke nisur nga vetja. Shembull i mirë për këtë është vendosja e Smart Flower- nje sistem fotovoltaik me pamje estetike ne forme luleje, e vendosur në qytetin Shkodër, të cilën KESH-i po e implementon aktualisht. Një vazhdimësi e mirë e këtij projekti do të ishte vendosja e smart flowers në te gjitha bashkitë e zonës së influencës dhe do të jepte edhe një mesazh shumë të mirë sensibilizues nëpërmjet promovimit.

Një tipologji e mundshme ndërhyrjeje do të ishte ristrukturimi i godinave permes ristrukturimit te godinat në varësi të korporatës me parime kursimi të energjisë.

Një tipologji tjetër ndërhyrjeje që promovon frymën e kursimit dhe efikasitetit të energjisë do të ishte organizimi i workshopeve në bashkëpunim me kompanitë e tjera publike dhe private të sektorit energjitik, si dhe bashkërendimi i axhendave për të arritur implementime konkrete të projekteve të rritjes së efikasitetit të energjisë. Këto projekte do të ishin tejet frytdhënëse në këtë drejtim pasi do të kishin një sferë të gjerë aplikimi, duke qënë se edhe aktorët e përfshirë do të ishin të ndryshëm.

3.4.1.3. Projekte edukuese dhe ndërgjegjësuere

Edukimi dhe ndërgjegjësimi i popullatës dhe bizneseve drejt përdorimit eficient të energjisë sjell benefite të shumfishta në shumë drejtime. Siç është përmendur, edukimi energjitik është veçantërisht i rëndësishëm tek fëmijët, pasi siguron që brezat e ardhshëm të kenë një botëkuptim të mirë të mënyrës se si energjia prodhohet, konsumohet dhe se çfarë benefitesh rrjedhin nga përdorimi eficient dhe me kursim i saj.

Në këtë kuadër, një tipologji e fushatave edukuese dhe ndërgjegjësuere të KESH-it, duhet të drejtohet tek shkollat dhe edukimi i të rinjve në fushën e energjisë në përgjithësi dhe në fushën e efikasitetit energjitik në veçanti, në mënyrë që të krijohen kapacitete që do të ndihmojnë në një zhvillim të qëndrueshëm të efikasitetit të përdorimit të energjisë në të ardhmen. Ky edukim mund të vijë në formën e fushatave dhe sensibilizimit, në bashkëpunim me shkollat dhe OJF-të e fushës, në formën e fushatave të ndërgjegjësimit nëpërmjet videove sensibilizuese që kanë lidhje me këtë temë apo broshurave informative dhe shpërndarjen e tyre në zonën e influencës, në formën e konkurseve nëpër shkolla, etj.

4. Qëllimi Strategjik 3: Mbështetja e Zhvillimit Social dhe Ekonomik në zonën e interesit

Mungesa e qëndrueshmërisë sociale dhe izolimi pasqyrojnë pengesat kryesore afatgjata të zhvillimit në zonën e influencës së KESH-it. Kthimi i vëmendjes tek popullata e përjashtuar nga mundësitë ekonomike dhe sociale dhe rritjen e investimeve që synojnë rritjen e përfshirjes do të kishte një impakt domethënës në rritjen e mirëqenjes se komuniteteve qe ndodhen prane HEC-eve.

Që të arrihet qëndrueshmëria sociale duhet të krijohet një shoqëri gjithëpërfshirëse dhe elastike ku qytetarët kanë zë dhe organet kompetente reagojnë. Qëndrueshmëria sociale ka të bëjë gjithashtu me zgjerimin e mundësive për të gjithë banorët e zonës. Së bashku me qëndrueshmërinë ekonomike dhe mjedisore, qëndrueshmëria sociale është thelbësore për uljen e varfërisë dhe rritjen e prosperitetit. Pikërisht për këtë arsye KESH-i planifikon të shtrijë projektet në kuadër të përgjegjshmërisë sociale të korporatës edhe në këtë fushë duke prekur kështu një numër sferash të jetës në zonën e influencës.

Parimi kryesor i projekteve të rritjes së qëndrueshmërisë sociale dhe përfshirjes (mos izolimit) është të ndihmojë njerëzit të kapërcejnë pengesat që hasin ata për t'u integruar plotësisht në shoqëri dhe të mbështesin përpjekjet e tyre për të përmirësuar te ardhmen. Kjo do të arrihet duke punuar e lobuar me organet kompetente të zonës, komunitetet, shoqërinë civile, sektorin privat dhe aktorët e tjerë të interesuar për të krijuar shoqëri më gjithëpërfshirëse dhe për fuqizimin e qytetarëve e forcimin e komuniteteve.

Për njerëzit që jetojnë në territore sfiduese, si zona e influencës së KESH-it, objektivi i projekteve të Planit të Veprimit do të jetë të forcohej rezistencën duke krijuar mundësi që këto komunitete të mund të lulëzojnë. Kjo arrihet duke punuar për të ndërtuar komunitete të forta që mund të përballojnë ndarjet e shkaktuara nga konflikti dhe goditjet ekzogjene siç janë ndryshimi i klimës, kujtojmë se lëvizja në disa territore gjatë stinës së dimrit është praktikisht e pamundur duke parë dhe infrastrukturën. Kjo është arsyeja pse shumica e projekteve duhet të përqendrohen në ndërtimin e kohezionit shoqëror në vendet e kësaj zone.

Thelbi i tipologjive të projekteve të Planit të Veprimit të KESH-it përqendrohet në fuqizimin e komuniteteve duke u dhënë rrugëzgjdhje problemeve të tyre për uljen e varfërisë. Duke u mbështetur në qasjet pjesëmarrëse dhe vlerat dhe traditat e komunitetit, projektet do të përmirësojnë shërbimet e komunitetit dhe infrastrukturën bazë për të ndihmuar banorët, veçanërisht ata më të prekur, të arrijnë potencialin e tyre dhe të zhvillojnë jetesën e tyre. Projektet gjithashtu do të synojnë të forcojnë kapacitetin e banorëve dhe drejtuesve të komunitetit për të artikuluar nevojat e tyre dhe për t'u angazhuar me qeverisjen lokale.

Ekziston gjithashtu nevoja për të ndërtuar mjete të angazhimit qytetar në projektet që KESH-i do të ndërmarrë në kuadër të përgjegjshmërisë sociale. Angazhimi i qytetarëve është veçanërisht i rëndësishëm gjatë pandemisë që po kalojmë, pasi mund të mundësojë korigjimin e kursit të veprimeve në kohë reale.

4.1. Objektivi Strategjik 3.1. Mbështetje për Zhvillimin e Turizmit

Turizmi është një nga potencialet më të mëdha të zonës së interesit për të nxitur zhvillimin ekonomik dhe rritjen e punësimit. Vetë liqenet përbëjnë një atraksion turistik që gjithnjë e më shumë po tërheqin vizitorë. Në këtë kuadër, KESH planifikon ndërmarrjen e një sërë iniciativash që do të ndihmojnë në mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe zhvillimin e turizmit në këtë zonë.

E gjithë zona e influencës së KESH paraqet potenciale madhore dhe asete të mjaftueshme për të tërhequr turistët, veçanërisht nisur nga burimet e jashtëzakonshme natyrore në majat e maleve, kullotat alpine, luginat e thella, si dhe liqenet dhe lumenjtë spektakolarë.

Atraksionet që tërheqin më shumë turistë janë, Liqeni i Fierzës, Shishtaveci, Kanionet e Gjallicës, etj. Zona ka gjithashtu histori e kulturë të gjerë, tradita vendase, shumëllojshmëri e produkte bujqësore, kulinari, të cilat janë potenciale mjaft të vlefshme për zhvillimin e turizmit në vend. Ndërkohë fokus të veçantë duhet të ketë edhe trashëgimia kulturore e zonës. Duke nisur me kalanë e Rozafës, e cila ngrihet mbi një kodër shkëmbore në perëndim të qytetit të Shkodrës, e deri tek pasuritë etnografike të zonës së Zadrimës dhe kështjellat e Sardës, Sapës dhe Danjës. Mbetet për t'u përmendur edhe zhvillimi i hotspotëve të reja turistike si Lumi i Shalës, i cili është kthyer në një atraksion të rëndësishëm turistik 2 vitet e fundit duke tërhequr një numër të madh vizitorësh vendas dhe të huaj.



Figura 7 – Pamje nga Lumi i Shalës

4.1.1.1. Projekte në mbështetje të turizmit

Tipologjitë e projekteve që mund të ndiqen nga KESH në këtë drejtim janë të shumta. Ajo që kërkon vëmendje emergjente në zonë është infrastruktura turistike, si konceptimi dhe shenjimi i shtigjeve të ecjes

malore, ndërtimi i info-pointeve, prodhimi dhe shpërndarja e hartave turistike, etj. Investimet në këtë drejtim mund të kryhen nga KESH-i në bashkëpunim me Bashkitë dhe bizneset turistike të zonës.

Vëmendje të veçantë duhet t'i kushtohet edhe diversifikimit të llojeve të turizmit që mund të kryhen në zonë. P.sh. nxitja e sporteve ujore duke nisur me peshkimin, zhytjen rekreative e deri tek garat ujore, përfaqësojnë tipologji të tjera projektesh në të cilat KESH-i mund të japë kontribujë. Në këtë kuadër, me mbështetjen e KESH mund të organizohen edhe evente periodike të sporteve ujore.

Përveç infrastrukturës dhe sporteve ujore, një drejtim tjetër që mund të ndihmojë turizmin lokal është promovimi dhe ruajtja e trashëgimisë kulturore të zonës. Zona e influencës së KESH përmban një larmishmëri shumë të madhe të trashëgimisë kulturore, duke nisur me Kulturën e Komanit, për të vazhduar me qytetet e lashta të Danjës e Drishtit, ndërtesat e shumta me status monument kulture e pasuritë etnografike të zonës së Zadrimës. Projektet që mund të implementojë KESH-i në këtë kuadër janë të shumta e mund të lidhen me ndërhyrje për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore përmes rikonstruksioneve, plotësimin e këtyre atraksioneve me infrastrukturën turistike (vendosje tabelash), promovimin dhe përfshirjen e tyre në itinerare turistike, etj.

4.1.1.2. Projekte në mbështetje të transportit ujor

Ndonëse mund të klasifikohen si projekte në mbështetje të turizmit, kjo tipologji projektesh ka një impakt pozitiv, si në lehtësimin e transportit dhe përmirësimin të aksesueshmërisë, ashtu edhe në mbështetje të ekonomisë lokale. Transporti ujor luan një rol të rëndësishëm në zonën e influencës, qoftë për turizmin ashtu edhe për lëvizjen e banorëve të zonës. Megjithatë, ky lloj transporti nuk është tërësisht formal dhe vuan nga mungesa e infrastrukturës. Në këtë kuadër, KESH mund të implementojë një sërë projektesh që lidhen me ndërtimin e moleve apo stacioneve të qëndrimit të varkave e traqeteve, formalizimin e tij, ndihmesën për të garantuar sigurinë e pasagjerëve, etj.

4.2. Objektivi Strategjik 3.2. Mbështetje për zhvillimin e arsimit

Duke qenë zona e influencës është një ndër zonat më të varfra të vendit, infrastruktura arsimore, sidomos në zonat rurale, lë shumë për të dëshiruar. Si pjesë e përgjegjshmërisë sociale, KESH-i do të kontribuojë në përmirësimin e infrastrukturës arsimore në zonë.

Arsimi është një nga shtyllat kryesore të zhvillimit ekonomik dhe luan një rol të rëndësishëm në suksesin e përgjegjshmërisë së korporatave. Investimi në arsim ofron dhe përfitime të mëtejshme për korporatat, të cilat duke punësuar individë të kualifikuar, përmbushin më me efikasitet misionin e tyre. Gjendja e infrastrukturës arsimore në zonën e influencës së KESH-i është problematike, duke qenë se kjo zone ka vuajtur izolimin, investimet e pakta në infrastrukturën arsimore dhe mungesë të instrumenteve, duke rezultuar në një mbulim të dobët me kopshte, shkolla 9-vjecare dhe shkolla të mesme në këtë territor. Kjo ka bërë që edhe banorët e zonës ta kenë të vështirë aksesin në arsim dhe nxënësit shpesh detyrohen të përshkojnë kilometra të tëra për të marrë formimin e duhur në institucionet arsimore.

Synimi i KESH-it është që nëpërmjet Planit të Veprimit të mos të kufizohet vetëm në zonën e influencës së aktivitetit, por të japë një kontribut gjithëpërfshirës në arsimin e vendit, në të gjitha hallkat e tij, pasi edhe vetë veprimtaria e KESH-it kërkon profesionistë që vijnë nga një gamë e gjerë sfondesh profesionale. Prandaj do të ishte në interesin e komunitetit dhe korporatës që përfitues të jenë jo vetëm banorët e zonave të interesit, por edhe institucionet arsimore që i përshtaten sfondit të profesionistëve që KESH-i kërkon në treg, duke përfshirë këtu edhe arsimin universitar.

Në nivel universitar, interesi i drejtpërdrejtë i KESH-it lidhet me Universitetin Politeknik të Tiranës, pasi është ky universitet ai që paraqet një tjetër treg rekrutimi potencial për KESH. Degët e Gjeodezisë, Inxhinierisë Energjetike, Inxhinierisë së Ndërtimit etj. paraqesin një horizont tjetër mjaft interesant, jo vetëm për punësimin dhe rekrutimin, por edhe për studime të ndryshme shkencore që mund t'i nevojiten KESH-it.

Një tjetër sferë arsimore që mund të përfshihet si përfituese e projekteve të KESH-it në kuadër të përgjegjshmërisë përgjegjshmërisë sociale të korporatës është ajo e arsimit profesional. Ky lloj arsimit është konsideruar si një nga prioritetet shtetërore në fushën e edukimit dhe ka disa institucione që potencialisht mund të përfitojnë nga projektet e KESH-it, siç janë Shkolla Elektrike "Gjergji Canco" në Tiranë dhe Shkolla e Ndërtimit "Kol Idromeno" në Shkodër. Arsimimi profesional do të krijonte kapital njerëzor të vlefshëm edhe për KESH-in dhe, nëpërmjet bashkëpunimit me këto shkolla, KESH-i mund të krijonte një horizont të ri shtesë për rekrutimin e korporatës.

Bazuar edhe në gjetjet e raporteve të mëparshme, disa fusha janë më problematike se të tjerat në drejtimin e projekteve që KESH-i mund të ndërmarrë në fushën e arsimit. Fokus kryesor i planit të veprimit të KESH-it duhet të jetë krijimi i ambienteve të përshtatshme për mësim në zonën e influencës, duke përfshirë edhe bazën materiale dhe mjetet mësimore. Problem i madh gjithashtu mbetet pamjaftueshmëria e teksteve mësimore dhe mospasja e aksesit për nxënësit në biblioteka, qofshin ato fizike apo dixhitale. Një problem tjetër madhor i infrastrukturës arsimore është mungesa e mjeteve mësimore, nga kabinetet IT a softwar-et e nevojshëm e deri tek mjetet demonstrative mësimore.

Për t'u fokusuar më tej tek përmirësimi i arsimit universitar nëpërmjet projekteve të përgjegjshmërisë sociale të korporatës, plani i veprimit fokusohet në forcimin e bashkëpunimit ekzistues midis Universiteteve dhe KESH-it. Ky bashkëpunim mund të zgjerohet në disa fusha, siç mund të jenë: financimi i studimeve për degë të caktuara, që janë në fushën e kompetencës së KESH-it, mbështetja e kërkimit shkencor në projekte të caktuara që mund t'i vijë në formë propozimesh strukturës që do ketë në kompetencë lëvrimin e fondeve për kërkime shkencore.

4.2.1. Tipologji projektsh në fushën e Arsimit

Marrëdhënia që KESH-i ka me institucionet e arsimit të lartë dhe profesional ka treguar se bashkëpunimi ndërmjet industrisë dhe arsimit mund të jetë tejet frytëdhënëse për të dyja palët. Universiteti Politeknik i Tiranës prej vitesh ka furnizuar KESH-in me inxhinierë të kualifikuar hidroteknikë, elektrikë, mekanikë e mjedisorë, ndërsa universitetet dhe qendrat e arsimit profesional kanë përfituar ekspertizën dhe specializimin që vetëm KESH-i mund t'u japë studentëve nëpërmjet stazheve dhe programeve të praktikave, apo vizitave mësimore në HEC-e. Nëpërmjet këtij Plani Veprimi, KESH-i planifikon të japë ndihmesën si korporatë në kuadër të përgjegjshmërisë sociale edhe në fushën e arsimit nëpërmjet skemave të financimeve të studimeve apo bursave dhe nëpërmjet ndihmesës në infrastrukturën arsimore.



Figura 8 – Vizitë studentore në HEC Vau I Dejës

4.2.1.1. Financime studimesh dhe marrëveshje me institucionet arsimore

Në mënyrë që marrëdhënia e mirë midis KESH dhe institucioneve arsimore të jetë e qëndrueshme, një nga tipologjitë e projekteve që KESH mund të ndërmarrë është financimi i bursave të studimeve në institucionet arsimore dhe qendrat e formimit profesional, në degët ku KESH mundet që pas mbarimit të studimeve t'u sigurojë përfituesve edhe stazhe apo vende pune. Këto bursa mund të targetojnë nxënësit me rezultate të larta apo të jepen për studentët me prejardhje nga zonat e influencës. Një tipologji tjetër projektsh do të përfshinte marrëveshjet e ndryshme që mund të bëhen me institucionet arsimore me në fokus kërkimin shkencor dhe hapjen e programeve të reja të studimit.

Një tjetër sferë arsimore që mund të preket nga projektet e KESH është arsimi profesional. Për të garantuar trajnimin e vazhdueshëm të fuqisë punëtore apo edhe për të mundësuar punësimin e të rinjve, KESH mund të bashkëpunojë me shkollat profesionale apo Qendrat e Formimit Profesional, kryesisht qendrën në Shkodër dhe qendrën e lëvizshme që mbulon zonën verilindore. Arsimi profesional është një nga prioritetet në nivel kombëtar dhe financimi i këtij sektori nga ana e KESH për të krijuar kurrikula të reja, për të siguruar mjetet mësimore apo për të ndihmuar me kryerjen e praktikave mësimore do të ishte një benefit i të gjitha palëve.

4.2.1.2. Projekte investimi në infrastrukturë arsimore

Infrastruktura arsimore e zonës së influencës së KESH është ndër më të amortizuara e vendit. Investimet në infrastrukturën arsimore do të sillnin një benefit madhor për zonën, pasi arsimimi do të çelte dyer të reja formimi për popullatën, duke kontribuar në zhvillimin e përgjithshëm të këtij territori. Investimet në këtë zonë në secilin aspekt të infrastrukturës arsimore, qoftë rikonstruksioni i godinave, instalimi i sistemeve të ngrohjes, blerja e bazës materiale dhe mjeteve mësimore për kopshtet do të mirëpriteshin nga komuniteti në zonën e influencës.

4.3. Objektivi Strategjik 3.3. Mbështetje për grupet vulnerabël

Duke qenë një zonë e izoluar dhe me zhvillim të ngadaltë ekonomik, përjashtimi social është një fenomen jo i rrallë. Prandaj, si pjesë e përgjegjshmërisë sociale, KESH do të angazhohet edhe në masa e inisiativa për përfshirjen dhe mbrojtjen sociale.

Qëndrueshmëria Sociale dhe përjashtimi social pasqyrojnë pengesat kryesore afatgjata të zhvillimit në zonën e influencës së KESH. Kthimi i vëmendjes tek shtresat në nevojë në lidhje me mundësitë ekonomike dhe sociale dhe rritjen e investimeve që synojnë rritjen e përfshirjes së këtyre shtresave, do të kishte një ndikim domethënës në rritjen e mirëqënjes së kësaj zone.

Që të arrihet qëndrueshmëria sociale duhet të krijohet një shoqëri gjithëpërfshirëse dhe elastike ku zëri i qytetarëve të dëgjohet në çdo kohë të respektohet, të mbështetet dhe të jetë një përgjegjësi publike për organet kompetente. Qëndrueshmëria sociale ka të bëjë gjithashtu me zgjerimin e mundësive për të gjithë banorët e zonës. Së bashku me qëndrueshmërinë ekonomike dhe mjedisore, qëndrueshmëria sociale është thelbësore për uljen e varfërisë dhe rritjen e prosperitetit. Pikërisht për këtë arsye KESH planifikon të shtrijë projektet në kuadër të përgjegjshmërisë sociale të korporatës edhe në këtë fushë duke prekur kështu një numër sferash të jetës në zonën e influencës.

Për komunitetet që jetojnë në territore sfiduese, siç janë zonat e influencës së KESH, objektivi i projekteve të Planit të Veprimit do të jetë krijimi i mundësive që këto komunitete të mund të lulëzojnë. Kjo arrihet duke punuar për të ndërtuar komunitete të forta, duke mundësuar ndërtimin e kohezionit shoqëror, si dhe duke rritur mundësitë e përballimit të goditjeve ekzogjene, siç është ndryshimi i klimës (kujtojmë se lëvizja në disa territore gjatë stinës së dimrit është praktikisht e pamundur duke parë dhe infrastrukturën). Në aspektin social përmendim ofrimin e ndihmave jetike për çdo familje që është në nevojë, si pako me ushqime, veshje, etj.

Thelbi i tipologjive të projekteve të Planit të Veprimit të KESH përqendrohet në fuqizimin e komuniteteve duke u dhënë rrugëzgjdhje problemeve të tyre për uljen e varfërisë. Duke u mbështetur në qasjet pjesëmarrëse dhe vlerat dhe traditat e komunitetit, projektet do të përmirësojnë shërbimet e komunitetit dhe infrastrukturën bazë për të ndihmuar banorët, veçanërisht ata më të prekur, të arrijnë potencialin e tyre dhe të zhvillojnë jetesën e tyre. Projektet gjithashtu do të synojnë të forcojnë kapacitetin e banorëve dhe drejtuesve të komunitetit për të artikuluar nevojat e tyre dhe për t'u angazhuar me qeverisjen lokale.

Shërbimet publike në nivel lokal janë elementi më i rëndësishëm që ndikon drejtpërdrejt në cilësinë e jetesës së komuniteteve lokale dhe në mundësitë e zhvillimit social të zonës. Shërbimet që i ofrohen popullatës janë një element i rëndësishëm në të kuptuarit e cilësisë së jetesës të një popullate të caktuar, pasi ajo prek drejtpërdrejt jetën e individëve të shoqërisë. Edhe në sferën e shërbimeve publike KESH mund t'i ndihmojë këto komunitete nëpërmjet lobimit që vëmendja që u kushtohet të jetë maksimale.

Ndihmesa për zhvillimin e ekonomisë lokale përben një nga ndërhyrjet më të rëndësishme që mund të ndërmarre KESH në kuadër të përgjegjshmërisë sociale dhe korporative, sidomos kur merret në konsideratë

fakti që zona e influencës ka zhvillimin më të ulët ekonomik në shkallë vendi. Dy shtyllat e ekonomisë së zonës së influencës janë bujqësia dhe turizmi prandaj edhe projektet që KESH synon të ndërmarrë lidhen me këto dy fusha.

4.3.1.1. Projekte në mbështetje të bujqësisë dhe belgtorisë

Qarqet Kukës dhe Shkodër mbështeten shumë të bujqësia dhe, në zonat më të thella, edhe të blegtorisë. Projektet që mund të implementojë KESH për mbështetjen e këtyre sektoreve lidhen me promovimin e produkteve të zonës, duke organizuar panairë me produkte lokale apo duke ndihmuar në krijimin e brandeve lokale.

Një tjetër tipologji projektesh mund të jetë ndihmesa për lehtësimin e daljes në treg të këtyre produkteve duke shfrytëzuar transportin ujor përmes kaskadës së Drinit.

4.3.1.2. Fushata mbështetjeje për grupet vulnerabël dhe kohezioni social

Nëpërmjet aktiviteteve të ndryshme për mbështetjen komunitare ndaj grupeve vulnerabël, Plani i Veprimit të KESH do të synojë rritjen e kohezionit social, afrimin e komuniteteve me njëri tjetrin, si dhe përfshirjen e grupeve më vulnerabël në shoqëri.

Kjo tipologji projektesh mund të përfshijë organizimin e eventeve me grupe vulnerabël siç janë të moshuarit e zonës ose me fëmijët jetimë. Angazhimi social për të përkrahur kategori të tilla do ndihmonte komunitetin e zonës të edukohej me një përjasje më moderne në trajtimin e këtyre personave, duke kthyer vëmendjen nga to në raste nevojë.

Në muajin tetor, në ditën botërore për të moshuarit, mund të organizohen evente argëtuese për këtë grup moshe, si dhe të vlerësohet mundësia që ky grup moshe të ketë qendra ditore për të kaluar një pjesë të ditës.

Përsa u përket fëmijëve jetimë, mund të ideohen dhe realizohen aktivitete, të zhvillohen konkurse për t'i nxitur fëmijët në sfida të ndryshme, si dhe të dhurohen lodra.

5. Analiza e Strukturës Organizative të KESH-it

Zbatimi i Strategjisë së Përgjegjshmërisë Sociale të Korporatës dhe i Planit të Veprimit kërkon, përveç krijimit të një fondi të veçantë në Programin Ekonomik të shoqërisë, edhe angazhimin e burimeve të

mjaftueshme njerëzore. Më poshtë vijon një analizë e Strukturës aktuale të KESH sa i përket përgjegjshmërisë sociale e ndjekur nga disa rekomandime mbi ndërhyrjet e mundshme në këtë strukturë për të përmbushur parashikimet e Strategjisë dhe Planit të Veprimit.

5.1. Struktura Aktuale

Sektori i Përgjegjshmërisë Social-Mjedisore ka si detyrë kryesore menaxhimin e çështjeve sociale dhe mjedisore, në përputhje me kërkesat e legjislacionit vendas dhe ndërkombëtar, dhe në përputhje me objektivat strategjike të KESH sh.a. Sektori ndodhet brenda Departamentit të Zhvillimit Strategjik nën varësinë direkte të Drejtorisë së Koordinimit dhe Zhvillimit. Ky sektor përbëhet nga një Shef Sektori dhe tre Specialistë, në total 4 punonjës.



Sektori i Përgjegjshmërisë Social-Mjedisore ka ndërmarrë projektet e veta në disa fusha. Fushat kryesore ku është operuar deri tani kanë qënë edukimi, vullnetarizmi dhe aktivitetet sensibilizuese. Në kuadër të vullnetarizmit, veprimtaritë e deritanishme kanë variuar nga ato shëndetësore (dhurimi i gjakut për fëmijet talasemikë, trajnimet e kryqit të kuq etj.) deri tek ato ekologjike siç mund të konsiderohen aktivitetet vullnetare të pastrimit që janë kryer nga vetë stafi i KESH. Në sferën e edukimit, KESH në bashkëpunim me shkollën 9-vjeçare dhe të mesme e profesionale kanë realizuar vizita edukative në impjantet e HEC-eve, organizimin e muajit të librit dhe një aktiviteti tjetër për dhurimin e librave, por edhe kanë ndihmuar në përmirësimin e infrastrukturës shkollore, si në rastin e dhurimit të një laboratorit informatike shkollës "Asim Vokshi" në qytetin e Bajram Currit.

Teksa mund të thuhet që aktiviteti dhe përpjekjet e deritanishme të këtij sektori kanë qënë të lavdërueshme, në mungesë të një strategjie drejtuese të gjithë aktivitetit në kuadër të përgjegjshmërisë sociale të korporatës, duhet përmendur që qasja për organizimin, identifikimin e projekteve dhe implementimin e tyre nuk ka qënë e strukturuar sipas një qëllimi afatgjatë.

Një qasje e tillë vërtet promovon nisma të mira, por është e pa strukturuar, duke bërë që përpjekjet e KESH të drejtohen ndonjëherë edhe në fusha që janë më pak prioritare se fusha të tjera më të rëndësishme për korporatën. Gjithashtu mungesa e një rregulloreje apo direktive të saktë për mënyrën se si projektet do të lëvrohen dhe menaxhohen, ka bërë që KESH përgjithësisht të ndërmarrë nisma të vogla, duke mos e përmbushur potencialin e organizatës në këtë drejtim. Një tjetër problem që lind nga kjo qasje është mospërmbushja e projekteve shpesh brenda afatit, si pasoje e mungesës së një kuadri të saktë për menaxhimin e tyre.

Tanimë, me ekzistencën e kësaj strategjie, rekomandohet një riorganizim i strukturës që do të menaxhojë këtë aspekt të veprimtarisë së KESH. Ky organizim duhet të kryhet në atë mënyrë që të sjellë maksimumin e efikasitetit në veprimtarinë e Sektorit të Përgjegjshmërisë Social-Mjedisore. Nryshimet strukturore dhe

organizative do të ndihmojnë këtë sektor të drejtojë nga fillimi deri në fund projektet në kuadër të përgjegjshmërisë sociale, duke nisur nga ideimi dhe identifikimi i tyre e deri tek implementimi dhe përfundimi i tyre.

5.2. Rritja e Kapaciteteve të Sektorit të Përgjegjshmërisë Sociale-Mjedisore

Sapo Strategjia e Përgjegjshmërisë Sociale të fillojë të implementohet, Sektori i Përgjegjshmërisë Social-Mjedisore do të jetë pika fokale e procesit të jetësimit të projekteve. Ky sektor do të jetë përgjegjës për angazhimin e vazhdueshëm të palëve të interesit, identifikimin e projekteve, administrimin e procedurave si edhe ndjekjen e zbatimit të tyre. Për të gjitha këto arsye, rekomandohet që stafi i Sektorit të Përgjegjshmërisë Sociale-Mjedisore të shtohet me dy punonjës të rinj të cilët duhet të kenë aftësi profesionale të ndryshme nga punonjësit aktualë, duke mbuluar kështu fushat e reja të përgjegjshmërisë sociale, si turizmi apo infrastruktura.

6. Instrumentet e Implementimit të PSK

KESH-i është një shoqëri tregtare me kapital 100% shtetëror, pronësi e cila përfaqësohet nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, që veprimtarinë e tij e ushtron në përputhje me Ligjin Nr. 9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" (i ndryshuar), Ligjin Nr.43/2015 „Për sektorin e energjisë elektrike" (i ndryshuar) dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore në fuqi. Sistemi i administrimit të shoqërisë është me dy nivele. Shoqëria administrohet nga Administratori, i cili emërohet dhe mbikqyret nga Këshilli

Mbikqyrës që emërohet nga Asambleja e Aksionerëve, e cila përfaqësohet nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.

Duke qenë shoqëri me kapital shtetëror, të gjitha shpenzimet e KESH janë objekt i Ligjit Nr. 9643, date 20.11.2006 "Për prokurimin publik" (i ndryshuar). Prej këtu, çdo shpenzim që KESH synon të realizojë që nuk është sponsorizim përfshirë edhe investimet apo financimet për projekte mjedisore apo sociale në përfitim të publikut apo komunitetit vendor ku shoqëria ushtron aktivitetin ekonomik, duhet të realizohet përmes procedurave të prokurimit publik.

Nga ana tjetër, në përputhje me Ligjin Nr. 7892, date 21.12.1994, "Për Sponsorizimet" (i ndryshuar), KESH mund të financojë projekte në fushën e veprimtarive sociale e publike "ku përfshihen veprimtaritë humanitare, kulturore e artistike, sportive, edukative, arsimore, ekologjike dhe vepra letrare, shkencore dhe enciklopedike si dhe botuesve të shtypit".

Përveç sa parashikohet në Ligjin "Për sponsorizimet", KESH sh.a. veprimtarine e tij për venien në zbatim të përgjegjshmërisë sociale e realizon bazur dhe në referim të dispozitave të Kodit Civil ku përmendim por pa u kufizuar marrëdhëniet e krijuara nepermjet dhurimit, financimit dhe huapërdorjes me të tretet përfitues (rasti i implementimit të drejtëpërdrejt nga KESH sh.a.).

Në përputhje me legjislacionin e sipër-përmendur, projektet e parashikuara në këtë Plan Veprimi, mund të implementohen përmes instrumentave të mëposhtme:

- 1- Implementimi i drejtëpërdrejtë nga KESH, i projekteve për të cilët KESH-i do të zbatojë kërkuesat e legjislacionit të prokurimit publik, përfshirë dhënien e ndihmave materiale (në ushqime apo mjete të tjera të nevojshme) për komunitetet e prekura në formën e sponsorizimeve materiale
- 2- ;
- 3- Implementimi/prokurimi nga Bashkitë përmes marrëveshjeve të financimit apo bashkë-financimit me këto të fundit në formën e sponsorizimeve financiare;
- 4- Implementimi nga shoqatat jo-fitimprurëse përmes marrëveshjeve të sponsorizuesve të financimit, apo bashkëfinancimit për këto të fundit;

Më poshtë vijon një analizë e këtyre instrumenteve.

6.1. Përshkrim i Proceseve të Implementimit

Të gjitha projektet e parashikuara në kuadër të PSK-së së KESH do të implementohen në përputhje me kërkesat e legjislacionit sektoral dhe do të kontabilizohen në përputhje me standartet e kontabilitetit, duke garantuar transparencën dhe llogari-dhënien. KESH-i duhet të mbajë parasysh që niveli i vlerës së sponsorizimit në një vit kalendarik nuk duhet të jetë më i madh se 3% i shpenzimeve totale të shoqërisë, të cilat njihen nga autoritetet fiskale si shpenzimeve të pataknuara.

Me miratimin e Strategjisë së Përgjegjshmërisë Sociale të Korporatës dhe Planit të Veprimit, KESH do të përfshijë në Programin Ekonomik një fond të veçantë për përgjegjshmërinë sociale. Ky fond do të detajohet përgjatë vitit financiar në bashkëpunim me palët e interesit, sipas kritereve dhe procedurave të mëposhtme.

6.1.1. Identifikimi i projekteve

Identifikimi i projekteve do të bëhet në bashkëpunim me palët e interesit, në zbatim të Planit të Angazhimit të Palëve të Interesit. KESH do të krijojë një Komitet për Përgjegjshmërinë Sociale, ku do të ftohen të jenë të përfaqësuar edhe bashkitë, institucionet e tjera vendore dhe rajonale, si edhe përfaqësues të shoqërisë civile apo biznesit. Gjithashtu, KESH do të ngrejë edhe dy zyra rajonale, në Kukës dhe Shkodër, përmes të cilave të administrohet procesi i angazhimit të palëve të interesit e do të jepet informacion mbi veprimtarinë sociale dhe mjedisore të KESH-it. Këto dy zyra rajonale do të koordinohen nga Sektori i Përgjegjshmërisë Social-Mjedisore. Persona fizikë apo juridike mund të propozojnë projekte të mundshme gjatë gjithë vitit përmes zyrave rajonale.

Komiteti i Përgjegjshmërisë Sociale do të mbledhet në mënyrë periodike, çdo muaj apo çdo tre muaj, për të diskutuar idetë dhe projektet e propozuara që mund të implementohen në kuadër të përgjegjshmërisë sociale. Për projektet që do të përzgjidhen, Komiteti do të japë këshillat dhe udhëzimet e tij, lidhur me instrumentet për implementimin e tyre. Me përzgjedhjen e projektit, përcaktimin e instrumentit dhe fondit të nevojshëm, Sektori i Përgjegjshmërisë Social-Mjedisore do të koordinojë punën me departamentet e tjera

brenda KESH për përgatitjen e vendimit dhe relacionit për t'u miratuar nga Këshilli Mbikqyrës. Duke qenë se në Programin Ekonomik fondi për përgjegjshmërinë sociale do të jetë i padetajuar, çdo projekt që do të implementohet përmes këtij fondi do të miratohet nga Këshilli Mbikqyrës, së bashku edhe me procedurat e implementimit.

Procedurat që do të ndiqen për secilin nga instrumentet e implementimit, detajohen më poshtë.


6.1.2. Implementimi i Projekteve

6.1.2.1. Implementimi i Drejtpërdrejtë nga KESH

Në të gjitha rastet kur tipologjia e projekteve përfshin ndërhyrje infrastrukturore apo blerje të mallrash dhe shërbimesh, përfshi edhe organizimin e aktiviteteve, ku nga shoqëria do të vendoset që implementimi do të bëhet nga vetë KESH, do të zbatohen dispozitat e Ligjit Nr. 9643, date 20.11.2006 "Për prokurimin publik" (i ndryshuar). Në të gjitha rastet kur projekti parashikon investime në asetet e një institucioni tjetër, hapi i parë do të jetë lidhja e një Marrëveshjeje Bashkëpunimi ose Kontratë Dhurimi me këtë institucion.

Në të gjitha këto raste, Sektori i Përgjegjshmërisë Social-Mjedisore do të koordinojë punën me Drejtorinë Ekonomike dhe Drejtorinë e Prokurimit për përgatitjen e Vendimit të Këshillit Mbikqyrës për miratimin e projektit dhe detajimin e fondit për të. Me miratimin nga Këshilli Mbikqyrës, Drejtoria e Prokurimeve do të ndjekë procedurat standarte të prokurimit publik sipas dispozitave të Ligjit Nr. 9643, date 20.11.2006 „Për prokurimin publik" (i ndryshuar).

Në mënyrë skematike, procedurat për implementimin e projekteve sipas këtij instrumenti, paraqiten në diagramën më poshtë.




6.1.2.2. Implementimi nga Bashkitë

Në rastet kur si instrument do të përcaktohet implementimi nga bashkitë apo institucionet e tjera rajonale apo vendore, hapi i parë do të jetë lidhja e Marrëveshjes së Financimit apo Bashkë-Financimit, e cila do të koordinohet nga Sektori i Përgjegjshmërisë Social-Mjedisore dhe Drejtoria Juridike. Në këtë Marrëveshje do të përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e palëve, masa e financimit si edhe destinacioni i tij. Më pas, Sektori i Përgjegjshmërisë Social-Mjedisore në bashkëpunim me Drejtorinë Ekonomike dhe Drejtorinë Juridike do të hartojnë Vendimin e Këshillit Mbikqyrës për detajimin e fondit dhe financimin e projektit. Vendimi i Këshillit Mbikqyrës do të bëjë edhe miratimin e Marrëveshjes.

Me miratimin nga Këshilli Mbikqyrës, Sektori i Përgjegjshmërisë Social-Mjedisore do të ndjekë implementimin e projektit ndërsa Drejtoria Ekonomike do të bëjë ekzekutimin e pagesave në përputhje me përmbajtjen e Marrëveshjes. Në çdo rast projektet do të financohen ose bashkë-financohen sipas një marrëveshjeje specifike sponsorizimi sipas Ligjit Nr. 7892, date 21.12.1994, "Për Sponsorizimet" (i ndryshuar).

Në mënyrë skematike, procedurat për implementimin e projekteve sipas këtij instrumenti, paraqiten në diagramën më poshtë.



6.1.2.3. Implementimi nga Shoqatat Jofitimprurëse


Për projektet ku si instrument implementimi do të përzgjidhet implementimi nga Shoqatat Jofitimprurëse do të zbatohen dispozitat e Ligjit Nr. 7892, date 21.12.1994, "Për Sponsorizimet" (i ndryshuar). Në përputhje me kufijtë monetarë të caktuar në këtë ligj, sponsorizimet për OJF-të do të bëhen duke ndjekur procedurën e mëposhtme:

Komiteti i Përgjegjshmërisë Sociale identifikon projektet dhe vlerëson propozimet e ardhura drejt KESH nga OJF të ndryshme. Pasi projekti që do kalojë në implementim zgjidhet pasi kalon dhe analizën e shpenzimeve dhe të preventivit, fillon procedura e zbatimit.

Fillimisht do të hartohet një Marrëveshje Sponsorizimi apo Kontratë Dhurimi, e cila do të ketë të detajuara të drejtat dhe përgjegjësitë e palëve si edhe masën e fondit dhe destinacionin e tij. Më pas, kjo Marrëveshje do të miratohet nga Këshilli Mbikqyrës së bashku me vendimin për detajimin e fondit për përgjegjshmërinë sociale.

Me miratimin nga Këshilli Mbikqyrës, Sektori i Përgjegjshmërisë Social-Mjedisore do të ndjekë zbatimin e kontratës ndërsa Drejtoria Ekonomike do të bëjë ekzekutimin e pagesave.

Në mënyrë skematike, procedurat për implementimin e projekteve sipas këtij instrumenti, paraqiten në diagramën më poshtë.




6.1.2.4. Dhënia e ndihmave materiale për komunitetet e prekura në formën e sponsorizimeve materiale

Në rastet kur projektet e përgjegjshmërisë sociale do të implementohen përmes skemave të dhënies së ndihmave materiale për komunitetet e prekura (në ushqime apo mjete të tjera të nevojshme), do të ndiqet një procedure e ndryshme nga sa më sipër. Fillimisht, me Urdhër të Administratorit do të ngrihet një Grup Pune për konceptimin dhe administrimin e skemës së sponsorizimit. Ky grup pune do të hartojë një Rregullore ku do të përcaktohet objekti i thirrjes, kriteret e pjesëmarrjes, kriteret e përzgjedhjes si edhe afatet procedurale. Gjithashtu, në këtë Rregullore do të përcaktohet edhe madhësia e ndihmës. Kjo Rregullore do të miratohet nga Këshilli Mbikqyrës bashkë me buxhetin total të vendosur në dispozicion të thirrjes.

Me miratimin nga Këshilli Mbikqyrës, Sektori i Përgjegjshmërisë Social-Mjedisore do të koordinojë lançimin e thirrjes, promovimin e saj, administrimin e aplikimeve si edhe njoftimin e fituesve, në përputhje me kriteret dhe procedurat që do të përcaktohen në Rregullore. Me përfituesit do të lidhet një Kontratë, përmbushja e të cilës do të mbikqyret nga Grupi i Punës që do të ngrihet.

Në mënyrë skematike, procedurat për implementimin e projekteve sipas këtij instrumenti, paraqiten në diagrmën më poshtë.



7. Aneks 1: Procedura e implementimit të sponsorizimit

7.1. Teksti I thirrjeve për projekt propozime

Në kuadër të zbatimit të Strategjisë të Përgjegjshmërisë Sociale të Korporatës, si dhe të vendosjes së një bashkëpunimi të qëndrueshëm me pushtetin lokal, agjensitë, organizatat jofitimprurëse, biznesin, komunitetin dhe grupe të tjera të interesit në zonat pranë HEC-eve nën administrim, KESH sh.a. ju fton të dërgoni propozimet dhe sugjerimet tuaja për aktivitete/investime/projekte të cilat ju i konsideroni prioritare në zonat që mbulon. Më konkretisht, do t'ju luteshim të na dërgoni propozimet tuaja në fushat:

Mjedisore

- Projekte kundër erozionit, sidomos pranë rezervuareve të HEC-eve, si dhe masa për mbrojtjen nga erozioni në pyje;
- Projekte kundër përmblytjeve, propozimime masash për ndihmesën dhe informimin për zonat që rrezikojnë përmblytjen, skema të veçanta sigurimi etj;
- Masa për menaxhimin e mbetjeve, veçanërisht nëse ka ndikim në ujëra apo rezervuaret pranë HEC-eve (vendosja e koshave, sistemeve të transferimit të mbetjeve, makineri);
- Gjelbërime, mbjellje pemësh në shkolla, qendra qytetesh;

- Rritja e efijencës së energjisë në banesa, izolimi i godinave publike, përdorimi i burimeve të energjisë së rinovueshme (psh instalimi i paneleve diellore në godina publike apo rrugë), instalimi i infrastrukturës inovatore që zbaton parimet e efijencës energjitike.

Sociale

Aktivite sociale rekreative, sportive dhe edukuese për komunitetin ose më gjerë.

- Përmirësimi i kushteve akomoduese apo mësimdhënëse në shkolla;
- Përmirësimi i shërbimeve, aksesit dhe infrastrukturës, veçanërisht në fshatrat pranë HEC-eve;
- Përmirësimi i infrastrukturës turistike;
- Nisma në funksion të komuniteteve lokale.

Propozimet duhet të dorëzohen zyrtarisht pranë Korporatës Elektroenergjitike Shqiptare në adresën: Rr. Viktor Eftimiu, Nr. 12, Tiranë, Shqipëri, brenda datës XX/ XX/ 2021.

7.2. Formati tip i aplikimit

FORMULAR APLIKIMI PËR SPONSORIZIME FINANCIARE

1. Informacion i përgjithshëm

Informacion i përgjithshëm për organizatën aplikuese	
Emri i organizatës	
Adresa	
Website / Kontakt	
Përfaqësuesi Zyrtar	
Drejtuuesi i Projektit	

2. Përshkrimi i projektit

2.1. Përshkrim i Përgjithshëm i Projektit

Titulli, qëllimi, fusha e aplikimit, përfituesit, kohëzgjatja, vendndodhja, rezultatet e pritshme, buxheti në lekë (pa TVSH).

2.2. Aktivitetet e Projektit

(Përshkruani aktivitetet që do të implementohen.)

2.3. Objektivat specifik të projektit

(Ju lutemi listoni objektiva që janë të saktë, të matshëm, të arritshëm dhe relevantë.)

2.7. Monitorimi dhe performanca e projektit

(Ju lutemi shpjegoni se si organizata juaj do të monitorojë zbatimin dhe performancën e projektit dhe tregoni një ose më shumë tregues për secilin aktivitet, që do të përdoren për të vlerësuar progresin dhe performancën e projektit, dhe arritjen e rezultateve të pritura.)

2.6. Rezultatet e pritura të projektit

(Ju lutemi shpjegoni se cili do të jetë rezultati fundor i pritshëm i projektit të propozuar mbi situatën e përfituesve përfundimtarë.)

3. Plani i zbatimit

Specifikimi i afatit kohor për zbatimin e projektit, të ndarë sipas secilit aktivitet

Aktiviteti	Zbatimi dhe afati kohor
Totali i kohës	

4. Buxheti I Projektit

Në këtë hapësirë vendosni buxhetin e detajuar të projektit.

5. Dokumentacion plotësues

Lista e dokumentacionit që aplikanti duhet të paraqesë bashkëlidhur me aplikimin:

1. Kopje e çertifikatës së regjistrimit në QKB, ose Vendim Gjykatë në rastin e OJF-ve;
2. CV-të e stafit që do të angazhohet në projekt;
3. Kopje e raporteve financiare të vitit të mëparshëm të organizatës;
4. Portofol prezantues I projekteve që ka realizuar më parë organizata.

6. Informacion shtesë


Cdo informacion që mund të shërbejë për argumentimin më të mirë të projektit.

Data e aplikimit: _____

Përfaqësuesi i organizatës (emer, mbiemër, nënshkrimi) _____

7.3. Formati i raportimit për aktivitetet

Rezultatet e pritura	Aktivitetet e planifikuara	Periudha e implementimit në Muaj												Pala e përgjegjshme për aktivitetin	Shuma në LEK	
		1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12		Viti ____	
															KESH	Palë të tjera



Kjo Marrëveshje Sponsorizimi ("Marrëveshja") përcakton termat dhe kushtet e kontributit financiar (sponsorizimi) që do të jepet nga Sponsorizuesi për Përfituesin drejt zbatimit të projektit "_____" ("Projekti").

I. Angazhimet Financiare

1. Pagesa e vleres se sponsorizuar

Shuma totale e kontributit është _____ ALL (shuma e shprehur në fjalë).

Shuma do t'i paguhet Përfituesit si pjesë e ekzekutimit të kësaj Marrëveshjeje.

Nëse pagesa do të bëhet me këste, jepni një plan të detajuar të pagesës.

2. Shfrytëzimi i fondeve

- (a) Sponsorizimi financiar kesaj Marreveshje do të përdoret vetëm për qëllimin e përshkruar në detaje të mëtejshme nëSeksionin II.2. të kësaj Marrëveshjeje.
- (b) Ndryshimet kryesore midis kategorive të shpenzimeve që mund të konsiderohen të nevojshme në zbatimin e aktiviteteve të Projektit kërkojnë miratimin paraprak me shkrim nga Sponsorizuesi.
- (c) Çdo fond i sponsorizimit që nuk është shteruar në kohën e përfundimit të Projektit do t'i kthehet Sponsorizuesit, përveçse kur bihet dakord ndryshe me shkrim nga Sponsorizuesi dhe Përfituesi.

II. Përshkrimi dhe Zbatimi I Projektit

1. Periudha e zbatimit

Projekti do të fillojë në datë ___/___/___ dhe do të përfundojë në datë ___/___/___.

Për çdo zgjatje të datës së përfundimit të projektit do t'i kërkohet autorizim me shkrim Sponsorizuesit, përpara arritjes së datës origjinale të përfundimit të projektit dhe kërkon miratimin po me shkrim nga donatori. Njoftimi duhet të përfshijë një argumentim për një zgjatje të afatit dhe informacion mbi datën e propozuar të re të përfundimit të projektit, si dhe çdo datë të re të propozuar për dorëzimin e raporteve të pazgjidhura financiare dhe/apo narrative.

2. Përshkrimi I projektit.

Ju lutemi jepni një përshkrim të hollësishëm të Projektit, duke përfshirë vendndodhjen / fokusin / popullsinë e synuar / objektivat specifike / aktivitetet dhe shërbimet / rezultatet e pritura.

II. Raportimi narrativ dhe financiar

Raportet narrative dhe financiare që mbulojnë tërë kohëzgjatjen e Projektit do t'i dorëzohen Sponsorizuesit brenda 2 muajve nga Data e Përfundimit të Projektit.

Nëse është e aplikueshme, ju lutemi specifikoni skedulën për dorëzimin e Raporteve të Periodike.

Pranuar dhe rënë dakord në emër
të Sponsorizuesit:

Pranuar dhe rënë dakord në emër
të Përfituesit:

Firma:

Firma:

.....

.....

Emri i Plotë:

Emri i plotë:

Pozicioni:

Pozicioni:

Data:

Data:

Vendi:

Vendi:

7.5. Rregullorja e aplikimit

RREGULLORJA E APLIKIMIT PËR SPONSORIZIME FINANCIARE

1. KESH do të ofrojë burime financiare në formën e sponsorizimeve në mbështetje për projekte që përfshijnë aktivitete specifike sipas kushteve të shpallura në thirrjen për projektpropozime dhe brenda fushëveprimit të Planit të Veprimit për Përgjegjshmërinë Sociale të Korporatës.
2. Komiteti mbi Përgjegjshmërinë Sociale, me mbështetjen e Sektorit të Përgjegjshmërisë Sociale-Mjedisore, kryen identifikimin e projekteve të mundshme që mund të financohen nga KESH.
3. Pasi projektet identifikohen, për çdo projekt krijohet një grup i posaçëm për ndjekjen dhe implementimin e projektit.
4. Çdo procedurë sponsorizimi financiar për projekte në Kuadër të PSK do të vlerësohet dhe miratohet nga Këshilli Mbikqyrës i KESH sh.a mbështetur në opinionin e Komitetit të Përgjegjshmërisë Sociale të Korporatës.
5. Me marrjen e miratimit nga Këshilli Mbikqyrës, kryhet procedura e hapjes së thirrjes për zbatimin e projektit. KESH shpall në faqen zyrtare të Internetit udhëzimet për thirrje për propozime, formularin e aplikimit, formularin e buxhetit, kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve fitues, një




Projektet e përzgjedhura bazuar në thirrjen e KESH sh.a. për aplikime në kuadër të Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Përgjegjshmërinë Sociale të Korporatës

Renditja	Aplikuesi	Statusi	Titulli	Shuma (pa TVSH)	Sektori	Përshkrim i shkurtër i projektit	Skema e Implementimit
1	Bashkia Kukës	Shtet	Administrimi dhe menaxhimi i mbetjeve plastike lundruese në liqenin e Fierzës	4,000,000	Mjedis	Projekti përqëndrohet në liqenin e Fierzës dhe parashikon sensibilizim, pastrim, ndarje të mbetjeve në burim, por edhe blerje makinerie pastrimi dhe rrijetave për grumbullim e mbetjeve.	Prokurim nga KESH
2	Bashkia Shkodër	Shtet	Masa kundër erozionit në brigjet e Bunës / ripyllëzim në zonat që përmythen	9,766,910	Mjedis	1. Ripyllëzimi me lloje të përshatshme për mjedisin ekologjik bazuar në kërkesat e komunitetit që e rrethon, për mbrojtjen nga përmytjet që shkakton lumi Buna. 2. Sensibilizimi i njëkohshëm i komunitetit të zonës për rëndësinë e ruajtjes së mjedisit dhe vecanërisht të shtimit të këtij mjedisi në brigjet e Lumit Buna dhe në afërsi të tij.	Prokurim nga KESH
3	Bashkia Vau i Dejës	Shtet	Ndërtim i cative te pallatet 2-katëshe	29,893,675	Sociale	Për shkak të kushteve të motit dhe mungesës së infrastrukturës së përshatshme, banorët e palleteve 2-katëshe në bashkinë e Vaut të Dejës, të cilat janë pallate të ndërtuara njëkohësisht me HEC-et dhe ku banojnë punonjës dhe ish-punonjës të HEC-eve, nuk janë në kushte të përshatshme. Projekti parashikon rinovimin e cative me materiale hidroizoluese dhe rezistente ndaj erës.	Prokurim nga KESH
4	Spitali rajonal Shkodër	Shtet	Riparim /mirëmbajtje ashensorësh	5,500,000	Sociale		Prokurim nga KESH

Projektet e përgjiedhura bazuar në thirrjen e KESH sh.a. për aplikime në kuadër të Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Përgjegjshmërinë Sociale të Korporatës

5	Shoqata e Aeronautikës Shqiptare	OJF	Financimi i paragjideve	1,968,000	Kulturë/sport	Blerja e 5 paragjideve të përshtatshme për të marrë pjesë në evente kombëtare e ndërkombëtare. Ato do të pajisen me logon e KESH	Implementim nga OJF/sponsorizim
6	Shkolla Arben Broci Shkodër	Shtet	Vendosja e kompjuterave dhe paneleve fotovoltaike në shkollë	6,666,667	Sociale/arsim	Pajisja e 3 laboratorëve të shkollës me kompjutera dhe pajisje laboratorike për shkollën me profil elektrik mekanik dhe panele diellore për prodhimin e energjisë	Prokurim nga KESH
7	Bashkim Shoqatash (AARHUS, Well Point, Wild Europe)	OJF	Resurset natyrore Drin - Bunë	3,000,000	Mjedis/turizëm	Ky projekt konsiston në promovimin e resurseve natyrore përmes ndërveprimit dhe fuqizimit të të rinjve. Përmes këtij projekti synohet përmirësimi i situatës mjedisore dhe rritja e mirëqënies socio-ekonomike të komuniteteve në basenin Drin-Bunë.	Implementim nga OJF/sponsorizim
8	Forumi i Mendimit të Lirë (Mentor Kikia)	OJF	Mbrojtja dhe rigjenerimi i mjedisit, si mënyrë për të luftuar agresionin në rritje të fenomeneve natyrore , Velipojë Shëngjin	1,500,000	Mjedis	Do të bëhet pastrimi i mbetjeve urbane që janë shkarkuar gjatë vërshimit të ujrave në zonën bregdetare të Velipojës, nga grykë-derdhja e Bunes deri në lagunën e Vllunit, si dhe pastrimi i plazhit të Shëngjinit, nga porti deri në lagunën e Kune-Vainit.	Implementim nga OJF/sponsorizim
9	Eko Mendje	OJF	Ujë, pemë dhe dritë	2,500,000	Mjedis	Projekti synon disa ndërhyrje në zonat pranë HEC-eve, si dhe nënShkodër, si pastrime me varka; Mbajllje pemësh; Konkurs fotografie; Panair me produktet e zonës	Implementim nga OJF/sponsorizim



Projektet e përzgjedhura bazuar në thirrjen e KESH sh.a. për aplikime në kuadër të Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Përgjegjshmërinë Sociale të Korporatës

10	BID Shkodra	OJF	Sound Vibes	1,000,000	Kulturë	Projekti synon të vendosë një sistem audio në zonën pedonale BID 1, Rr. "13 Dhjetori – 28 Nëntori", ku tingujt e audios do të dëgjojnë përgjatë gjithë pedonales, me qëllim promovimin e kulturës dhe traditës së këtij qyteti, sipas një kalendarit të caktuar të eventeve	Implementim nga OJF/sponsorizim
11	Albanian Center of Audio Visual & Cinematography	OJF	Za-Fest	2,000,000	Kulturë	Mbështetje për festivalin ZAFest që zhvillohet në Shkodër e në Alpe për të promovuar kulturën e zonës	Implementim nga OJF/sponsorizim
12	Shoqata "Shpirti artistik i Shkodres"	OJF	Festivali mbarëkombëtar i fëmijëve Shkodër	3,000,000	Kulturë	Projekti synon të kontribuojë në vazhdimësinë e traditës së organizimit të festivalit të këngës për fëmijë në Shkodër	Implementim nga OJF/sponsorizim
13	Kontigjenca, asistenca teknike			8,000,000			
TOTALI				78,795,252			